



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Dhjetor 2021

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE

Prof. Dr. Edmond Hajrizi: UBT e vendosi Kosovën në hartën botërore të arsimit të lartë



Rangimet e UBT-së:

TIMES HIGHER EDUCATION

WURI 2021

POSITIVE IMPACT RATING EDITION 2021

THE IMPACT RANKINGS

GOOGLE SCHOLAR...

INTERNATIONAL RANKINGS AND PARTNERSHIPS

E
X
C
E
L
L
E
N
C
E

UBT-UNI.NET

TIMES HIGHER EDUCATION

UBT, është renditur në këtë listë prestigjioze në gjysmën më të mirë të renditjes përkrah institucioneve me më shumë emër në botë, ndërsa është institucioni më i mirërenditur nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Me këtë pozicion UBT e vendos Kosovën për herë të parë në këtë renditje, duke treguar kështu edhe frytet e shkëlqyera të punës 20-vjeçare të UBT-së.

WURI 2021

UBT, është vlerësuar nga WURI për rolin e jashtëzakonshëm inovativ, duke u renditur në mes të 51-100 universiteteve më të mira për Impakt Real në Menaxhim të Krizave, Impakt Real në Shpirt Sipërmarrës, Impakt Real në Vlera Etike dhe Impakt Real në Aplikime Industriale. Ndërsa është radhitur në mesin e 52-100 universiteteve më të mira për Impakt Real në Mobilitet dhe Mundësi për Student dhe në mesin e 101-200 universiteteve më të mira për Impakt Real.

POSITIVE IMPACT RATING EDITION 2021

UBT u vlerësua për ndikimin shoqëror dhe arritjet e qëndrueshmërisë pas publikimit të rezultateve nga Positive Impact Rating – PIR në Forumin Global të Parimeve për Menaxhim të Përgjegjshëm të Edukimit – Principles for Responsible Management Education- UN PRME.

UBT është një nga 47 shkollat e biznesit nga 21 vende të botës që morën pjesë në vlerësimin e këtij viti dhe arriti nivelin e pestë, duke e bërë UBT-në një shkollë pioniere që përmbledh angazhimin e saj për ndikim në shoqëri, duke qenë institucion unik brenda Positive Impact Ranking – PIR.

THE IMPACT RANKINGS

Arritja e UBT-së është e rëndësishme pasi ajo ka lënë pas edhe institucione të arsimit të lartë të mirënjohura, me prestigj dhe traditë. Vlerësimi i impaktit të universiteteve në këtë listë bëhet përmes analizës së të dhënave që lidhen me Sustainable Development Goals (SDGs). UBT është vlerësuar nga Impact Rankings 2021 për rezultate të larta në zbatimin e politikave të

qëndrueshme në të cilat lidhen me industrinë, inovacionin dhe infrastrukturën (SDG 9), kontributin për paqen, drejtësinë dhe institucione të forta (SDG 16), mirëqenien shëndetësore dhe fizike (SDG 3), partneritetin shumëdimensional për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17) si edhe zhdukjen e varfërisë (SDG 1).

GOOGLE SCHOLAR

UBT është renditur institucioni i parë jopublik, në nivel kombëtar, në bazë të citimeve në raportin e fundit të muajit korrik 2020, të titulluar: “TRANSPARENT RANKING: Top Universities by Citations in Top Google Scholar profiles”. UBT ka hyrë në renditjen e ngushtë globale prej rreth 4 mijë universiteteve prestigjioze të përgjedhura nga 30 mijë universitete, si një ndër top universitetet më të mira anëmbanë botës në bazë të botimeve të studuesve dhe profesorëve, citimit të tyre në Google Scholar, teksa prej këtyre institucioneve vetëm gjashtë universitete nga trojet shqiptare kanë arritur të rangohen në këtë listë të ngushtë.

Recognised for
Excellence 5 starAwarded to:
UBT

April 2019

This certificate remains valid for 3 years.

Russell Longmuir



20 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting

2001/2021

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatiti: Media Grupi i UBT-së

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

Intervistë e rektorit të UBT-së

Prof.dr.Edmond Hajrizi: UBT e vendosi Kosovën në hartën botërore të arsimit e të shkencës



Instituti IEME dhe UBT, institucione të themeluara nga prof.dr.Edmond Hajrizi, shënojnë sivjet 20-vjetorin e themelimit.

Një punë e gjatë, duke pasur parasysh rrethanat në kohën e themelimit, kur Kosova sapo kishte dalë nga lufta shkatërrimtare. Një zhvillim i hovshëm e krejtësisht i veçantë, përballë vështirësish të shumta. Por, gjithnjë një hap para të tjerëve, gjithnjë duke ndërmarrë hapa e veprime që të tjerët nuk kishin guxim t'i ndërmerrnin.

Për të arritur deri në ditën e sotme, kur UBT është institucion i njohur në gjithë globin.

Për rrugën e zhvillimit të deritashëm të UBT-së, në një intervistë, flet themeluesi dhe presidenti i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi.

Duke bërë një përmbledhje të zhvillimit të UBT-së, rektori Hajrizi thotë se koha kalon shumë shpejt, por ajo nuk e zbeh ndjenjën e mirë, kënaqësinë që në këto 20 vjet UBT ka pasur një zhvillim të vazhdueshëm dhe një rritje, dhe është një lloj storie të suksesit për të cilën ai ndihet mirë. Për faktin se është bërë një punë e mirë për komunitetin, për shtetin e Kosovës, për ndërkombëtarizimin e tij.

E rrugëtimi i tij, që nga studimet në Universitetin e Prishtinës e deri sot ka kaluar nëpër një kohë ndryshimesh të mëdha të sistemeve, si politike ashtu edhe ekonomike.

Por, si e kujton kohën e studimeve në vitet nëntëdhjetë?

“Ka qenë një përjetim i studimeve në një institucion të vetëm të arsimit të lartë në Kosovë, në Universitetin e Prishtinës. Natyrisht, një universitet i vetëm sjell edhe një koncept monopoli, jo mundësi të mëdha alternative për të gjetur edhe studime të tjera. Por, në të njëjtën kohë, edhe krenarë që ne kishim një universitet në gjuhën shqipe, me shumicën e fushave të jetës për të studiuar”, thotë ai.

Mirëpo, në kohën kur ai filloi studimet, filluan trazirat, filloi aneksimi, filloi pushtimi, filloi largimi nga shkollat, nga universitetet dhe kjo krijoi një ndjenjë

ashtu, të themi gjysëm-ilegale.

“Një studim, një dëshirë për të studiuar, por në të njëjtën kohë edhe një lloj fshehjeje për të studiuar, një lloj qasjeje totalisht ndryshe në relacion me parimet e të drejtave të njeriut, liritë e njeriut, të drejtën për t'u edukuar, për të qenë i shëndetshëm, i lirë...”

Kjo gjendje, tek Hajrizi dhe e gjithë gjenerata krijoi ndjenjën që të brumoset ideja se liria dhe të gjitha vlerat njerëzore janë shumë të rëndësishme për vendin, dhe një lloj vetëdijeje që studentët duhet të jenë pjesë e angazhimit dhe proaktivitetit për të arritur ato që bota i përcakton si vlera njerëzore.

“Kjo ishte një lloj përvojë me mungesë të shumtë të hapësirave, të infrastrukturës, të ecjes, krahasimit, izolimit me të tjerët, por në anën tjetër, një lloj vullneti e pasioni i pakontestueshëm për të mbijetuar dhe për të mbetur gjallë, që ky universitet, ky institucion, dhe ne të vazhdojmë me dijen, të vazhdojmë me edukimin dhe të mos mbetemi mbrapa gjeneratave të tjera”, thotë Hajrizi.

Në këto rrethana, shumë të rinj lanë studimet e mëtejme dhe jetën në Kosovë dhe vazhduan studimet e tyre jashtë vendit. Për faktin se studimet pas fakultetit ishin një sfidë e madhe në kohën e funksionimit të fakulteteve në shtëpi-shkolla.

Hajrizi u përcaktua që studimet pasdiplomike t'i ndjekë në Vjenë të Austrisë.

Austria ka qenë një prej vendeve të para që e ka kuptuar shumë më afër gjendjen e Kosovës dhe popullatës në shumë raste, dhe shumë forma, e sidomos te edukimi. Ajo u ka dalë në krahë të rinjve dhe e ka perceptuar mënyrën se si të ndihmohet.

“Kjo krijoi një perspektivë shumë të mirë, sepse kalova në një gjendje të zhvillimit akademiko-shkencor dhe nuk kishte më problem për t'u njohur me të arriturat e fundit, me lidhjen globale, me qasjen globale, me ndërkombëtarizimin e shkencës së kërkimit”, thekson Hajrizi.

Kushtet e ofruara për studime në Austri krijuan motivim shtesë për studime dhe zhvillim.

Për Hajrizin, kombinimi i mundësive dhe i dëshirës e pasionit krijoi një rezultat shumë të mirë.

“Arritëm të marrim edhe kompetenca të mira, dije të mira, njohje të mira, ndërlidhje të mira me profesorë, akademikë eminentë, universitete të ndryshme botërore dhe u krijua një gjendje shumë më e mirë”, shtona ai.

Pas çlirimit të Kosovës, ai u kthye në vend, ku ishin krijuar rrethana krejt të tjera...

“Kaloi pjesa e mbyllur, e errët e pushtimit edhe në këtë rast u krijua kështu një lloj drite, një lloj mundësie që të ecim përpara”.

Hapi i parë pas kthimit është themelimi i Institutit për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinierisë (IEME).

Ishte një reagim shpirtëror për të ndihmuar, për të qenë afër, për të qenë këtu, për të komunikuar, për të organizuar një tryezë, një konferencë, një trajnim.

“E gjitha kjo, ishte ajo fryma, ai magneti që të tërheq për të ardhur në Kosovë, dhe ajo tërheqje, ai bashkëveprim, mandej me popullatën, me institucionet që, në një farë mënyre, ishin të hapur që të vazhdojmë, mua më krijonte një lloj mundësie, një lloj pasioni që të jem edhe më aktiv, dhe ashtu vendosa që të themelohë një institucion para 20 viteve, që të kemi këtu në Kosovë dhe që të vijmë mandej dhe të ndihmojmë”, thotë Hajrizi.

Dhe gjërat morën rrjedhën e tyre.

“Ai institucion nuk mbeti, ashtu, i pjesshëm, i kohëpaskohshëm, por faktikisht filloi të rritej me aktivitete, me trajnime, me konferenca shkencore, me studime, me certifikime, me të gjitha risitë për të cilat kishte shumë nevojë Kosova në atë kohë. Kishte për gjithçka nevojë, dhe unë mundohesha që gjithçka që kam në lidhjet e mia dhe në mundësitë e mia profesionale, por jo vetëm të miat, por edhe të rrjetit tim profesional akademik, ta sjell në Kosovë dhe të bëj zgjidhje, të ndihmojë, të bëj

një transfer në dije”, thotë Hajrizi.

Si rrjedhojë erdhi UBT-ja?

“IEME ishte UBT-ja e parë ose ishte pjesa që ne filluam si institucion, siç kanë filluar edhe shumë institucione të tjera në botë, njëherë me një emër ‘Institut’, mandej me ‘Universitet’, ‘Kolegj’ apo forma të tjera të emërtimeve. Ne në fillim patëm vendosur ‘Institut’ emrin, dhe pas ‘Institutit’ e kthyem në emërtim universitar”, kujton ai.

Gjendja në Kosovë ishte e rëndë, as që mund të krahasohej me zhvillimet që kishin ndodhur në botë.

“Nga vizita që kisha me industrinë që kishin mbetur shihja se ishin pasive, me institucione të sapoformuara. Kisha një ndjenjë që këtu ka nevojë për shumë gjëra, nevoja të cilat lidheshin me fushat e mia, me fushat e teknologjive të reja, në fushat e menaxhimit modern, një organizimi ndryshe edhe mandej fillova që t'i ofroj ato, natyrisht me një koncept falas, vetëm që të ndihmoj.

Shkoja në Vjenë, kthehesha, mbaja një javë trajnime, organizime, kthehesha [në Vjenë] punoja atje, [më pas] vazhdoja të kthehem prapë”, thekson ai.

Ky kthim vazhdoi të përsëritet. Filluan kërkesat dhe kontaktet më shumë.

“Çka është e rëndësishme, njerëzit këtu më ofruan bashkëpunim, në njëfarë mënyre më hapën derën që unë të jem afër tyre dhe të punojmë bashkë. Kjo ishte për mua shumë domethënëse që nuk ka një shkallë të neglizhencës, por ka dëshirë për të transferuar, dhe ajo mandej ishte ajo shtytja e parë kryesore për mua që unë të bëj një vendimmarrje që në Kosovë duhet të angazhohesh, ka nevojë, njerëzit e dëshirojnë aktivitetin edhe njeriun profesionist, nuk të neglizhojnë!”, shton ai.

Filloi të jetë më aktiv. Por, ai nuk kishte ndonjë infrastrukturë, përveç dijes, pjesës intelektuale, nuk kishte ndonjë buxhet financiar ose angazhim infrastrukturor që të hynte me një investim të madh.

klasik vetëm i edukimit, por të jetë një ekosistem i vepërimeve dhe funksioneve të ndryshme që gjenerojnë dhe kanë impakt në kualitetin e jetës, në rritje ekonomike, në krijimin e vendeve të punës, në digjitalizim, në siguri, në njohje, ndërkombëtarizim e kështu me radhë”, thotë ai.

Vetë Hajrizi ka punuar në industri dhe në akademi dhe e kishte të qartë relacionin akademi-industri, krijimin e qendrave inovative e kështu me radhë. “Atëherë mua nuk më ka mbetur tjetër vetëm t’i implementojë ato praktika dhe ato mënyra që unë i paraqes në klasë edhe në Kosovë. Kështu që relacioni, bashkëpunimi mes industrisë dhe akademisë, industrisë, Qeverisë dhe akademisë, është i pashmangshëm, është kusht i domosdoshëm, kusht i nevojshëm për të qenë të suksesshëm. Andaj unë prej fillimit kam qenë aktiv, së pari personalisht, se s’kam pasur shumë staf që t’i angazhoj, të shkojë te kompanitë, t’ju mbaj trajnime, t’ju mbaj konsulta, t’ju ndihmoj që ato të aftësohen dhe të plotësojnë standardet botërore, të jenë sa më të konkurrueshme në treg, t’ju krijojmë fizibilitet, t’ju krijojmë lidhje me kompanitë simotra në Evropë dhe në botë, t’i njoftojmë për teknologjitë e fundit se ku mund ta gjejmë dhe ta bëjmë një lidhje me të”, thotë ai.

“Ne kemi zhvilluar programet profesionale të arsimit në Kosovë, programet e reja, kemi bërë reformën e arsimit profesional në Kosovë, kemi bërë digjitalizime të shumta në Kosovë, ne kemi vendosur certifikimet, ne kemi studiuar kryesisht shumicën e zonave ekonomike, zonave zhvillimore në Kosovë dhe i kemi ndihmuar Kosovës dhe pjesës lokale. Ne kemi bërë shumë projekte interesante, inovative, gjatë këtyre 20 viteve, stori që të krijojnë kënaqësi kur e sheh që nga këto aktivitete ka pasur një impakt dhe ka një rezultat do të thotë në vazhdimësi, shton ai.

Një segment i rëndësishëm i punës së UBT-së është ndërkombëtarizimi. Në këtë fushë është bërë një punë shumë e madhe.

“Edhe pse ishte kohë e izolimit, mungesë e lidhjeve, ne kemi qenë shumë aktivë në anëtarësimin e Kosovës në organizatat profesionale, sepse nuk ka vetëm anëtarësime të themi shtetërore, por ka edhe anëtarësime nacionale ose shtetërore në nivel profesional dhe akademik dhe ne e kemi parë që roli ynë është në këtë pikë, të angazhohemi që Kosova, flamuri i Kosovës të jetë pjesë e rrjeteve profesionale akademike shkencore në botë. Dhe ne me dhjetëra mos të them qindra anëtarësime në botë kemi bërë në emër të Kosovës dhe për Kosovën, duke përdorur dhe vetëfinancimin,

vetëlobimin, vetangazhimin, në mënyrë që ne të jemi krah për krah me shtetet e tjera”, thotë ai.

UBT në disa anëtarësime ishte para Serbisë, para Shqipërisë, para vendeve të tjera. Me këtë qasje shumë proaktive, sepse anëtarësimet nuk janë vetëm dëshirë, pasi në anëtarësime duhet të konfirmohet edhe kompetenca dhe një lloj profesionaliteti që ata ta akceptojnë në komunitete, si dhe plotësimi i kriterëve.

“UBT-ja dhe unë kemi punuar shumë që të plotësojmë kriteret, të tregojmë që edhe ne jemi të mirë, jemi profesionistë, jemi të njohur ndërkombëtarisht, na njeh bota dhe punojmë aktivisht jo vetëm në Kosovë”, thotë ai.

Dhe ky anëtarësim gjithnjë është konfirmuar me rezultatet botërore, duke qenë aktivë në shkencë, duke qenë aktivë në anëtarësime dhe duke thënë se, shiko edhe ne në Kosovë e bëjmë të njëjtën punë që e bëni ju dhe ne meritojmë që të jemi pjesë e këtyre të themi komuniteteve botërore ku ju merrni pjesë.

Vështirësitë kanë qenë shumë herë me rezistenca nga Serbia dhe të tjerët, por është arritur anëtarësimi. Dhe ky është edhe ai emocion i ndërtimit institucional jo vetëm të UBT-së.

“E thashë në fillim edhe po e cek që UBT-ja është rritur me Kosovën, është ndërtuar për Kosovën, dhe çdo gjë që kemi bërë kemi pasur një emocion direkt të njohjes së Kosovës, njohjes me rezultate, njohjes që edhe Kosova ka programe të mira, që edhe Kosova ka talente të mirë, që edhe Kosova ka të rinj të mirë, që arrijnë rezultate, që edhe ne jemi anëtarë, që edhe ne jemi një shtet në vetë, dhe gjithëherë kanë qenë këto komponentet tona që na kanë shtyrë të jemi aktivë, shton ai.

Rektori Hajrizi ka arritur të jetë edhe në borde drejtuese të shumë institucioneve ndërkombëtare.

“Kur ti tregon një lloj rezultati në shkencë, në punë profesionale akademike, ke ftesa të shumta të jesh anëtar i bordeve të ndryshme edhe të industrisë. Ju e dini, ne jemi tash anëtarë të kompanisë, të bordit mbikëqyrës apo bordit konsultativ (supervisory board) në ION Reality, një kompani globale tanimë. Ose në mekanizma të ndryshëm, ku ne kemi dhënë dëshminë tonë, kemi treguar që edhe nga Kosova kemi vlera, mund të zhvillojmë dhe të punojmë. Kështu që ka me dhjetëra anëtarësime ose kontribute tonat”, thotë Hajrizi.

“Mbi këtë bazë mandej edhe aty ku ka pasur mundësi të anëtarësohet UBT-ja mbi këtë bazë ku ka pasur mundësi edhe Kosova. Unë kam shkuar në tri nivele të anëtarësimit, niveli minimal individual që

unë të jem si individ anëtar i komiteteve, asociacioneve, e kështu me radhë, por që përfaqësohem nga Kosova, rasti kur institucioni ka mundur të regjistrohet apo të anëtarësohet kemi vendosur institucionet tona dhe në fazën e tretë kur është kërkuar të themi përfaqësim nacional atëherë kemi bërë edhe aty veprime që të organizohemi në nivel nacional që edhe aty të jetë Kosova pjesëmarrëse”, shton ai.

UBT njihet si një institucion ku zhvillohen shumë konferenca, debate në tema të ndryshme, me mysafirë të shumtë ndërkombëtarë. Ato kanë një rëndësi shumë të madhe dhe, të shumtën e herëve, trajtojnë tema specifike.

“Një nga veprimet që duhet shtyrë përpara janë forumet, debatet, komunikimi, ndarja e vlerave, e eksperiencave e praktikave të mira. Dhe vendi më adekuat për të gjitha palët e interesit që të jenë bashkë janë institucionet akademike, janë universitetet, janë qendrat e dijes, në të cilat edhe për vendimmarrësit dhe pjesëmarrësit kanë një hapësirë për neutralitet të mendimeve. Në këtë mënyrë, mendoj se ne duhet të jemi aktivë në organizimin e këtyre aktiviteteve, ku njerëzit shprehen, japin e shkëmbejnë mendime”, thotë ai.

Në vazhden e aktiviteteve të rëndësishme ka qenë edhe organizimi i konferencave shkencore këtu në Kosovë. Të vijnë dhe të publikojnë këtu edhe të tjerët dhe jo vetëm ne të shkojmë dhe të publikojmë në ndonjë konferencë që organizon dikush tjetër, në një universitet tjetër.

“Duhet të vijnë edhe ata në Kosovë, sepse edhe ne dimë të bëjmë pyetje të mira, të organizojmë konferenca të mira. Me këtë edhe e promovojmë Kosovën si vend që ka potencial dhe ia vlen dhe në anën tjetër japim kontributin tonë dhe plotësojmë kërkesën që universiteti të organizojë konferenca. Duke pasur parasysh këtë, që nga fillimi e deri tash, për 20 vjet, ne organizojmë konferenca shkencore ndërkombëtare, ku shkencëtarët e ndryshëm botërorë, përfaqësuesit e industrive vijnë dhe paraqesin këtu rezultatet e tyre shkencore. Kjo është diçka shumë e rëndësishme. Ndaj, ftojme politikëbërësit që të marrin pjesë dhe të jenë pjesë e këtyre konferencave”, thekson Hajrizi.

UBT ka një infrastrukturë solide në të gjithë kampuset e tij dhe po vazhdon të zhvillohet në këtë plan, duke qenë në trend me institucionet më moderne.

“Meqë jetojmë në një kohë të një konvergjece të dijes, për të cilën fola më herët, një moment i ndërlidhje së dijes dhe infrastrukturës, ne po mundohemi që këtë ta etablojmë këtu në Kosovë dhe të jetë si një model

për të tjerët në Kosovë, që të shihet se kjo është e mundshme. Ky inovacion kërkon edhe infrastrukturë, sepse po flasim për teknologjinë e fundit dhe transformimin e mënyrës së të jetuarit, atëherë duhet të kesh eksperimente të bazuara në teknologjinë e fundit dhe atë teknologji duhet ta kesh”, thotë Hajrizi.

UBT ka investuar dhe po investon që teknologjitë e së ardhmes të jenë prezente edhe në Kosovë.

“Unë nga fillimi, që 20 vjet, kam punuar që teknologjitë e së ardhmes të jenë në Kosovë. Unë kam sjellë robotët inteligjentë, që t’ju tregoj të rinjve se ne nuk duhet të largohemi dhe nuk guxojmë të mendojmë se nuk mund të afrohem te teknologjitë e fundit. Ne i ofrojmë Kosovës teknologjinë e fundit dhe atë para gjithë rajonit”, shton ai.

“Ne duhet të ofrojmë edhe një ekosistem të funksioneve të ndryshme të jetës, të shëndetit, pjesën e ushqimit, të energjisë, të klimës, të infrastrukturës, të aspekteve humane, të rolit gjinor, pjesën e të rinjve dhe kujdesit ndaj tyre, gjithashtu edhe të moshuarve, pjesën e mobilitetit, të transportit... Të gjitha jemi munduar, si infrastrukturë dhe si ekosisteme të vogla t’i instalojmë dhe kur ato i kemi, atëherë ne mund ta shohim këtë kompleksitet i cili po na rrethon dhe i cili ka nevojë për transformime, modele inovative, sepse jemi në një fazë shumë interesante. Ka sfida të jetës, një prej të cilave është pabarazia, pastaj çështja e klimës, ndryshimet klimatike dhe për këtë kërkohet nga ne që të gjejmë zgjidhje, modele. Dhe ato modele po kërkojnë një ambient ku studiohen në miniaturë dhe mbi ato studime mund të japim rezultate. UBT tash ka krijuar një ekosistem të tillë inovativ dhe do të vazhdojë edhe më tutje të investojë, aq sa ka mundësi për të qenë pjesë e kontributit global”, thotë Hajrizi.

Në fund, ai ka një vizion për UBT-në pas 10 vitesh.

“UBT ka një strategji 2025-2030. Mendoj se UBT do të jetë një ndërmarrësi dhe një ekosistem inovativ modern, me një rol model, jo vetëm për Kosovën por në nivelin global. Do të ketë një rrjet të gjerë të qendrave të veta virtuale apo fizike në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Ju e dini se kemi filluar të hapim qendra të ndryshme në botë. Mandej të krijojmë një mbështetje dhe një impakt global që edukimin mos ta ofrojmë vetëm për kosovarët, siç e afrojmë tani, por ta ofrojmë edhe në nivelin global”, thotë ai.

UBT po punon në transformimin e modeleve të një universiteti modern.

“Lirisht mund të themi se jemi

një frontier i modeleve se si duket një universitet në të ardhmen. Gjithë ato publikime ato forume botërore për një kampus modern, për një universitet të tillë, UBT është duke i implementuar me një shpejtësi shumë të madhe. Dhe po e konfirmon se ne gjithsesi do të jemi në hap më të gjitha... E keni parë Classroom 3.0, keni parë University 4.0... këto dhe modele të tjera UBT i ka futur në proces të implementimit dhe deri më 2030 mendoj se të gjitha këto komponente do të jenë të natyrshme dhe të kenë një ndikim të madh në botë.

Ne e dimë qartë se kah duhet të shkojmë dhe ku duhet të mbërrijmë në 2030, i cili është një vit i sfidave të mileniumit – 17 qëllimet e Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm kanë një afat të fundit, që ne mundësisht të kujdesemi për uljen e nivelit të karbonit në planet, të kujdesemi për planetin...”, thotë Hajrizi,

UBT është duke punuar fuqishëm në pjesën e zhvillimit të qëndrueshëm, në inovacion dhe në reziliencë, që janë motot kryesore të këtyre viteve.

“Jorastësisht ne kemi dalë edhe këtë vit si ndër universitetet më të mira në botë për kontributin në zhvillimin e qëndrueshëm. Në nivel botëror kemi dalë ndër 500 universitetet më të mira në Impact Ranking, në Positive Impact Ranking kemi dalë në nivelin më të lartë në nivelin botëror të shkollave më të mira në botë dhe në rangimin e universiteteve për impaktin real kemi hyrë ndër 100 universitetet më të mira në botë. Këto janë rangime prestigjioze, nga organizata prestigjioze, nga organizata të Kombeve të Bashkuara, ne tanimë kemi treguar impakt. Nuk jemi më vetëm “do të bëjmë” apo “kemi plan apo strategji”, por në fakt, veç strategjisë e planeve, ne kemi edhe veprime, ne kemi edhe rezultate dhe kemi një impakt, për të cilin jemi vlerësuar si një prej universiteteve më të mira në botë”, thotë Hajrizi.

Mendoj se kjo është një arritje shumë e mirë, dhe njëkohësisht neve na krijon edhe një hapësirë manovrimi edhe më të mirë që ne të hyjmë në elitën botërore të institucioneve dhe me këtë të kemi edhe qasje më të mirë, edhe një mundësi për të kontribuar më shumë, përfundon themeluesi dhe rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Intervistoi: Myrvete Çerkezi

Mbi 1200 pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së



Organizimi më i madh shkencor në tërë Evropën Juglindore ka përfunduar suksesshëm, me Konferencën Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion, që shtriu aktivitetin në 24 fusha studimi,

të mbajtura në eventin dy ditor, të organizuar nga UBT. Edicioni i këtij viti, ishte edicioni i 10-të – jubilar, i cili mblodhi më shumë se 1200 pjesëmarrës, mbi 600 hulumtues shkencorë, me një rritje të numrit të ndër-

kombëtarëve pjesëmarrës prej 20%.

Ky edicion i Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion solli tema që nuk janë trajtuar më parë, e që nga këndvështrime të ndryshme

u dhanë vlerësime rreth problemeve të shtruar dhe trajtuara nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së, e cila këtë vit u mbajt në formë të kombinuar, fizikisht dhe virtualisht,

shtriu aktivitetin e saj në 24 fusha të ndryshme, duke dëshmuar edhe njëherë liderшипin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në vend, duke përfshirë fushat:

Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri e Komunikimit; Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi; Mekatronikë, Inxhinieri e Sistemeve dhe Robotikë; Inxhinieri e Energjisë Efiçente; Sistemet e Informacionit dhe Siguri; Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor; Inxhinieri e Ndërtimit, Infrastruktura dhe Mjedis; Juridik; Shkenca Politike; Gazetari, Media dhe Komunikim; Agrikulturë, Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji; Shkencat Farmaceutike dhe të Natyrës; Dizajn i Integruar; Psikologji; Edukim dhe Zhvillim; Modë; Muzikë Moderne dhe Audio Produksion; Art dhe Media Digjitale; Stomatologji; Mjekësi e Aplikuar – Infermieri; Mjekësi – Infermieri dhe Shkencat Teknike Mjekësore (Radiologji dhe Anesteziologji); Sport; Gjuhë dhe Kulturë; Studime të Sigurisë.

Global UBT Fest 2021” dëshmoi rolin që UBT ka në arsimin e lartë në Kosovë

Ka përmbyllur suksesshëm aktivitetin festivali “Global UBT Fest 2021”, festival që mori vëmendjen e shumë pjesëmarrësve nga vendi, rajoni dhe Evropa, të cilët përgjatë 1 muaji ndoqën akademi të shumta online, forume, aktivitete kulturore-artistike, hackings, etj.

Në ceremoninë përmbylëse të ngjarjes më të madhe akademike në rajon, “Global UBT Fest 2021”, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, potencoi se festivali ishte një arenë e fortë e ballafaqimit të ideve, prezantimit të arritjeve e mbi të gjitha e shkëmbimit të përvojave mes pjesëmarrësve, një diversantët që i ka dhënë vlerë të pakontestueshme këtij festivali.

“Njëzetë vite më parë, kur unë u ktheva në Kosovë, për të sjellë këtu përvojën

dhe cilësinë perëndimore të shkollimit, isha plot shpresë se një ditë dera e UBT-së do të jetë e hapur jo vetëm për studentët dhe profesorët tanë vendorë por edhe për akademikët, studiuesit, studentët e mësimdhënësit e respektuar ndërkombëtarë. Pas njëzetë vitesh, sot, e them me mburrje se përmbushja e këtij qëllimi nuk ka qenë e lehtë, ishte plot sfida por e pandalshme dhe e arritshme, për çka sot jam tejet krenar”, theksoi Hajrizi.

Rektori Hajrizi tha se “Global UBT Fest 2021” zgjoi interesimin e pjesëmarrësve nga shumë shtete ndërkombëtare, teksa në fokus kishte inovacionin, zhvillimin e qëndrueshëm, njëherësh pati një këndvështrim akademik.

“Kosova sot ka potencial të madh në rininë e saj, në



studentët e saj. Ne sot jemi konkurrent kudo, në shumë fusha, në disa prej të cilave në krye të listës. Kjo është dëshmi e këtij potenciali frymëzues i cili do t'i sigurojë Kosovës një të ardhme të ndritur”, tha

rektori Hajrizi. Integruar në kuadër të festivalit “Global UBT Fest 2021”, Akademia Ndërkombëtare Verore e UBT-së, tashmë është shndërruar në traditë, ku u mbajt për të dhjetin vit me

radhë. Akademitë, si dhe aktivitetet tjera, ishin të fokusuar në disiplina të shumta shkencore ku u shkëmbyen ide online nga qindra profesorë dhe nga mijëra pjesëmarrës.

UBT e rendit Kosovën të parën në rajon në vendosjen e rrjetit 5G

Kosova është bërë me kampusin e parë universitar që ka instaluar rrjetin global 5G, duke e lokalizuar në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, përmes një marrëveshje me UBT-së dhe kompanisë finlandeze të telekomunikacionit "Nokia".

Në një ceremoni solemne, nën patronatin e rektorit të UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, është bërë inaugurimi i shtrirjes së gjeneratës së pestë së teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela – 5G.

Pjesëmarrës në këtë ceremoni në formë virtuale ishin: ambasadorja e Ambasadës së Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, përfaqësuesi i kompanisë së telekomunikacionit "Nokia", David Pavlinic, si dhe profesori i Fakultetit Shkencor Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Xhafer Krasniqi, ndërkaq fizikisht morën pjesë përfaqësues nga zyra e kryeministrit, ARKEP, komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sporte, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përfaqësues të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përfaqësues nga Zyra e Koordinatorës për Zhvillim të OKB-së, drejtues të Parkut Trajnues në Prizren, përfaqësues të Telekomit të Kosovës, përfaqësues të Odës Ekonomike Gjermane, përfaqësues të Odës së Afarizmit, përfaqësues nga kompani të ndryshme, si dhe përfaqësues dhe pjesëmarrës të tjerë nga institucionet vendore.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, në hapje të kësaj ceremonie tha se UBT po prezanton një teknologji të re në Kosovë, e cila tashmë po kompletton një ekosistem të quajtur "Placed based Innovation Ecosystem".

"Besojmë se tashmë e kemi krijuar një ekosistem që po e



quajmë "Placed based Innovation Ecosystem", ku përveç teknologjisë 5G kemi bërë edhe një qendër për virtualizim të bazuar në Virtual Reality dhe Augmented Reality. Kur të mbledhim të gjitha këto komponente është një investim diku rreth 50 milionë euro dhe që shumica është bërë nga investimi ynë 20 vjeçar, por që kemi pasur edhe investime që vijnë edhe nga partnerët tjerë, në këtë rast nga kompanitë që kemi krijuar një lloj kornize të një sipërmarrje të përbashkët", ka thënë rektori Hajrizi.

Virtualisht, ambasadorja e Ambasadës së Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, ka thënë se ndihet e lumtur me këtë arritje të UBT-së, duke theksuar se UBT ka bërë një progres të jashtëzakonshëm që i ka ndihmuar shumë promovimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

"Jam shumë krenare që po arrini ta jetësoni këtë projekt në një universitet dhe po mundoheni t'i gjeni format më të mira për ta shfrytëzuar rrjetin 5G. Ka shumë gjëra pozitive që mund t'i bëni me 5G. Studentët në universite-

tin tuaj janë me të vërtetë të privilegjuar sepse ata mund të shohin edhe mundësi të tjera", ka thënë ambasadorja e Ambasadës së Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall.

Përfaqësuesi nga kompania finlandeze e telekomunikacionit "Nokia", David Pavlinic, tha se UBT pa pikë mëdyshje është institucioni i parë në rajon që po vendos rrjetin privat 5G, përderisa dha mbështetjen e plotë të kompanisë "Nokia" për UBT-në dhe Kosovën në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

"Rrjeti 5G është i rëndësishëm sepse po e zhvendos të gjithë industrinë, Qeverinë dhe të gjithë sektorët në epokën e digitalizimit, në industrinë 4.0. Nokia është këtu për t'ju mbështetur dhe mezi po presim ta vazhdojmë bashkëpunimin me UBT-në dhe për ta mbështetur të gjithë Kosovën në epokën e digitalizimit", theksoi përfaqësuesi i kompanisë finlandeze të telekomunikacionit "Nokia", David Pavlinic.

Nga Londra, profesori i UBT-së, Xhafer Krasniqi, për pjesëmarrësit e kësaj ceremonie, virtualisht ka bërë një

prezantim të periudhës së implementimit të teknologjisë më të re të rrjeteve celulare pa tela në UBT, 5G.

Ai ka thënë se UBT vendosi rrjetin 5G për të shfrytëzuar aftësitë e kësaj teknologjie, për të lejuar studentët dhe studiuesit të testojnë dhe eksperimentojnë ide dhe zgjidhje të ndryshme kërkimore pa pasur nevojë për simulime dhe pa pasur nevojë të presin për vendosjen e plotë të rrjetit 5G. Anëtarja e bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Rrezarta Duraku Rizaj, ka theksuar se iniciativat e tilla si të UBT-së promovojnë inovacion dhe ju ndihmojnë jashtëzakonisht shumë gjeneratave të reja të zhvillohen edhe më shumë profesionalisht në lëmin e teknologjive digjitale, pse jo edhe në fusha të tjera.

"Iniciativat e tilla promovojnë inovacion dhe ju mundësojnë gjeneratave të reja të shohin nga afër funksionimin e teknologjive më të reja në botë. Si përfaqësuese e ARKEP-it, mund të them se edhe ne e kemi dhënë një kontribut duke e lejuar përdorimin e

brezeve frekuencore që janë të nevojshme për funksionimin e këtij laboratorit, në përjashtim të brezit 700 mhz i cili është momentalisht i zënë nga shërbimet radiodifuzive", ka thënë anëtarja e bordit të ARKEP, Rrezarta Duraku Rizaj.

Shefi i Kabinetit të Zyrës së Kryeministrit, Luan Dalipi, tha se zhvillimi i teknologjisë dhe inovacionit është e vetmja alternativë që ne si shoqëri kemi, dhe institucionet si UBT tregojnë se si duhet punuar në gjëra inovative pa prituri që qeveria t'i shtyjë ato para.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sporte, Ardian Gola, ka thënë se UBT është një nga kontribuuesit kryesor që i ka kthyer institucioneve të arsimit të lartë kulturën akademike, shkencore dhe inovative, përderisa ka vlerësuar lartë arritjen e implementimit të 5G, si një prej revolucioneve digjitale që pason revolucionin industrial dhe teknologjik.

Deputeti i Parlamentit të Kosovës, Jahja Kokaj, në një fjalë rasti tha se arritja e sotme e Kosovës përmes UBT-së në teknologjinë 5G është shumë emocionale, duke falënderuar rektorin Hajrizi për angazhimin e tij të palodhshëm për të qenë të parët në region në teknologjinë e rrjeteve celulare pa tela 5G.

Me këtë arritje të jashtëzakonshme, UBT e fut në rangun e 20 inovacioneve të saj në 20-vjetorin e themelimit, njërin prej teknologjive më të sofistikuar të kohës, kështu duke krijuar hapësirë dhe mbështetje edhe më të madhe për të gjithë të rinjtë dhe të rejtat novator, për të krijuar një shoqëri të dijes, që mbështetet në kërkim, zhvillim dhe inovacion.

UBT anëtarësohet në "European University Association"

UBT është bërë pjesë e "European University Association" (EUA), kështu duke fuqizuar edhe më shumë ndërkombëtarizimin e Kosovës jashtë vendit.

Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi ka thënë se anëtarësimi i UBT-së në këtë shoqatë është një vlerë e madhe për Kosovën, pasi

që UBT gjithmonë ka qenë një zë i fuqishëm i Kosovës në arenën ndërkombëtare.

"Anëtarësimi i UBT-së në EUA është një lajm shumë i mirë jo vetëm për ne por për gjithë vendin, pasi që UBT gjithmonë ka qenë një përfaqësues i denjë dhe zë i fuqishëm i Kosovës në arenën ndërkombëtare,

gjithnjë me punë dhe përkushtim", ka thënë rektori Hajrizi.

Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me një sërë organizatash të tjera evropiane dhe ndërkombëtare, EUA siguron që zëri i pavarur i universiteteve evropiane të dëgjohet.

UBT përmes këtij rrjeti

bashkëpunimi me universitetet evropiane do të ketë mundësi që të shkëmbejë përvoja në fushën e arsimit universitar, hulumtimit, dhe inovacionit.

"European University Association" (EUA) përfaqëson më shumë se 800 universitete dhe konferenca kombëtare të rektorëve në 48

vende evropiane. Anëtarët e kësaj shoqate janë universitete evropiane të përfshira në mësimdhënie dhe hulumtime shkencore, shoqata kombëtare të rektorëve, si dhe organizata të tjera aktive në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

UBT përmes “Nokia” sjell në Kosovë rrjetin 5G

UBT përmes kompanisë finlandeze të telekomunikacionit “Nokia”, po sjell për herë të parë në Kosovë dhe rajon rrjetin 5G, që mundëson shtrirjen e gjeneratës së pestë të teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela që njihet si e ardhmja e internetit.

Sipas marrëveshjes trevjeçare, “Nokia” do t’i sigurojë UBT-së lidhjen wireless 5G SA, që do të mundësojë zhvillimin e kërkimit dhe testimit të bazuar në 5G, për një numër rastesh përdorimi të drejtuara nga teknologjitë përkatëse Internet of Things (IoT) dhe AI, si pjesë e përpjekjeve për të nxitur kërkime dhe inovacione.

Në një komunikatë për media, lëshuar nga kompania prestigjioze e telekomunikacionit, “Nokia”, thuhet se rrjeti 5G do të bazohet në Nokia Digital Automation Cloud (DAC), një platformë digjitalizimi, e cila është e aftë të ofrojë besueshmëri, shpejtësi të lartë të trafikut dhe uljen e vonesave gjatë komunikimeve



të ndryshme në kohë reale duke përdorur teknologji të ndryshme.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se shtrirja e rrjetit 5G në Kosovë përbën një zhvillim të rëndësishëm për Kosovën në ekonominë digjitale të vendit. “Shtrirja e rrjetit të parë privat 5G në Kosovë do të na mundësojë të qëndrojmë në krye të kërkimit dhe zhvillimit në nivel lokal. 5G është një shtysë e madhe, ndërsa

po zhvillohen edhe aplikacione të tjera, dhe kjo do të na mundësojë të nxisim inovacionin dhe do të ketë një ndikim në ekonominë digjitale të Kosovës në përgjithësi”, ka thënë rektori Hajrizi.

Në komunikatën e lëshuar nga “Nokia”, drejtori i Shitjeve për Evropën Juglindore, Michael Siegel, ka thënë se ky investim i “Nokia” në bashkëpunim me UBT-në nënkupton një zhvillim të madh për të dy palët në rajon.

“Investimi i UBT-së në 5G, në bashkëpunim me “Nokia”, përfaqëson një përparim të madh në rajon. Në planin ndërkombëtar, ne shohim institucionet kryesore kërkimore që u drejtohen aftësive të besueshme, të sigurta dhe me shpejtësi dhe gjerësi të brezit me frekuencë shumë të lartë që ofron rrjeti 5G, kjo mundëson kërkimin, funksionimin e rrjetave Internet of Things, Artificial Intelligence dhe automatizimit të gjitha proceseve në industri – të cilat të gjitha kontribuojnë në avancimin e industrisë 4.0”, ka thënë Drejtori i Shitjeve për Evropën Juglindore në kompaninë “Nokia”, Michael Siegel. Sipas zyrtarëve të kësaj kompanie, “UBT” është duke mbështetur të rinjtë dhe të rejtat në ambiciet e tyre për të krijuar një shoqëri të dijes, duke punuar me ndërmarrjet publike dhe private, në mënyrë që të vendoset infrastruktura e nevojshme që mbështet kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin.

“Nokia” është kontribuue-


si kryesor i industrisë së telefonisë mobile, pasi që ka ndihmuar në zhvillimin e standardeve GSM, 3G dhe LTE, dhe aktualisht 5G, si dhe dikur ishte shitësi më i madh në mbarë botën i telefonave celularë dhe telefonave të mençur.

UBT u themelua në vitin 2001. Me shumë programe të akredituara, 10 mijë studentë, 1 mijë të punësuar, park shkencor dhe teknologjik, institucione kërkimore dhe zhvillimore, qendra, laboratorë të ndërmarrësisë dhe inovacionit, qendra të ndryshme të teknologjisë dhe media, UBT ka krijuar një ekosistem.

Për më tepër, UBT është institucioni që procesin arsimor e ka vendosur në platformën e realitetit virtual, duke ofruar zbatimin e plotë të CLASSROOM 3.0 dhe tani duke u bërë Kampusi Universitar 5G, do të ketë sukses të bëhet një nga universitetet më progresive dhe më të vlerësuara në Evropën Juglindore.

Kosova përmes UBT-së renditet e para në botë për nga aplikimi i Realitetit Virtual

Falë UBT-së flamuri i Kosovës sërisht është ngritur në arenën ndërkombëtare. Kësaj here, UBT në ShBA përfaqësoi vendin në ngjarjen më të madhe globale të gjigantit teknologjik, EON Reality, kompani kjo më e madhja botërore për teknologji virtuale. Në këtë ngjarje Kosova përmes UBT-së është renditur institucioni i parë nga mbarë bota për nga aplikimi i EON-XR në arsim.



UBT e përfaqësoi Kosovën në konkursin ndërkombëtar INSPIRELLI AWARDS

Edhe Kosova, falë UBT-së, u përfaqësua denjësisht në konkursin ndërkombëtar “INSPIRELLI AWARDS”, e cila organizohet në Pragë, në mesin e 106 shteteve. Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor ishin pjesë e kësaj gare me shumë punime inovative.

Ekspozita e punimeve të zgjedhura u ofrua online dhe në galeritë e partnerëve të përzgjedhur për popullatën dhe komunën e Ouagadougou, kryeqyteti i Burkina Faso dhe qendra administrative, komunikuese, kulturore dhe ekonomike e kombit, për



të eksploruar, për të mësuar, për t’u frymëzuar dhe për të përjetuar rehabilitimin e qëndrueshëm futuristik si një mjet elastik konstruktiv i qytetit. INSPIRELLI AWARDS është konkursi më i madh

botëror i studentëve në Arkitekturë, Dizajnit Urban të Peizazhit, dhe Dizajnit të Enterierit, i cili mundëson prezantimin dhe shfaqjen e talentit të arkitektëve të së ardhmes nga mbarë globi.

Presidenti i Shoqatës Evropiane të Universiteteve mirëpret anëtarësimin e UBT-së në EUA



Presidenti i Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EUA), profesori Michael Murphy, i ka dërguar rektorit të UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, një letër mirëseardhëse, me rastin e anëtarësimit të UBT-së në EUA.

Në letrën dërguar rektorit Hajrizi ai i uron mirëseardhje institucionit që ai drejton, duke thënë se është i hapur për të punuar ngushtë në promovimin e partneriteteve në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor brenda Evropës.

“Kam kënaqësinë të mirëpres Institucionin e Arsimit të Lartë – UBT, si

një anëtar të ri të Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EUA). EUA është rrjeti më i madh dhe më i gjerë i universiteteve evropiane që ofron një forum për të ndarë ekspertizën, për të kontribuar në studime, për të marrë pjesë në ngjarje, si dhe për të ndikuar në vendimet e politikave. Unë pres që të punoj me ju në promovimin e partneriteteve në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në brenda Evropës, dhe unë ju falënderoj që u bashkuat me zërin e universiteteve të Evropës”, ka shkruar në letrën e tij dërguar rektorit Hajrizi, profesori Michael Murphy.

UBT institucioni privat me më së shumti programe studimi të akredituara në Kosovë



Janë bërë 20 vite që prej kur UBT është themeluar si institucion i arsimit të lartë, dhe që nga ajo kohë UBT ka qenë lider i arsimit të lartë në vend, tani së fundmi duke mbajtur primatin si institucioni privat me më së shumti programe studimi dhe specializime të akredituara në vend.

Me vendimin e fundit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, krahas shumë programeve të tjera të studimit UBT ka marrë akreditimin edhe për 18 programe të reja studimi si dhe është riakredituar në 13 programe tjera, në të cilat tashmë edhe zyrtarisht mund të aplikojnë të gjithë të interesuarit:

Psikologji (Bachelor), në Prishtinë
 Teknik Dentar (Bachelor), në Prishtinë
 Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes (Bachelor), në Prishtinë
 Specializimet:
 Aktiviteti Fizik në Shëndet dhe Mirëqenie;
 Trajnimi dhe Trajnimi Sportiv;
 Menaxhimi Sportiv.
 Gjuhë Angleze (Bachelor), në Prishtinë
 Shëndet Publik dhe Menaxhment (Master), në Prishtinë
 Zhvillim dhe Urbanizëm (Master), në Prishtinë
 Studime të Sigurisë

(Bachelor), në Prishtinë
 Administrim Biznesi (Bachelor), në Pejë
 Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Bachelor), në Prizren
 Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Bachelor), në Pejë
 Juridik (LLB), në Prizren
 E Drejta Penale (LLM), në Prishtinë
 Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji (Bachelor), në Prizren
 Shkenca Politike (Master), në Prishtinë
 Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment (Master), në Prishtinë
 Dizajn i Integruar i Avancuar (Master), në Prishtinë
 Specializimet:
 Dizajn i Modës;
 Dizajn i Produktit;
 Dizajn Grafik;
 Dizajn Interieri;
 Menaxhimi i pronave të paluajtshme dhe infrastrukturës ESLG (Bachelor), në Prishtinë-ESLG
 Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Bachelor), në Prishtinë

Programet e riakredituara:
 Sistemet e Informacionit (Bachelor), në Prishtinë
 Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji (Bachelor), në Prishtinë
 Arkitekturë dhe Planifikim

Hapësinor (Bachelor), në Prishtinë
 Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (Master), në Prishtinë
 Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (Bachelor), në Ferizaj
 Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (Bachelor), në Prizren
 Shkenca Politike (Bachelor), në Prishtinë
 Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë (Bachelor), në Prishtinë
 Dizajn i Integruar (Bachelor), në Prishtinë
 Media dhe Komunikim (Bachelor), në Prishtinë
 Media dhe Komunikim (Master), në Prishtinë
 Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë (Master), në Prishtinë
 Sistemet e Informacionit dhe Menaxhment (Master), në Prishtinë

Lista e programeve ekzistuese:

Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi
 Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri
 Menaxhimi i Mekatronikës
 Sistemet e Informacionit
 Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor
 Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë
 Shkenca Politike

Media dhe Komunikim Juridik
 Inxhinieri e Energjisë
 Dizajn i Integruar
 Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji
 Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi
 Agrikultura dhe Inxhinieria e Mjedisit
 Art dhe Media Digjitale
 Teknik i Anestezijologjisë
 Teknik i Radiologjisë
 Infermieri
 Farmaci
 Stomatologji

UBT përgjatë 20 viteve punë të palodhshme akademike, ka sjellë çdo herë programe të reja të studimit për të rinjtë kosovarë, duke u bazuar në eksperiencat, idetë dhe modelet e universiteteve më të njohura dhe më prestigjioze të botës, shtuar këtu edhe ndjekjen e trendit të profesioneve më të kërkuara në botë.

Mijëra studentë të diplomuar në nivelet bachelor dhe master, diplomë kjo e njohur ndërkombëtarisht, si dhe me profesionistët dhe ekspertët më të mirë të fushave përkatëse të bashkuar në një vend, pra në UBT, kanë bërë që ky institucion të jetë numër një në arsimin e lartë, si për cilësi ashtu edhe për kushtet infrastrukturë moderne të saj. Praktikant më të mira të

mësimi bashkëkohor dhe modern, si dhe teknologjitë më të spikatura dhe të fundit të kohës i ka sjellë në Kosovë UBT, të gjitha në funksion të shkencës dhe akademisë, duke u hapur rrugë studentëve që të kenë mundësi të zhvillohen pa pasur asnjë pengesë në rrugëtimin e tyre akademik. Realiteti Virtual dhe rrjeti global i teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela 5G, janë dëshmi se UBT është institucion serioz për sa i përket zhvillimit të studentëve dhe teknologjive të reja, për t'iu mundësuar atyre ndjekjen e trendit teknologjik dhe të qenit i barabartë me secilin studentë të secilit shtet të botës.

Tjetër hap i rëndësishëm i UBT-së përgjatë këtyre 20 viteve është hapja e qendrave të teknologjisë dhe inovacionit në qytete të ndryshme të Kosovës, së fundmi me qytetin e Korçës dhe tani me Prizrenin, ku të rinjve po u hapen dyert për të gjetur vetën në fusha multidisiplinare të jetës shoqërore.

Me të gjitha kushtet e plotësuar dhe me mundësitë unike për studim, profesorët dhe ekspertët më të mirë, të gjithë të rinjtë kanë një zgjedhje për të bërë, dhe ajo është UBT.

UBT organizoi ceremoni për nder të 13-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës - Ndahen mbi 300 bursa

UBT ka shënuar 13-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës përmes një ngjarje madhështore, pjesë e së cilës ishin stafi dhe studentët e UBT-së.

Në ceremoninë e cila u zhvillua virtualisht, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi kujtoi rëndësinë e kësaj dite, si dhe sakrificat për liri dhe pavarësi të një shteti demokratik.

“Liria dhe Pavarësia e Republikës së Kosovës u arrit me shumë sakrificë. Derisa festojmë frytet e lirisë dhe pavarësisë sonë, duhet të kujtojmë sakrificën e atyre që e bënë këtë të mundur, dëshmorët e kombit, veteranët e luftës, familjet e tyre, aktivistët politikë, aktivistët për të drejtat e njeriut, mjekët, mësimdhënësit dhe diasporën tonë”, tha rektori Hajrizi.

Ai ka thënë se UBT për 20 vite ka dhënë kontribut të madh për



shtetin e Kosovës, në ndërkombëtarizimin dhe rritjen akademike të shumë të rinjve, që në të ardhmen do të jenë profesionistë në fushat e tyre përkatëse.

“Shtatë vite përpara se Kosova të shpallej shtet i pavarur,

përpara se të kurorëzonte me pavarësi shtetësinë e saj, ne filluam rrugëtimin tonë akademik për të bërë diçka ndryshe, për të kontribuar në krijimin e një brezi të ri, të shkolluar e akademik, që Kosovës do t’i dalin zot,

e do e udhëheqin në të ardhmen në procese të ndryshme, në fusha të ndryshme”, ka thënë prof. dr. Edmond Hajrizi.

UBT për nder të 13-vjetorit të pavarësisë ka ndarë mbi 300 bursa studimi për studentët të

dalluar, të cilët kanë treguar sukses në studime, kështu duke dëshmuar përkushtimin për studentët dhe cilësinë që UBT gjithmonë e ka mbajtur në nivele të larta.

Ndër të tjera, me vendim të Këshillit Akademik të UBT-së, sot u konfirmuan edhe thirrjet akademike për 100 profesorë.

Në këtë ceremoni ka performuar edhe bendi i UBT-së, i përbërë nga studentët të Fakultetit Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment.

UBT çdo vit feston dhe organizon ceremoni për nder të Pavarësisë së Kosovës, që shërben si një ditë reflektimi mbi të arriturat dhe kontributin e UBT-së në ngritjen e cilësisë akademike, për sukseset e institucionit dhe studentëve, si dhe për ndërkombëtarizimin e vendit dhe ngritjen e imazhit të Kosovës nëpër botë.

Rritet numri i stafit, UBT-së i bashkohen edhe 50 profesorë



Krahas rritjes së vazhdueshme të studentëve, viti i ri akademik 2020/2021, e karakterizon UBT-në me staf të përfunduar akademik dhe profesional. Së fundmi, rreth 50 profesorë, prej tyre doktorë shkencë të diplomuar në shtetet për zhvilluar të botës, i janë bashkuar institucionit më të përkushtuar ndaj aktiviteteve akademike dhe arsimore-edukative, UBT-së. UBT përveç që vazhdon të jetë lider në arsimin e lartë jop-

ublik dhe të ketë rol aktiv në shërbim të shoqërisë, mbetet një nga i vetmi institucion që përkrahë vazhdimisht zvogëlimin e papunësisë në vend. Si rezultat, paralel me numrin e studentëve, edhe numri i stafit që punësohet në UBT vazhdon të rritet nga viti në vit, ku stafi i angazhuar ka grada të larta shkollimi dhe janë të përgatitur për të ndarë përvojat dhe ekspertizat e tyre profesionale me studentët.

Në bazë të raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), UBT është institucioni numër një për nga numri i stafit të punësuar. UBT vitin e kaluar ka rritur numrin në rreth 1 mijë të punësuar, përfshirë staf akademik dhe administrativ. Numri i stafit që angazhohet në UBT, vazhdon të rritet nga viti në vit.

Së shpejti edhe një mundësi për studime të doktoratës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Bullgari

UBT së shpejti do ta ketë edhe një dritare më shumë për ata që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivelin e doktoratës, në një prej instituteve prestigjioze bullgare. Bashkëpunimi shkencor në shumë fusha të sigurisë, veçanërisht në studimet postdiplomike, ishte thelbi i takimit të frytshëm e premtues në Bullgari në mes të rektorit të UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe drejtorit të Institutit të Mbrojtjes “Prof. Tsvetan Lazarov”, kolonel dr. Dimitar Kirkov.

Rektori Hajrizi dhe delegacioni i lartë i Institutit i kryesuar nga koloneli Kirkov, diskutuan mundësitë e arritjes së shpejtë të marëveshjes që do t’u mundësojë të gjithë atyre që duan të avancojnë karrierën e tyre akademike në nivelin e doktoratës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që këtë ta bëjnë përmes UBT-së në këtë institucion kredibil e prestigjioz.

Në këtë takim, ka pasur një bashkëbisedim të avancuar

për bashkëpunimin në të ardhmen mes UBT-së dhe Institutit të Mbrojtjes “Prof. Tsvetan Lazarov”, në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbimit të shkencëtarëve të rinj, pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta etj. Bashkëpunimi do të nis me ftesën që i është bërë UBT-së për pjesëmarrjen në një konferencë shkencore që do të mbahet pas pak javësh në Sofje. Instituti i Mbrojtjes ‘Prof. Tsvetan Lazarov’ është një institut me karakter shkencor me ekspertizë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky institut është organ që funksionon në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, përkrahë nga strukturat shkencore në kuadër të NATO-s, BE-së dhe bashkëpunon me mbi 100 institucione të ndryshme shkencore në Bullgari dhe jashtë. Instituti ofron programe të karakterit mësimor-shkencor për fitim të titujve “Doktor” dhe “Doktor i Shkencave” në nëntë fusha: Dinamika, balistika dhe kontrolli i fluturimit të aeroplanëve; radiolokimi dhe radio-navigimi;

pajisjet radio-transmetuese dhe radio-pranuese; sistemet e automatizuara të procesimit dhe kontrollit të informacionit; pajisjet dhe metodat optike laserike; dizajnim dhe projektimi i automjeteve dhe aeroplanëve; metodat për kontrollin dhe testimin e materialeve, pajisjeve dhe makinerisë; teknologjia kimike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe teknologjia e informacionit dhe siguria kibernetike. Që nga viti 2009, në Institutin e Mbrojtjes është e vendosur edhe Akademia CISCO për trajnim të personelit ushtarak dhe civil për sisteme të Ministrisë së Mbrojtjes në teknologji të lartë të informacionit. Ekspertiza tjetër e Institutit është certifikimi i kualitetit të sistemeve dhe produkteve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes, regjistrimi dhe certifikimi i mjeteve dhe pajisjeve ushtarake dhe atyre policore. Instituti ka tri laboratore të akredituara nga Agjensioni Kombëtar i Bullgarisë i Shërbimeve të Akreditimit.

UBT nderohet me çmimin “Best Innovative Education 2021

UBT ka arritur një sukses tjetër jashtëzakonisht të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Si institucion lider në rajon për teknologji dhe inovacion, UBT është nderuar me çmimin “Best Innovative Education 2021” nga Annual Balkan Business Awards, në Sofje, për arritjet e pakrahasueshme në ofrimin e teknologjisë së re në edukimin CLASROOM 3.0 dhe për Smart University 4.0. Çmimi i është dorëzuar rektorit të UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, nga kryetarja e Komunes së Lovech, Kornelia Marinova, në një ceremoni solemne të mbajtur në Presidium Palace Hotel, me pjesëmarrje të personaliteteve të shumta, përfshirë edhe të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Kosovës në Bullgari, ambasadorin Delfin Pillana. Rektori Hajrizi ka thënë se kjo është një arritje e madhe për UBT-në dhe Kosovën, duke shtuar se UBT do të vazhdojë të kontribuojë në zhvillimin e

shkencës, inovacionit dhe teknologjisë në Kosovë dhe rajon. “Ky çmim është një arritje e çmuar për UBT-në, për përkushtimin e këtij institucioni në fushën e inovacionit dhe teknologjisë dhe vjen pas disa çmimeve tjera të rëndësishme që UBT ka marrë për arritje kulminante në disa prej kryeqendrave botërore”, u shpreh rektori Hajrizi. Rektori Hajrizi, përgjatë qëndrimit në Bullgari, nën shoqërimin e ambasadorit Delfin Pillana, në Bullgari, zhvilloi një takim zyrtar me Kryetaren e Komunes së Lovech, Kornelia Marinova, e cila shprehu gatishtësinë për të bashkëpunuar me UBT-në, drejt zhvillimit në fushën e inovacionit. Ky event organizohet për t’i nderuar të gjitha ato biznese të Ballkanit që edhe në kohë krize, arritën të kenë sukses në zhvillimin e qëndrueshëm dhe sigurimin e standardeve evropiane.

UBT hapi në Korçë qendrën më të madhe inovative dhe teknologjike në rajon

Korça e mësonjëtores së parë shqipe u bë me qendrën më të madhe inovative dhe teknologjike në rajon. Bibliotekës që mban emrin e folkloristit të njohur korçar, "Thimi Mitko", sot iu bë krah i fortë inovacioni dhe teknologjia. "UBT - Korça Innovation & Technology Hub", është një projekt i jashtëzakonshëm inovativ e teknologjik, i cili bën bashkë trashëgiminë e pasur kulturore dhe të ardhmen teknologjike. Kjo qendër, e para e këtij lloji në rajon, bën bashkë të kaluarën, përmes bibliotekës me fondin prej mbi 200,000 librash të ndryshëm dhe të ardhmen me mbi 90 projekte inovative e teknologjike të UBT-së. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, u shpreh në ceremoninë e hapjes së "UBT -Korça Innovation & Technology Hub" do të jetë model për inovacionin në biznes, teknologji e sipërmarrje për të gjithë të rinjtë e Korçës, si dhe do të jetë një ambient inovativ me teknologjinë më të avancuar të kohës. "Në Korçën e mësonjëtores së parë shqipe, ne sot po nisim një rrugë tjetër po kaq të rëndësishëm në fushën e dijes. Brenda ambienteve të bukura e moderne të bibliotekës së Korçës po e bëjmë



të mundur që trashëgimia jonë e pasur kulturore të bashkëjetojë me teknologjinë, me arritjet e saj kulminante. Po e bëjmë bashkë, nën një çati, të kaluarën dhe të ardhmen tonë. Po e bashkojmë dijen me teknologjinë. Po i sjellim Korçës dhe Shqipërisë, përmes inaugurimit të këtij inkubatori të biznesit digjital, inovacionin si katalizator për rritjen e biznesit dhe ekonomisë. Po i sjellim hapin e fundit të teknologjisë për të qenë në trend me arritjet e fundit teknologjike, jo si spektatorë, por si pjesë e këtyre arritjeve", u shpreh ai. Në këtë projekt madhor, ai tha se UBT me ek-

spertët e angazhuar, do të ofrojë mbështetje akademike dhe do të ketë rol kyç në hartimin e trajnimeve profesionale në gjuhë të ndryshme programuese, për temat që lidhen me zhvillimin e projekteve në fushën e digjitalizimit, inovacionit, punësimit të të rinjve dhe çështje të tjera për zhvillimin e biznesit e teknologjisë. "Përmes këtij Hub-i të madh të teknologjisë dhe inovacioni synojnë mundësinë unike për aftësimin, e mandej punësimin e të rinjve të Korçës, dhe në përgjithësi të të gjithë të rinjve me shpirt ndërmarrësi, nga Shqipëria dhe Kosova", ka thënë rektori Hajrizi. Rektori

Hajrizi falënderoi Bashkinë e Korçës dhe kryetarin e Bashkisë së Korçës, Sotirajq Filo, për mbështetjen e pakursyer në realizimin e këtij projekti inovativ. Nga ana e tij, kryetari Filo, tha se është i lumtur që tani Korça do të jetë qendër e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik. Ai shtoi se kjo është një rrugë e gjatë, që kërkon vullnet dhe punë të përdaluar në mënyrë që t'i ofrohet të rinjve të Korçës e ardhmja në teknologji, informacion dhe sipërmarrje. "Bashkë me UBT ne e kemi sjellë të ardhmen teknologjike në qytetin e Korçës por tani topi është në fushën e të rin-

jve e të rejave të qytetit për t'u angazhuar me shërbimet dhe mundësitë që ofron kjo qendër", ka thënë kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotirajq Filo. Në hapje të saj, Korça Innovation & Technology Hub, u vizitua edhe nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të cilit i uroi i pari mirëseardhje roboti Nao me fjalët: Mirësevjen kryeministër Rama. Kryeministri Rama u njoftua nga rektori i UBT-së me gamën e gjerë të projekteve inovative të "UBT -Korça Innovation & Technology Hub", përmes të cilave synohet gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe edukimi i inovatorëve të rinj, sipërmarrësve, drejtuesve të ardhshëm të ndryshimeve shoqërore në Shqipëri e më gjerë. Kryeministri Rama tha se krijimi i qendrave të tilla do të jetë prioritet në Shqipëri. "Në bibliotekën e re ultramoderne të Korçës, po merr jetë edhe qendra e re e mësimave të teknologjisë së lartë, për t'i futur të rinjtë në rrugën e punësimit në tregun global online, ku pa qenë aspak të detyruar të lëvizin nga vendlindja ata mund të krijojnë të ardhura të larta", u shpreh ai.

UBT mes institucioneve më të mira në botë për impaktin në zhvillimin e qëndrueshëm

Revista prestigjioze globale, Times Higher Education, ka publikuar renditjen globale të universiteteve bazuar në impaktin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm, Impact Rankings 2021. UBT, është renditur në këtë listë prestigjioze në gjysmën më të mirë të renditjes përkrah institucioneve me më shumë emër në botë, ndërsa është institucioni më i mirërenditur nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Me këtë pozicion UBT e vendos Kosovën për herë të parë në këtë renditje, duke treguar kështu edhe frytet e shkëlqyera të punës 20-vjeçare të UBT-së. Arritja e UBT-së është e rëndësishme pasi ajo ka lënë pas edhe institucione të arsimit të lartë të mirënjohura, me prestigj dhe traditë. Vlerësimi i impaktit të universiteteve në këtë listë bëhet përmes analizës së të dhënave që lidhen me Sustainable Development Goals (SDGs). UBT ka dorëzuar gjatë vitit të shkuar të dhënat e saj për zhvillimin e qëndrueshëm në të 17-a SDGs, ndërsa sot është vlerësuar lartë për punën e dedikuar si institucion i prirur drejt politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe impaktit si në Kosovë ashtu edhe në rajon. UBT është vlerësuar nga Impact Rankings 2021 për rezultate të larta në zbatimin e politikave të qëndrueshme në të cilat lidhen me industrinë, inovacionin dhe infrastrukturën



(SDG 9), kontributin për paqen, drejtësinë dhe institucione të forta (SDG 16), mirëqënien shëndetësore dhe fizike (SDG 3), partneritetin shumë-dimENSIONAL për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17) si edhe zhdukjen e varfërisë (SDG 1). Në veçanti, në këtë vlerësim UBT dallohet për impaktin për partneritetin shumë-dimENSIONAL për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17), ku përveç renditjes së shkëlqyer në këtë rankim, vlerësohet me notën më të lartë për impaktin në zhvillimin e kapaciteteve dhe strukturave për STEAM. Ky vlerësim i lartë nga Times Higher Education është një arritje e shkëlqyer e UBT-së, institucion lider i edukimit në Kosovë dhe rajon për inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kështu UBT konfirmon rolin e liderit për

marrjen e përgjegjësisë në funksion të zgjidhjes së problemeve aktuale dhe zhvillimit me qasje inovative, jo vetëm në Kosovë por edhe rajon e më gjerë. UBT synon që në të ardhmen të pozicionohet edhe më mirë në këtë renditje, edhe përmes thellimit të punës për funksionalizimin e plotë të UBT-së si një universitet i bazuar në një ekosistem inovativ. Lista e Impact Ratings 2021 kryesohet nga Universiteti i Manchester në Britaninë e Madhe, ndërkohë që Top 10 mbizotërohet nga universitete nga Australia dhe SHBA dhe Britania. Ndërkohë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk është renditur asnjë universitet tjetër nga Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Mali i Zi, me përjashtim të një universiteti nga Bosnje Hercegovina por me renditje më të ulët.

Rreth 130 profesorë të UBT-së pranojnë titujt akademikë nga rektori Hajrizi



Rreth 130 profesorë të profileve të ndryshme profesionale kanë pranuar tituj akademikë nga institucioni ku ata ligjërojnë, UBT, në një ceremoni solemne të mbajtur në kuadër të aktiviteteve me rastin e 20-vjetorit të themelimit të UBT-së. Titujt u ndanë nga vetë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ku janë dhënë si rezultat i produktivitetit dhe angazhimit të profesorëve në fushën e shkencës, njehërësh për avancimin e tyre dhe marrjen e titujve doktorë i shkencës. Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi është shprehur i lumtur me këtë arritje të profesorëve dhe të UBT-së, që sipas tij, tashmë institucioni po kalon në një periudhë tjetër ngaqë numri i profesorëve që janë doktorë shkencash vazhdon të rritet dukshëm. "Gjatë këtyre 20 viteve kemi filluar me profesorë ndërkombëtarë dhe më pas kemi huazuar profe-

sorë nga universitete tjera për të krijuar kuadro të reja. Tani me kalimin e kohës kemi arritur në një periudhë ku kemi stafin tonë të përbërë nga 900 profesorë, ku 300 prej tyre janë doktorë shkencash", potencoi rektori Hajrizi. Tutje, rektori Hajrizi theksoi edhe njëherë se UBT vazhdon të mbetet njëri nga institucionet më kredibile në rajon dhe më gjerë, duke konfirmuar cilësinë dhe lidërsipin që ka ky institucion. "Në 20-vjetorin e UBT-së, konfirmohemi edhe njëherë si një institucion serioz, lider dhe me cilësi të lartë, kjo vjen edhe nga partneriteti që kemi me universitetet e tjera prestigjioze nga e gjithë bota", shtoi ai. Teksa, rektori Hajrizi ka falënderuar të gjithë profesorët për angazhimin e tyre në gjenerimin e dijes dhe shpërndarjen e njohurive të studentët, të cilët i kanë besuar UBT-së zhvillimin e tyre akademik e profesional.

Siguria e informacionit dhe ndërtimi i kapacitetit të sigurisë kibernetike jetike për sigurinë e qytetarëve dhe të shtetit

Në prezencën e Gjeneral Major Hazrolli, oficerëve amerikanë të KFOR-it dhe stafit akademik të UBT-së, në Kampusin Inovativ të UBT-së, Koloneli dhe profesori izraelit prof. Gabriel Siboni, ka prezantuar mbi pikat kryesore të mbrojtjes kibernetike dhe sigurisë së integruar kombëtare, nga ku shpalosi ekspertizën e tij mbi bazat e sigurisë kibernetike dhe strategjive kombëtare të mbrojtjes së integruar.

Kolonel Siboni u shpreh se ndërtimi i një strategjie shtetërore për mbrojtjen nga sulmet kibernetike është shumë e rëndësishme për garantimin e sigurisë së një vendi. "Izraeli është një histori suksesi në ndërtimin e një mburoje virtuale dhe fizike ndaj sulmeve kibernetike,




se ka mundësuar që të identifikojë burimet e tyre në kohë. Kjo ka mundësuar që të trajnohen kapacitetet intelektuale dhe gjithashtu qytetarët e vendit për të mbrojtur të dhënat perso-

nale. Megjithatë mbrojtja kibernetike është një çështje komplekse dhe agjenturat e huaja janë gjithnjë në vëzhgim të mundësive për të shfrytëzuar pikat e dobëta të sistemeve të informacionit

për sulmet e tyre", tha prof. Gabriel Siboni. Sipas tij, Kosova si çdo shtet tjetër duhet t'i japë përparësi sigurisë kibernetike dhe ta integrojë atë thelbësisht në strategjinë kombëtare të mbrojtjes,

me synim mbrojtjen e shtetit dhe të qytetarëve. "Meqenëse sot jetojmë në një shoqëri të informacionit, duhet kuptuar se menaxhimi sa më i sigurtë i informacionit, sidomos atij personal e shtetëror, përmes bashkëpunimit të shtetit me të gjithë akterët kombëtarë e ndërkombëtarë të interesit, është kyç për një shoqëri të sigurtë", potencoi prof. Siboni. Koloneli dhe profesori izraelit, prof. Gabriel Siboni përmbylli vizitën e tij në UBT dhe Kosovë, ku përmes kontributit të tij, jo vetëm që është hedhur themeli për një urë të re bashkëpunimi akademik mes Kosovës dhe Izraelit, por UBT tanimë gëzon një ekspertizë më të gjerë në këtë fushë me rëndësi për shoqërinë tonë.

Ambasadori i BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca, vizitoi "Korça Innovation and Technology Hub"



Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Luigi Soreca, bashkë me ambasadorën e Mbretërisë së Holandës, Guusje Korthals Altes, kanë vizituar qendrën më të madhe të teknologjisë dhe inovacionit në Korçë, "Korça Innovation and Technology Hub", e cila menaxhohet nga UBT. Ambasadorët janë mirëpritur nga kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraj Filo, dhe përfaqësues të Hub-it të teknologjisë dhe inovacionit në Korçë, ku janë njoftuar nga afër me infrastrukturën tejet moderne të Hub-it teknologjik dhe punën

intensive që të rinjtë e qytetit të Korçës po e bëjnë brenda kësaj qendre, përfshirë aktivitetet e shumta dhe trajnimet e ndryshme.

"Korça Innovation and Technology Hub" është qendra më e madhe në rajon e këtij lloji e cila u ofron të rinjve programe moderne, aktivitete inovative, hapësira pune, trajnime profesionale, që me gërshetimin e të gjitha mundësive që ofron ky Hub, krijon një komunitet inovativ.

UBT shembull i suksesit në fushën e inovacionit dhe kreativitetit

Dita Botërore e Kreativitetit dhe Inovacionit e gjen UBT-në si institucioni më inovativ në vend, rajon dhe më gjerë, duke aplikuar teknologjitë më inovative dhe të fundit të kohës, e që për nder të 20-vjetorit të institucionit, UBT Kosovës do i sjellë 20 inovacione për vitin 2021.

UBT për 20 vite me radhë ka qenë burim i kreativitetit, ideve të reja, si në shkencë ashtu edhe në teknologji, duke kontribuar jashtëzakonisht shumë në inovacionin në Kosovë.

UBT ka krijuar Qendrën më të madhe të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë: "UBT Smart City", e cila është qendra më unike dhe e para e këtij lloji në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor e që do të mundësojë rritjen e vendeve të punës,

ndërmarrësisë, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, UBT, ka sjellë në Kosovë realitetin virtual, duke u bërë institucioni i parë nga mbarë bota për nga aplikimi i EON-XR në arsim. Me platformën e realitetit virtual, mijëra studentë të UBT-së përfituan mbi 20 mijë mësimë bazuar në më shumë se 120 mijë gjëra të krijuara, nga fusha të ndryshme studimi.

Inovacioneve të shumta që UBT ka sjellë për shoqërinë, së fundmi, i është shtuar edhe Qendra e Inovacionit dhe Teknologjisë "Korça Innovation & Technology Hub", që është qendra më e re në rajon që posedon të gjitha komponentat e nevojshme në frymën e teknologjisë, e që ofron hapësira pune për të gjithë të rinjtë

e qytetit të Korçës.

UBT përmes Nokias, Kosovës i solli gjeneratën e pestë të teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela, 5G, duke mundësuar zhvillimin e kërkimit dhe testimit të bazuar në 5G, për shumë raste të drejtuara nga teknologjitë përkatëse Internet of Things (IoT) dhe AI, si përpjekje për të nxitur kërkime dhe inovacione të shumta. Kjo teknologji e fundit përbën një zhvillim shumë të rëndësishëm për Kosovën në ekonominë digjitale të vendit.

UBT po përgatit profesionalisht inovatorët e së ardhmes, të cilët me kompetencat e larta krijuese dhe idetë e tyre inovative, të motivuar do të krijojnë biznese, organizata joqeveritare, dhe në këtë mënyrë do ta bëjnë Kosovën një vend më të mirë.

UBT e përkushtuar për të drejtat e pronësisë intelektuale

UBT vazhdon të jetë e përkushtuar në forcimin e ligjshmërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave pronësisë intelektuale. UBT është i vetmi institucion arsimor që ka themeluar Qendrën për Transferimin e Teknologjisë, e cila i ndihmon studentët

që t'i mbrojnë shpikjet e tyre nëpërmjet ushtrimit të të drejtave mbi pronësinë intelektuale. Në Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, UBT u bën thirrje të gjithë studentëve për të punuar sa më shumë në shpikje të reja dhe për të patentuar idetë

dhe produktet që i kanë.

Është tejet e rëndësishme që sot të mbrojmë idetë dhe krijimet inovative në mënyrë që në këtë formë të nxitet inovacioni dhe krijimtaria tek të gjithë të rinjtë.

UBT rikonfirmohet si institucioni me performancë të jashtëzakonshme për cilësi EFQM

UBT edhe njëherë është rikonfirmuar si institucioni që ka treguar performancë të jashtëzakonshme në zbatimin e modelit EFQM për cilësi dhe performancë, duke u renditur në 1-2% të institucioneve në mbarë botën që janë të certifikuar në The European Founda-

tion for Quality Management (EFQM). Ekspertët ndërkombëtarë të Fondacionit Evropian për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM) kanë vlerësuar lartë kontributin e UBT-së për nivelin e menaxhimit të cilësisë, duke e cilësuar UBT-në si institucion model në zbatimin e standardeve

të EFQM. "Jemi shumë të kënaqur që UBT vazhdon të përdorë modelin EFQM. Ju keni qenë implementues të shkëlqyeshëm për shumë vite të modelit EFQM, dhe jeni në krye të 1-2% të organizatave të të gjithë botës që keni kontribuar në fuqizimin

e EFQM si model në 25 vitet e fundit. Kjo është një performancë e jashtëzakonshme", thuhet në letrën e dërguar nga përfaqësues të Fondacionit Evropian për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM), drejtuar rektorit të UBT-së, prof.dr. Edmond Ha-

grizi. UBT është lider në implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për cilësi, dëshmuar dhe vlerësuar nga The European Foundation for Quality Management (EFQM) me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje.

UBT hap një dritare të re për studime të doktoratës në fushën e sigurisë

Një mundësi e jashtëzakonshme për studime të doktoratës në fushën e sigurisë është bërë e mundur nga UBT, përmes arritjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin e Mbrojtjes "Profesor Tsvetan Lazarov", me seli në Sofje të Bullgarisë.

Marrëveshja u nënshkrua në një ceremoni solemne nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori i Institutit të Mbrojtjes, kol.dr. Dimitar Kirkov, në prani të ambasadorit të Republikës së Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, e vlerësoi lartë arritjen e kësaj marrëveshjeje, duke e parë atë si kontribut të madh për avancimin e përgjithshëm të Kosovës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si një prej shtyllave të shtetit dhe të çdo institucioni tjetër të rëndësishëm në vend.

"Kosova do të ketë mundësinë tani që të ketë njerëz të kualifikuar me tituj të lartë shkencor në nëntë fusha të ndryshme që ndërliken me sigurinë dhe mbrojtjen. Nga kjo mundësi e re do të mund të përfitojnë, punonjësit e çdo institucioni të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë për të avancuar dijen e tyre në këto fusha, si dhe për ta rritur performancën dhe ekspertizën e institucionit ku ata punojnë", tha rektori Hajrizi.

Drejtori i Institutit të Mbrojtjes, kol.dr. Dimitar Kirkov u shpreh i lumtur me arritjen e kësaj marrëveshjeje, teksa



njoftoi se ofrojnë programe shkencore edhe për kandidatë nga vendet e tjera, si dhe janë të hapur për bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës për të ofruar mundësi trajnimi dhe shkollimi për kandidatë të interesuar nga Kosova.

Me marrëveshjen e arritur në mes të UBT-së dhe Institutit të Mbrojtjes "Profesor Tsvetan Lazarov", të gjithë ata që duan të vazhdojnë studimet post-diplomike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes do t'i vijojnë ato në nëntë fusha të cilat janë deficitare për Kosovën.

Instituti ofron programe të karakterit mësimor-shkencor për marrjen e titujve Doktor dhe Doktor i Shkencave në këto fusha: Dinamika, balistika dhe kontrolli i fluturimit të aeroplanëve;

Radiolokimi dhe radio-navigimi; Pajisjet radio-transmetuese dhe radio-pranuese; Sistemet e automatizuara të

procesimit dhe kontrollit të informacionit; Pajisjet dhe metodat optike laserike; Dizajnimi dhe projektimi i automjeteve dhe aeroplanëve; Metodat për kontrollin dhe testimin e materialeve, pajisjeve dhe makinerisë;

Teknologjia kimike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes; Teknologjia e informacionit dhe siguria kibernetike. Marrëveshja e bashkëpunimit midis UBT-së dhe Institutit "Profesor Tsvetan Lazarov" është një hap i radhës i UBT-së për rritjen e ekspertizës për edukimin dhe kërkimin shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ky institut duke funksionuar në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Bullgarisë, gëzon një ekspertizë të rëndësishme në shkencat e mbrojtjes e sigurisë. Duke marrë parasysh perspektivën Euro-Atlantike të vendit, UBT vazhdon të jetë institucion pararojë në promovimin dhe

mbështetjen e kësaj perspektive në vend.

Marrëveshja midis dy institucioneve do të mundësojë praktikën e shkëmbimit të stafit për programe me interes të përbashkët si edhe shkëmbim të studentëve midis tyre. Përmes kësaj marrëveshjeje do të synohet rritja e bashkëpunimit shkencor dhe edukativ jo vetëm midis UBT-së dhe Institutit të Mbrojtjes, por edhe midis studentëve dhe akademikëve të Kosovës dhe Bullgarisë.

Marrëveshja midis dy institucioneve, po ashtu, synon të promovojë:

Shkëmbimin e stafit në programe të interesit të përbashkët;

Shkëmbimin e studentëve në programe studimi me interes të përbashkët;

Bashkëpunim në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe zhvillim dhe shërbime konsultimi; Shkëmbimin e materia-

leve shkencore dhe akademike të publikuara;

Ofrimin e mundësive për rritjen e kapaciteteve kulturore dhe intelektuale për stafin dhe studentët e të dyja palëve.

Që nga viti 2009 në Institutin e Mbrojtjes është e vendosur edhe Akademia CISCO për trajnim të personelit ushtarak dhe civil për sisteme të Ministrisë së Mbrojtjes në teknologji të lartë të informacionit. Ekspertiza tjetër e Institutit është certifikimi i kualitetit të sistemeve dhe produkteve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes, regjistrimi dhe certifikimi i mjeteve dhe pajisjeve ushtarake dhe atyre policore. Ndër të tjera, instituti ka tri laboratore të akredituara nga Agjencia Kombëtare e Bullgarisë e Shërbimeve të Akreditimit. Programet e institutit ofrohen në gjuhën angleze dhe të gjithë kandidatët e interesuar do të kenë qasje në mentorim profesional sipas kërkesës dhe temës specifike të cilën duan ta hulumtojnë.

Ky institucion shkencor i mbrojtjes me ekspertizë të pasur në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë funksionon në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Bullgarisë dhe mbështetet nga strukturat shkencore në kuadër të NATO-s dhe BE-së duke ofruar një gamë të madhe bashkëpunimi me mbi 100 institucione të ndryshme shkencore në Bullgari dhe jashtë.

UBT - institucioni me më së shumti partneritete ndërkombëtare

Lidhjet dhe partneritetet e shumta që UBT i ka me universitetet më prestigjioze të botës kanë bërë që të rinjtë kosovarë të kenë mundësi të shumfishta për të studiuar, punuar dhe udhëtuar në arenën ndërkombëtare.

Tashmë Kosova e ka një ambasador të fuqishëm të arsimit të lartë në arenën ndërkombëtare, UBT-në, që po e përfaqëson denjësisht në garat e konferencat më të mëdha të botës.

Qindra universitete prestigjioze i thanë: "Po!" bashkëpunimit të ngushtë me UBT-në dhe Kosovën, duke bërë që studentëve tanë t'u hapet një derë e mundësive për të marrë njohuri nga profesorë dhe ekspertë ndërkombëtarë, kështu duke pasur një shans të artë për të njohur edhe kulturat e shteteve të ndryshme.

Me formimin e partneriteteve ndërkombëtare me universi-

tetet më të njohura të botës, UBT përveç shkëmbimit të studentëve, po jep një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës, inovacionit e teknologjisë, duke krijuar edhe programe të përbashkëta studimi. Vendet që studentët i kanë ëndërruar për t'i vizituar, UBT u ka dhënë shansin që edhe të studiojnë dhe eksplorojnë në aspektin shkencor, të marrin pjesë në shkollat verore të universiteteve të ndryshme, duke e bërë kështu edhe më unik dhe interesant rrugëtimin e tyre akademik. UBT nuk është vetëm numër, por është cilësi akademike dhe shkencore, cilësi që studentëve u hap dyer brenda dhe jashtë vendit për tregun e punës, dhe i bën ata profesionistë e ekspertë për të zgjidhur problemet dhe sfidat në fushën që ata kanë zgjedhur në rrugëtimin e tyre në karrierë.

Studentët e UBT-së priten nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana



Studentët e UBT-së që janë duke vazhduar studimet në Universitetin Teknik të Sofjes në Bullgari, në kuadër të programit Erasmus+, kanë zhvilluar një vizitë në ambasadën e Republikës së Kosovës në Bullgari, ku janë pritur nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana.

Në cilësinë e udhëheqëses shkencore të studentëve, bashkë me studentët e UBT-së, në vizitë ishte edhe pro-

fesoresha e Universitetit Teknik të Sofjes, Galia Marinova, e cila vlerësoi angazhimin dhe punën e tyre, teksa ka falënderuar UBT-në për bashkëpunimin dhe mundësinë që po u jep studentëve për studime të përbashkëta.

Ndërkaq, ambasadori i Republikës së Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana, ka falënderuar profesoreshën dhe studentët për vizitën e bërë, duke thënë se bash-

këpunimet e tilla të suksesshme janë një arsyeje shtesë për të punuar edhe më shumë në shkëmbimin e studentëve mes këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë. Sipas ambasadorit Pllana, kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur janë parasysh specifikat e profilit studimor, siç është teknologjia informative, një sektor që është promotori kryesor i zhvillimit të çdo segmenti tjetër.

Hapet ekspozita “Si u vra Kodi Etik i Hipokratit dhe si u shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës”

Në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës, është hapur ekspozita “Si u vra Kodi Etik i Hipokratit dhe si u shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës”, e autorit prof.dr. Salih Krasniqi, organizuar dhe mbështetur nga UBT.

Kjo ekspozitë është përmbledhur përmes 250 fotografive, të cilat janë vendosur brenda Muzeut Kombëtar të Kosovës, e që shpërfaqin terrorin dhe gjenocidin që forcat serbe dhe një pjesë e personelit shëndetësor serb kanë kryer mbi pacientët shqiptarë.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka falënderuar profesorin Krasniqi për punën e bërë, duke mbledhur fakte për atë që ka ndodhur në Kosovë në periudhën 1998-1999.

“Profesori Krasniqi është dëshmitar i dhunës, krimeve dhe gjenocidit, ku ai përveç trajtimit dhe intervenimeve kirurgjike të qindra pacientëve që kishte kryer në atë kohë, sot po sjellë para nesh fakte dhe prova të pakontestueshme për krimet më mizore të kryera nga forcat serbe në Kosovë”, ka thënë rektori Hajrizi.

Nën emocione të kujtesës së çfarë kishte përjetuar 23



vite më parë, Arsim Hasimi, pacient i prof.dr. Salih Krasniqi gjatë luftës në Kosovë, tha se kontributi i profesorit Krasniqi në atë kohë ishte shumë i madh, dhe se kjo ekspozitë më së miri shpalos vuajtjet që kanë përjetuar në atë periudhë. “Në vitin 1998 forcat serbe mua më kanë plagosur shumë rëndë dhe ato vuajtje që kam përjetuar nuk i harroj kurrë. Dr. Salih Krasniqi bashkë me dr. Sadri Bajraktarin dhe të tjerët më kanë ndihmuar shumë, mirëpo forcat serbe vazhdimisht na hapnin plagët të cilat doktorët e nderuar na i kuronin”, ka thënë Arsim Hasimi.

Profesor Ismet Salihu, bash-

këpunëtor i profesor Krasniqi, ekspozitën “Si u vra Kodi Etik i Hipokratit dhe si u shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës” e vlerësoi jashtëzakonisht të rëndësishme, duke theksuar se ajo që kjo ekspozitë shpalosë, me të gjitha konventat ndërkombëtare cilësohen si krime ndaj njerëzimit. “Kjo ekspozitë është jashtëzakonisht e rëndësishme, ekspozitë në të cilën shpërfaqën krimet makabre të regjimit serb ndaj mjekëve, personelit mjekësor dhe ndaj pacientëve. Me emër dhe mbiemër në këtë ekspozitë janë të shënuar 19 doktorë, mjekë, dhe 26 infermierë dhe personel tjetër

mjekësorë të cilët gjatë luftës u vranë nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe”, tha profesor Salihu. Profesor Halim Hyseni, bashkëpunëtor i profesor Krasniqi, ka thënë se çështja e viktimave të terrorit serb është e vonuar pasi që sipas tij 20 vite në mënyrë institucionale ka pasur heshtje ndaj këtij terrori të bërë, e që ka fakte përmes librave që janë punuar nga autor të ndryshëm. “Ka njerëz të cilët kanë punuar jashtëzakonisht shumë në këtë fushë dhe kemi libra të cilët kanë punuar shumë. Kërkoj nga qeveria me ngulm, që Ministria e Arsimit, Ministria e

Kulturës, Ministria e Jashtme, të punojnë me një zell krejt tjetër çfarë kanë punuar deri sot, që t’i kenë librat e botuara për gjenocidin serb dhe ky libër i profesor Krasniqi të përkthehet në 11 gjuhë, dhe të jetë në secilën ambasadë të Republikës së Kosovës, në mënyrë që asnjë ministër, askush që shkon në bisedime me Serbinë të mos shkojë pa këto libra”, tha profesor Halim Hyseni.

Prof.dr. Salih Krasniqi i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët e tij për këtë ekspozitë

“Ju përsëritës të gjithëve, në veçanti pacientët që kanë ardhur nga të gjitha trevat për këtë ekspozitë, personelin shëndetësor me të cilët kam punuar, profesor Sadri Bajraktarin, si dhe të tjerët, të cilët më kanë ndihmuar shumë që këta pacientë sot t’i shoh këtu”, ka thënë prof. dr. Salih Krasniqi.

Ekspozita “Si u vra Kodi Etik i Hipokratit dhe si u shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës” do të jetë e hapur deri më 29 maj, në Muzeun Kombëtar të Kosovës.

Rektori Hajrizi prezanton formulën e re të financimit për arsimin profesional



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në Samitin e Arsimit dhe Afërsimit Profesional – VET Samiti, ku ka prezantuar formulën e financimit të arsimit profesional dhe për mënyrën e ndërlidhjes së arsimit profesional me sektorin privat, formulë kjo e zhvilluar nga UBT për programin ALLED2, finan-

ciuar nga Komisioni Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

Përgjatë prezantimit, rektori Hajrizi theksoi se formula financiare për sistemin arsimor vjen si nevojë e sistemit, dhe se planifikimi financiar duhet bazuar në indikatorë që përfaqësojnë nevojat për shkollat, ndaj sipas rektorit Hajrizi kjo

shërben edhe si një mjet simulimi për skenar të ndryshëm të financimit.

“Propozimi për formulën financiare për arsimin profesional në Kosovë del si nevojë e akceptimit pak më ndryshe të arsimit profesional sepse i ka disa karakteristika më specifike të cilat duhet të trajtohen. Ne jemi munduar ta ndjekim tërë zingjirin e furnizimit, nga klasa e deri te praktika, përfshirë këtu edhe të gjitha komponentët e nevojshme duke i definuar ato, dhe në bazë të kësaj kemi parë se një formulë e tillë e financimit me një ristrukturim pak më ndryshe dhe adaptim më ndryshe, mund të mbetet prapë në ngjyrën e njëjtë të ligjeve dhe rregulloreve pa ndryshuar dhe komplikuar konceptin legal”, ka thënë rektori Hajrizi.

Dokumenti i quajtur “Planifikimi Financiar për Sistemin e AAP-së në Kosovë – Propozim për Përmirësim”, publikuar nga programi ALLED2 dhe prezantuar nga rektori Hajrizi shtjellon në detaje skenarët të cilët duhet ndjekur për një zgjidhje efektive, duke sjellë analiza dhe rekomandime të opsioneve të ndryshme të mundshme rreth financimit të AAP-së në Kosovë, brenda kornizës legislative ekzistuese.

Rektori Hajrizi ka thënë se UBT shquhet për kontributin e dhënë për arsimin dhe edukimin profesional, sidomos në fushën që lidhet me STEAM, në ngritjen e infrastrukturës moderne për këtë lloj arsimit, si dhe për sjelljen e praktikave më të mira austriake, gjermane, zvicerane, e të shteteve të tjera të botës.

“Arsimi profesional zë një vend të merituar në ekosistemin inovativ që ne po e ndërtojmë në Parkun Shkencor Inovativ, por edhe në qendrat e tjera nëpër regionet e Kosovës dhe Shqipërisë. Mekatronika, energjia, robotika, ICT, ndërmarrësia, ndërtimi, arkitektura, dizajni industrial, shëndetësia, ushqimi, turizmi, menaxhimi i projekteve e shumë programe të tjera, për herë të parë në Kosovë janë zhvilluar në UBT”, ka thënë rektori Hajrizi.

Ky samit është duke u mbajtur për herë të parë në Kosovë, me qëllim diskutimin mbi rolin kyç të arsimit dhe aftësimin profesional në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës, organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me Fondacionin BESA.

UBT-së i akreditohen 22 programe të trajnimit profesional të mësimdhënësve

Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ka akredituar UBT-së 22 programe të trajnimit profesional të mësimdhënësve, që synojnë ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënimit në fushën e arsimit në vend. Këto programe trajnimi ofrojnë një qasje inovative që synojnë avancimin e personelit akademik, duke sjellur ide të reja që i përshtat-

en nevojave dhe interesave të të gjitha profileve të mësimdhënësve. Programet e trajnimit të miratuara nga MASH : Abuzimi i fëmijëve; Roli i mësimdhënësve në identifikim, raportim dhe përkrahje; Bazat e sigurisë në teknologjinë informative; Bazat e sigurisë së të dhënave; Gjuhë angleze; Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në

edukim; Integrimi i shkathtësive të buta në mësimdhënie I Integrimi i shkathtësive të buta në mësimdhënie II Inteligjenca e shumëfishtë tek fëmijët; Menaxhimi efektiv në klasë; Menaxhimi i projekteve; Mësimdhënia e aftësive të shekullit XXI; Mësimi online; Motivimi i adoleshentëve dhe sfidat në edukim; Nxënës të ndryshëm


dhe nevoja të ndryshme të të nxënimit gjatë procesit të mësimdhënies; Orientimi në karrierë dhe zhvillimi profesional; Prezantimi profesional; Qasja e mësimdhënësve tek fëmijët me nevoja të veçanta; Shkrimi akademik në shkollë; Të mësuarit përmes projekteve; Të nxënimit bashkëveprues përmes kompjuterit; Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijëve

të moshave 3-6; Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijëve të moshave 6-12;

UBT në vazhdimësi ka ofruar një numër të madh të trajnimeve dhe shkollave profesionale, të licencuara nga shkolla profesionale ndërkombëtare, me ekspertë vendor e ndërkombëtarë.

UBT dhe University of Cambridge sjellin në Kosovë qendrën e parë të politikave publike

Institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, UBT, në bashkëpunim me University of Cambridge, po sjellin në Kosovë për herë të parë qendrën: "Public Policy Simulation Lab", e cila është qendra e vetme në tërë Evropën Juglindore. Në bashkëpunimin mes UBT-së dhe University of Cambridge, parashihet ndërtimi i kapaciteteve në fushën e politikave publike, ngritjen e nivelit të qasjes sisteme, studimin, analizën dhe simulimin në fushën e politikave publike. Ky bashkëpunim, sjellë këtë qendër në kuadër të 20 inovacioneve për 20-vjetorin e UBT-së, që do të ketë benefite të mëdha për studentët e UBT-së, me fokus ata të shkencave politike, politikave publike, ekonomisë e inxhinierisë. Ndër të tjera, nga kjo mar-



rreveshje e UBT-së me University of Cambridge, do të përfitojnë edhe profesionistët dhe akademikët e UBT-së, por edhe do të jetë një mbështetje edhe për Qeverinë e Kosovës, nivelin lokal të qeverisjes, si dhe për organizatat e ndryshme të cilat kanë nevojë për ndihmë në këtë fushë. Rektori i UBT-

së, prof.dr Edmond Hajrizi ka thënë se kjo marrëveshje është jashtëzakonisht e rëndësishme, jo vetëm për UBT-në, por për të gjithë Kosovën, duke krijuar një potencial tashmë të ri për t'i dhënë përgjigje gjendjes aktuale mbi politikën publike, teksa ka theksuar se do të bashkëpunojë me të gjitha palët e interesit në Kosovë, që kanë për fokus forcimin e politikave publike.

"Ne do të bashkëpunojmë ngushtë me palët e interesit me fokus te pjesa e qeverisë në Kosovë, qeverisjes së politikave publike, shërbyesve civil, dhe bashkë me ta, me pjesën akademike të UBT-së do të krijojmë një ekosistem, të cilin besoj se do të sjellë ngritje të cilësisë së politikave publike dhe vlerave që lidhen me një kualitet më të mirë të jetës", ka thënë rektori Hajrizi. Ky projekt i përbashkët mes UBT-së dhe University of Cambridge, i cili është vazhdimësi i një marrëveshjeje paraprake, do të ofrojë shumë mundësi për shkëmbimin e përvojave mes profesorëve e studentëve tanë me University of Cambridge. Menaxhimi i politikave publike dhe dizajnimi i tyre është fokusi i këtij projekti, teksa vlerësohet të jetë një nga projektet më të rëndësishme të realizuara ndonjëherë në Kosovë, që do të luaj rol kyç në vlerësimin e politikave publike dhe ndikimin që këto politika mund ta kenë në jetën e qytetarëve.

Kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo, vizitoi Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

Kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo, bashkë me delegacionin e tij nga Korça, kanë qëndruar për vizitë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, ku janë pritur nga rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi. Në këtë vizitë bërë njërit prej kampuseve dhe qendrave më inovative që njeh vendi dhe mbarë rajoni, sa i përket fushës së arsimit, shkencës dhe teknologjisë, rektori Hajrizi e njoftoi kryetarin e Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo, me stafin dhe studentët, punën dhe kontributin që është duke e dhënë UBT për zhvillimin e shkencës dhe arsimit në vend. Kryetari i Bashkisë së Korçës,

pa nga afër procesin akademik, punën shkencore të UBT-së, angazhimin e stafit, bibliotekën universitare, si dhe teknologjitë më të fundit të gërshetuara me infrastrukturën më moderne të UBT-së. Ndërkaq, rektori Hajrizi, është shprehur i lumtur me prezencën e të parit të Bashkisë së Korçës, duke thënë se bashkëpunimi me Korçën në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit do të vazhdojë edhe më tutje, me qëllim që studentëve tanë t'u ofrohen kushtet më moderne që të gjithë të rinjtë e botës i kanë.

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, vizitoi Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka qëndruar për vizitë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, ku është pritur nga rektori i këtij institucioni të arsimit të lartë, prof.dr Edmond Hajrizi. Në këtë vizitë, bërë njërit prej kampuseve më inovative në vend dhe rajon, Muhaxheri pa për së afërmi punën dhe angazhimin që UBT është duke e bërë në zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit me theks të veçantë nxjerrjen e kuadrove profesionale për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës. Ndër të tjera, rektori Hajrizi i shpalosi kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, konceptin e gjenerimit të dijes



përmes gërshetimit unik të teorisë me praktikën brenda UBT-së, përmes laboratorëve dhe fabrikave, si dhe jashtë UBT-së, përmes bashkëpunimeve me industrinë. Kryetari i Komunës së Pejës,

Gazmend Muhaxheri, pa nga afër konceptin "Smart City", gjeneratën e pestë të rrjeteve celulare pa tela 5G, realitetin virtual, spitalin universitar, si dhe bibliotekën më të madhe në vend.

UBT arrin nivelin më të lartë në Positive Impact Rating Edition 2021

UBT u vlerësua për ndikimin shoqëror dhe arritjet e qëndrueshmërisë pas publikimit të rezultateve nga Positive Impact Rating - PIR në Forumin Global të Parimeve për Menaxhim të Përgjegjshëm të Edukimit - Principles for Responsible Management Education- UN PRME. UBT është një nga 47 shkollat e biznesit nga 21 vende të botës që morën pjesë në vlerësimin e këtij viti dhe arriti nivelin e pestë, duke e bërë UBT-në një shkollë pioniere që përmbledh angazhimin e saj për ndikim në shoqëri, duke qenë institucion unik brenda Positive Impact Ranking - PIR. PIR është një vlerësim i kryer nga studentët dhe për studentët, nga ku për herë të dytë, studentët në mbarë

botën vlerësuan shkollat e tyre të biznesit se si ata e perceptojnë ndikimin e tyre pozitiv në botë. Ndikimi pozitiv i shkollave të biznesit shkon përtej kontributit të tyre në biznes dhe ekonomi, duke adresuar nevojën për ndikimin e tyre pozitiv në shoqëri. "Gjatë këtyre dy viteve të studimeve në UBT, unë kisha mundësi të zhvillojë njohuritë e mia akademike dhe të trajnohem në mënyrën më të mirë të mundshme për profesionin tim", tha Fortesë Qerimi, studente në UBT. Studentët vlerësuan se si UBT adreson sfidat shoqërore dhe të qëndrueshme dhe i përgatit ata të jenë udhëheqës të përgjegjshëm të biznesit. Mbledhja e të dhënave në UBT u organizua dhe u drejtua nga

Këshilli Studentor i UBT-së, të cilët shpërndanë studimin PIR në të gjithë kampusin. Këtë vit, 260 studentë iu përgjigjën sondazhit të vlerësimit të UBT-së, teksa pjesëmarrja në Positive Impact Rating - PIR dëshmon vlerën që UBT i jep zërit të studentëve. "Të gjitha këto rankime që kemi marrë në kohët e fundit janë një vlerësim për kontributin tonë dhe ndikimin që UBT ka dhe po bën për vendin. Prandaj edhe vlerësimi se ne jemi pionier dhe jemi unik e inovativ na ngritë motivimin për të bërë edhe më shumë. Natyrisht jemi shumë të lumtur që ne jemi listuar në pozita të larta, si dhe kemi sjellë Kosovën në këtë pozitë. Modeli modern i UBT-së, si një universitet i bazuar në një

ekosistem inovativ dhe me një ndërmarrësi të qëndrueshme e me përgjegjësi sociale, ka bërë që puna e UBT-së të vlerësohet në rank botëror", tha prof.dr Edmond Hajrizi - rektor i UBT-së. Sondazhi i vlerësimit u parashtron studentëve 20 pyetje në shtatë dimensione përkatëse të ndikimit që qëndrojnë brenda tre fushave: aktivizmi, edukimi dhe angazhimi. Rezultati i përgjithshëm PIR i shkollës së biznesit përdoret për të pozicionuar shkollat në pesë nivele. Nivelet e ndryshme i referohen fazës së zhvillimit të shkollës së biznesit, duke e vlerësuar atë sipas një niveli të caktuar të arritjeve. Shkollat e biznesit pajisen me një ndikim të përcaktuar shoqëror dhe një mjet

që ata mund ta përdorin për ndryshim. "PIR është krijuar si një mjet për të përmirësuar dhe transformuar edukimin e biznesit. Kjo u mundëson shkollave të kuptojnë se cili është ndikimi pozitiv për shoqërinë, sipas studentëve të tyre. PIR thekson potencialin për përmirësim, madje edhe për shkollat kryesore", tha Katrin Muff - presidente e Positive Impact Rating - PIR. PIR u krijua nga ekspertë të interesuar të shkollës së biznesit së bashku me OJQ globale - WWF, Oxfam dhe UN Global Compact. Shoqatat ndërkombëtare të studentëve oikos, AIESEC dhe Net Impact janë gjithashtu pjesë e PIR, e cila mbështetet nga VIVA Idea dhe Fehr Advice.

Në UBT arrijnë pajisjet e 5G, të parët në rajon



UBT është bërë institucioni i parë në rajon që ka marrë licencën dhe tani instalon pajisjet 5G. Pajisjet e teknologjisë së fundit që mundësojnë shtrirjen e rrjetit 5G, për herë të parë në rajonin tonë, arritën të premtën në Parkun Shkencor dhe Inovativ të UBT-së. “Në UBT sot nuk ka pyetje të lehta, as gjëra sipërfaqësore në fushën e dijes, shkencës e teknologjisë. Ne shkojmë përtej kësaj, hulumtojmë më thellë dhe bëjmë pyetje të mëdha që ndërlidhen me të ardhmen, me inteligjencën artificiale si sf-

iduese e kohës, ku rol qendror do të ketë rrjeti 5G që do ta lansojmë së shpejti”, u shpreh rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi me këtë rast. Ndryshe, UBT po implementon suksesshëm marrëveshjen me kompaninë finlandeze të telekomunikacionit “Nokia”, për vendosjen e rrjetit 5G, që mundëson shtrirjen e gjeneratës së pestë të teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela që njihet si e ardhmja e internetit. Marrëveshja do t'i sigurojë UBT-së lidhjen wireless 5G SA, që do të mundësojë zhvillimin e kërkimit dhe testi-

mit të bazuar në 5G, për një numër rastesh përdorimi të drejtuara nga teknologjitë përkatëse Internet of Things (IoT) dhe AI, si pjesë e përpjekjeve për të nxitur kërkime dhe inovacione.

UBT po mbështetë të rinjtë dhe të rejtat në ambicjet e tyre për të krijuar një shoqëri të dijes, duke punuar me institucione publike e private për të vendosur infrastrukturën e nevojshme që mbështetë kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin.

Licencohet shkolla e mesme e lartë gjimnazi “UBT”

Ekosistemit gjigant të dijes, që është i ndërthurur me shkencë, teknologji dhe inovacion, i është shtuar edhe një vlerë tjetër e rëndësishme e arsimit që do të nxjerr gjenerata të reja të arsimuara në nivelet më të larta në vendin tonë.

UBT, tashme i dëshmuar si një institucion që po bën ndryshimin në vend sa i përket fushës së arsimit është licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të nxjerr gjenerata të reja të nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, duke shkuar kështu

edhe një hap me tutje drejt kompletimit të ekosistemit inovativ të UBT-së. Sipas vendimit të MASHTI, institucioni arsimor gjimnazi “UBT” i plotëson kushtet dhe kriteret për zhvillimin e ofrimin e veprimtarisë edukativo- arsimore për nivelin e mesëm të lartë me një cikël shkollor për tre vite.

UBT ofron modelin më të ri të të mësuarit CLASSROOM 3.0 të shkollave të mesme si dhe ofron praktikën më të njohura ndërkombëtare të mësimdhënies, për zhvillimin e mësimin të mesëm të lartë.



UBT sjell në Prizren qendrën e teknologjisë dhe inovacionit

UBT po vazhdon suksesshëm projektin e saj madhor të krijimit të qendrave të inovacionit dhe teknologjisë, si investimin më premtues dhe më serioz për të ardhmen e gjeneratës së re. Pas hapjes së “Korça Innovation and Technology Hub”, UBT po vazhdon lidhjen e fuqishme teknologjike, kësaj radhe, me potencialin më të madh që ka Kosova, rininë e saj. Në kuadër të këtij projekti në

tetor do të hapet “UBT Prizreni Innovation and Technology Hub”, si qendër lidere e teknologjisë dhe inovacionit në qytetin e Prizrenit, përmes të cilit synohet lidhja e rinisë dhe ndërmarrësisë së qytetit të bukur e të pasur me trashëgimi kulturore me zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe inovacionit, me trendet aktuale botërore.

Marrëveshja për vendosjen e UBT-së në Parkun e In-

novacionit dhe Trajnimeve në Prizren (ITP), u nënshkrua nga rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi dhe koordinatori i ITP-së, Muhamed Rexhepi, në prani edhe të drejtuesit të këtij parku të biznesit, Wolfgang Leidig. Rektori Hajrizi tha se investimi i UBT-së në këtë Hub teknologjik dhe inovativ në Prizren është pjesë e përgjegjësisë shoqërore që ky institucion ka ndaj rinisë dhe potencialit inovativ e teknologjik të Kosovës, i cili ka nevojë për ofrim të dijes, përkrahjes dhe aftësimin për të ecur përpara. “Duke qenë

në hap me vendet e zhvilluara të botës në fushën e dijes dhe informacionit, Kosova po dëshmon fuqishëm se nuk është spektatore por pjesëmarrëse aktive dhe kontribuuese në të ardhmen e reziliencës, inovacionit dhe qëndrueshmërisë, me UBT-në prijëse të këtyre proceseve”, u shpreh ai.

Ekosistemi që ofron sot UBT si lider në fushën e arsimit të lartë dhe lider i arsimit e aftësimin profesional, duke bashkuar dijen me teknologjinë, inovacionin me shkencën e studimet teorike me prodhimin si produkt fi-

nal, e bëjnë UBT-në që të jetë konkurrenente me universitetet më të mira të botës.

Ndryshe, ITP në Prizren është një projekt i përbashkët kosovaro-gjerman që synon të krijojë një mjedis tërheqës biznesi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Parku ndodhet në ish-kampin ushtarak gjerman në Prizren, ka një hapësirë prej 40 hektarësh dhe përfshinë 56 ndërtesa dhe disa parcela për zhvillim të metutjeshëm. Në ballë të këtij parku biznesi nga tetori do ta kenë UBT-në me super eksperiencën e pasur të saj në inovacion e teknologji.

Përurohet Kopshti Botanik i UBT-së



Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së, sot iu shtua Kopshti Botanik i UBT-së, i cili është i pari i tillë në vend, e që futet në kuadër të 20 inovacioneve për 20-vjetorin e UBT-së, duke

bërë ndërlidhjen unike me Fakultetin Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit në një ekosistem të madh të ndërthurur me shkencë, teknologji dhe inovacion.

Me mbi 560 bimë të ndryshme të cilat reprezentojnë bimët të cilat rriten në Kosovë dhe bimë të tjera që vijnë nga jashtë vendit, e që mund të zhvillohen në Kosovë përmes këtij kopshti, studentët e UBT-së dhe jo vetëm, do të kenë mundësi të shfrytëzimit të një resursi të ri brenda ambienteve të institucionit më të madh akademik në vend. Me rastin e përvëlimit të Kopshtit Botanik të UBT-së, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, është shprehur i lumtur se po plotësohet edhe një pjesë e ekosistemit që ndërlidh shkencën, teknologjinë dhe inovacionin në një vend, duke i ofruar studentëve

edhe pjesën praktike përbrenda hapësirave të institucionit. “Kjo zonë do të jetë një zonë e rëndësishme për studentët ku ata do të mësojnë se si zhvillohen bimët dhe do të përcjellin tërë procesin e zhvillimit të tyre, duke ndihmuar në aspektin e ngritjes së kompetencave të mira për studentët tanë, poashtu duke u ofruar edhe mundësinë e hulumtimeve shkencore, kështu duke qenë kontributdhënës të mëdhenj në pjesën tjetër që ne e quajmë zhvillim i qëndrueshëm”, ka thënë rektori Hajrizi. Dekani i Fakultetit Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit, prof.dr Fidan Feka, ka

falënderuar rektorin Hajrizi për zhvillimin e një kopshti të tillë që iu kontribuon shumë studentëve të agrikulturës, duke vlerësuar se ky kopsht do të jetë një ndihmesë e madhe për kryerjen e punës praktike e hulumtimeve shkencore. Kopshti Botanik i UBT-së, i hap rrugën zhvillimit të metutjeshëm të zgjerimit të vlerave të UBT-së, në fusha të ndryshme të studimit, duke vazhduar rankimin e institucionit në pozita të larta, për sa i përket impaktit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

UBT renditet në mesin e top 100 universiteteve më të mira në botë për Impakt Real - WURI 2021

UBT ka arritur një sukses tjetër të jashtëzakonshëm ndërkombëtar duke u renditur në mesin e 100 universiteteve më të mira në botë për inovacion.

Në listën e "World's Universities with Real Impact (WURI)", të cilës i prijnë universitetet prestigjioze si Stanford e Harvard, për herë të parë për arritje të pakrahueshme, radhitet edhe një bartës i arsimit të lartë nga Kosova.

UBT po e mban lartë flamurin e Kosovës në arenën ndërkombëtare ku viteve të fundit ka korrur suksese të mëdha në gara të forta përballë universiteteve me histori qindra vjeçare.

Institucioni lider i edukimit në vend – UBT, është vlerësuar nga WURI për rolin e jashtëzakonshëm inovativ, duke u renditur në mes të 51-100 universiteteve më të mira për Impakt Real në Menaxhim të Krizave, Impakt

Real në Shpirt Sipërmarrës, Impakt Real në Vlera Etike dhe Impakt Real në Aplikime Industriale. Ndërsa është radhitur në mesin e 52-100 universiteteve më të mira për Impakt Real në Mobilitet dhe Mundësi për Student dhe në mesin e 101-200 universiteteve më të mira për Impakt Real.

Kjo renditje nga WURI nuk bazohet në traditën, reputacionin ose popullaritetin e një universiteti, por përkundrazi fokusohet në koncepte të reja të tilla si inovacioni, sipërmarrja, përgjegjësia dhe menaxhimi i krizave. Këto janë fushat ku janë shënuar arritje të mëdha nga UBT e të cilat janë vlerësuar ndërkombëtarisht nga organizata prestigjioze WURI.

"Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se UBT është zgjedhur si një nga universitetet më novatore midis Universiteteve Botërore me Ndikim Real (WURI) për renditjet e

vitit 2021", thuhet në letrën që Hwy-Chang MOON, drejtor themelues i "The WURI Ranking" i ka dërguar Presidentit dhe themeluesit të UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

"Edhe pse WURI 2021 renditi MIT, Stanford dhe Harvard në krye të listës, ai gjithashtu përfshiu shumë institucione të arsimit të lartë më pak të njohura por jashtëzakonisht novatore të cilat nuk ishin shfaqur më parë në renditjet e tjera tradicionale të universiteteve", shtoi tutje Moon.

"Ne besojmë se përvojat tuaja me programe inovative janë të denja për t'u ndarë me institucionet e tjera të arsimit të lartë. Duke pasur parasysh sfidat e mëdha si rezultat i pandemisë COVID-19, përvoja të tilla tani janë më të vlefshme se kurrë", thuhet ndër të tjera në letrën që drejtori themelues i "The WURI Ranking" i ka dërguar rektorit Hajrizi, përmes të cilës UBT është inkurajuar për

të marrë pjesë edhe në renditjen e WURI 2022, për të prezantuar arritjet e reja inovative gjatë vitit të ri.

Presidenti dhe themeluesi i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, e ka vlerësuar lartë këtë rangim për UBT-në, duke e parë këtë si produkt të investimeve të mëdha disaveqare në këtë institucion, përfshirë krijimin e një ekosistemi super modern dhe cilësinë e pakrahueshme të mësimdhënies.

"UBT ka një komunitet të jashtëzakonshëm, një infrastrukturë moderne dhe një rini të mrekullueshme. Të tri këto komponente, të bashkuara në një Park Inovativ e Shkencor në UBT, po e lartësojnë çdo ditë imazhin e Kosovës përballë botës me arritje të mëdha në secilën fushë", ka thënë rektori Hajrizi.

"UBT si institucion lider i arsimit është shndërruar në institucion model në rajon e

më gjerë. Do të synojmë ta bëjmë Kosovën vend atraktiv e konkurrues edhe për studentët e vendeve të tjera, duke dëshmuar para secilit se cilësia dhe arritjet shkencore e teknologjike i përkasin institucioneve inovative e nuk janë ekskluzivitet i traditës apo popullaritetit", shtoi tutje rektori Hajrizi.

Gjatë këtij viti, UBT është anëtarësuar në "European University Association" e po ashtu është renditur mes institucioneve më të mira në botë për impaktin në zhvillimin e qëndrueshëm sipas revistës prestigjioze "Times Higher Education", përderisa në të njëjtën kohë ka arritur nivelin më të lartë në rankimin "Positive Impact Rating Edition 2021".

Përfaqësues të Ambasadës së Hungarisë në Kosovë, vizituan UBT-në



Zyrtarë të Ambasadës së Hungarisë në Kosovë, kanë vizituar Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, nga ku për së afërmi kanë parë nivelin e zhvillimit të arsimit, shkencës dhe teknologjisë në UBT, si dhe punën dhe angazhimin e institucionit për gjeneratat e reja. Në këtë takim mes zyrtarëve të UBT-së dhe të zyrtarëve të Ambasadës së Hungarisë në Kosovë, palët u pajtuan që përmes ambasadës të organizohet një provim me prezantim fizik të zyrtarëve të ambasadës për bursat shtetërore të Hungarisë "Stipendium Hungaricum".

Përmes Ambasadës së Hungarisë në Kosovë, është organizuar edhe një takim me "University of Pannonia", në të cilin do të vazhdohet bashkëpunimi me projektet dhe programet Erasmus+, si dhe në projekte të tjera kërkimore, program në të cilin është partner edhe UBT.

Në këtë takim, palët kanë rënë dakord për shkëmbimin e stafit dhe studentëve në të gjitha nivelet, si dhe për mundësinë që stafi i programit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri të aplikoj për programet e doktoratës, duke shfrytëzuar bursat e ambasadës dhe të universitetit.

UBT për nder të 20 vjetorit ndanë 20 lloje të bursave për studentët e rinj

Në nderim të 20-vjetorit të themelimit të UBT-së, me vendim të rektorit të UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend – UBT, ka vendosur të ndajë 20 lloje të bursave me të vetmin qëllim, përkrahjen dhe motivimin e të rinjve në ngritjen e tyre profesionale.

Në këtë mënyrë, UBT kontribuon duke ndihmuar dhe lehtësuar edhe barrën që rëndon familjet kosovare për shkollim të fëmijëve të tyre, duke bërë kështu më të lehtë dhe më motivues studimin për të gjithë ata që synojnë që ngritjen e tyre profesionale t'ia besojnë UBT-së, kështu duke i siguruar atyre përkrahje të vazhdueshme

në rrugëtimin e tyre profesional.

UBT çdo vit shpërblen me bursa studimi studentët e dalluar, të cilët gjatë një viti akademik kanë arritur minimumi notën mesatare 9.0, përderisa UBT ka ndarë bursa edhe për studentët që i takojnë kategorive të parapara me rregulloren e institucionit.

Përmes praktikave më të mira dhe më moderne, UBT po krijon kuadrot më profesionale të vendit, dhe gjithësi që në tërë këtë rrugëtim studentët e UBT-së nuk kanë qenë dhe nuk janë të vetëm, kjo sepse UBT u ka kursyer familjeve kosovare rreth 1 milion e 400 mijë euro përmes ofrimit të bursave

për fëmijët e tyre dhe për studentët e Kosovës.

Përveç bursave, UBT ka ndihmuar qindra studentë që të pranohen dhe të vijojnë studimet nëpër universitet më prestigjioze ndërkombëtare, prej ku po kthehen me kompetenca të larta dhe me dëshirë të madhe për të dhënë kontribut për Kosovën.

Ndaj, në tërë këtë proces akademik, pa asnjë mëdyshje mund të themi se UBT është familja më e madhe akademike që të rinjve kosovarë u ka ofruar mbështetje në secilin hap të rrugëtimin të tyre, duke iu ofruar të gjitha kushtet e nevojshme për studime cilësore akademike.

UBT - licencuar si ofrues për shërbime të internetit!

UBT ka bërë edhe një hap tutje në kompletimin e ekosistemit duke e ridëshmuar veten si një institucion model dhe lider i arsimit të lartë në Kosovë.

Pas krijimit të infrastrukturës së avancuar të internetit në Parkun Shkencor dhe Inovativ dhe në të gjitha ambientet e tjera edukative e administrative, UBT tani ka lansuar edhe internetin e vet, duke u pavarësuar kështu nga marrja e internetit prej ofruesve të tjerë.

Interneti në UBT, ku së shpejti do të jetë funksional edhe rrjeti edhe pajisjet 5G, do të jetë i një kualitetit super të lartë, me shpejtësi e fuqi që s'është parë deri tani në Kosovë.

Kjo do ta lehtësojë punën kërkimore, shkencore e teknologjike brenda UBT-së, duke e bërë atë të pandikuar nga faktorët e jashtëm, e duke siguruar internet të pakushtëzuar në secilën hapësirë brenda këtij institucioni.

U mbajt festivali i teknologjisë dhe inovacionit në Korçë



bashkë të shtunën në bibliotekën "Thimi Mitko" ekspertët më të njohur të fushës së inovacionit dhe teknologjisë.

Ky festival i dijes dhe shkathësisë në fushën e teknologjisë dhe inovacionit u zhvilluar në "Korça Innovation and Technology Hub", qendrën më të madhe të kësaj fushe në Shqipëri, që menaxhohet nga UBT.

Presidenti i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, tha se "Korça Innovation and Technology Hub", ka arritur sukseshëm të jetë pikë referente në fushën e teknologjisë në Shqipëri.

"Korça ka potencial dhe duhet të jetë një inspirim i mirë për fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Andaj ky festival i teknologjisë është një dëshmi për këtë potencial, i cili përveç që do të aftësojë të rinjtë në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, gjithashtu do t'u krijojë atyre mundësi që të punojnë për tregun global pa e braktisur Korçën. Ky Hub është i të gjithëve dhe ne duam që të punojmë me të gjithë që të arrijmë rezultate dhe vlera të përbashkëta", tha rektori Hajrizi.

"Korça do të jetë një pikë referimi, një destinacion i rëndë-

sishëm kur flitet për teknologjinë, inovacionin dhe për çdo gjë që lidhet me një small scale ecosystem", u shpreh tutje rektori Hajrizi.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Niko Peleshi, tha se përmes "Korça Innovation and Technology Hub" ky qytet e ka gjetur 'çelësin magjik'.

"Kemi gjetur një çelës magjik. Ky çelës magjik është inovacioni", tha ministri Peleshi.

Në anën tjetër, kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo, tha se përmes këtij festivali, Korça u kthye në qendrën e botës digjitale në Shqipëri.

"Një e shtunë HITECH në Korçë, bëri bashkë emrat më të spikatur në fushën e teknologjisë dhe inovacionit në Shqipëri dhe në botë, në një event fantastik si Korça ICT Festival", tha Kryetari Filo.

"Programi i bashkisë për ta kthyer Korçën në qendrën e inovacionit, teknologjisë dhe komunikimit, ka si synim që përveç trajnimeve, të rinjve të qytetit t'iu ofrojë edhe mundësi punësimi në tregun global", u shpreh tutje kryetari Filo.

Në kuadër të aktiviteteve të shumta që kjo konferencë organizoi, ishte edhe paneli i diskutimit me temën, "Rëndë-

sia e Korçës si një qendër e TIK-ut në jug të Shqipërisë", me ekspertët Florensa Haxhi, Charalampos Papadopoulos, Kushtrim Shala dhe Shqipe Berisha.

Në anën tjetër, njohësit në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, profesori i UBT-së, prof.dr. Besnik Qehaja bashkë me ekspertët Belma Lushi, Enea Mançellari, Adlind Haxhijaj, Xheni Maloku dhe Arbi Bamllari dhe nën drejtimin e profesorit të UBT-së, dr. Besnik Skenderi, diskutuan mbi rëndësinë që ka aftësimi në fushën e ICT-së në epokën e digjitalizimit.

Ndërkaq, rëndësia e ICT dhe si ndikon në biznes dhe komunitet, ishte një tjetër diskutim përmbajtësor në këtë festival. Stavri Pici, Ervin Konstandini, Ervis Smakaj, Gjergji Guri, Dritan Mezini dhe Diana Xhumari folën mbi rëndësinë e ICT dhe si ajo e bën një biznes më efikas, efektiv dhe më të shpejtë për t'u përgjigjur nevojave të klientëve duke ndihmuar aktivitetet e biznesit si dhe duke përfshirë projektimin, prodhimin, kërkimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e produkteve.

Bota e startup-eve ishte një prej paneleve me rëndësi të

UBT-Korça ICT Festival, ku eksperti nga Izraeli, Tal Catran theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve, si domosdoshmëri e zhvillimit lokal të Korçës.

Kurse, Cyber Security me panelistë Hergis Jica, Edlira Martiri dhe Ganiela Egro e nën moderimin e profesorit të UBT-së, prof.dr. Blerton Abazi, kishte fokus të veçantë rëndësinë që ka sot siguria kibernetike. Po ashtu, rëndësi ju kushtua edhe se sa i vlefshëm është siguri i qëndrueshmërisë financiare në suksesin e një biznesi.

Një panel tjetër ishte dhe ai "Tech Time" që në fokus kishte përdorimin e teknologjisë si imperative të kohës sot.

Ndërkaq, në kuadër të punëtorive të organizuara,

"Start-up Marketing" nën moderimin e Rrita Rekës nga UBT u prezantuan idetë për bizneset fillestare (start-ups), ku ekipi më i mirë do të marrë trajnim falas për kurset e marketingut në mediat sociale dhe financim të idesë së biznesit.

Në anën tjetër, "Gaming Arena", kuize lojërash, përkatësisht realizimi i një loje ishte një prej punëtorive më interesante ku fituesit do të financohen për të realizuar idenë e tij.

Punëtoritë tjetër, "Virtual Reality", zgjoi interesim të madh në këtë festival, duke i kushtuar rëndësi, Realitetit Virtual (VR) si një përvojë e simuluar që mund të jetë e ngjashme ose krejtësisht e ndryshme nga bota reale. Në kuadër të kësaj punëtorie, përmes pajisjeve të siguruar nga UBT, pjesëmarrësit ishin në gjendje të përjetojnë botën artificiale dhe të bëhen pjesë e saj.

Gjithashtu, në festivalin e Korçës u mbajt edhe punëtoritë me pjesëmarrje të profesionistëve të fushave të ndryshme, siç ishte edhe "Agrichallenge" ku rëndësi ju kushtua agrikulturës dhe teknologjisë në këtë fushë.

Korça ICT Festival 2021, u përmbyllë me sukses përmes storjeve të suksesit të studentëve dhe të rinjve të qytetit të Korçës, të cilët dëshmuar për rëndësinë dhe mbështetjen që një qendër e tillë e inovacionit dhe teknologjisë ka në zhvillimin profesional dhe personal tek të rinjtë dhe zhvillimin e ideve të tyre për biznes dhe teknologji.



Kosova përmes UBT-së renditet në dhjetëshen më të mirë në botë në garën

Microsoft Office Specialist (MOS) 2021



Një sukses tjetër i jashtëzakonshëm në arenën ndërkombëtare nga UBT dhe Kosova u shënuar edhe këtë herë, kësaj radhe në kampionatin botëror të Microsoft Office Specialist (MOS) 2021. Në garën që Kosova përmes UBT-së për herë të parë mori pjesë si shtet, Elta Bajrami nga ekipi i Kosovës nën mentorimin e profesorit të UBT-së, Besnik Skenderi, është renditur në dhjetëshen e parë të kampionatit botëror Microsoft Office Specialist (MOS)

2021, duke zënë kështu vendin e gjashtë.

Pjesë e ekipit kosovar ishin edhe Elita Hajrizi dhe Vlera Saraqi, që përveç garës Microsoft Office Specialist (MOS) 2021, përfaqësuan Kosovën denjësisht edhe në garën e robotikës FIRST Global Challenge.

Kosova në garën Microsoft Office Specialist (MOS) 2021, që këtë vit është mbajtur në formën online, nga më shumë se 200 mijë garues nga 108 vende, ka arritur të

triumfoi në shkathtësitë e përfaqësuesve nga Kosova në Microsoft Word, Excel dhe PowerPoint, në konkursin më të njohur të aftësive teknologjike të Microsoft Office.

UBT përgjatë dy viteve ka sjellur, organizuar dhe financuar këtë garë në Kosovë, në nivel shtetëror, nga ku edhe janë përzgjedhur tre finalistët për të përfaqësuar Kosovën këtë vit në këtë garë.

Rektori Hajrizi nderohet me çmimin “EON Power User Award” nga gjiganti teknologjik EON Reality



Në një ceremoni të mbajtur virtualisht, gjiganti teknologjik, EON Reality, ka nderuar rektorin e UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, me çmimin EON Power User Award.

Ky çmim prestigjioz iu dha rektorit Hajrizi për faktin se institucioni që ai drejton hyri në rangun e universiteteve prestigjioze dhe shërbeu si model në zhvillimin e inovacioneve teknologjike, ngaqë krijoi mijëra mësim në qindra kurse universitare.

Çmimi u dha në ngjarjen më të madhe në historinë e EON-it, ngjarje globale ku u prezantua e ardhmja e EON-XR. Kjo ngjarje u mbajt në praninë virtuale

të rreth 5 mijë pjesëmarrësve, klientë të industrisë, njëherësh edhe përfaqësues të universiteteve botërore.

“Jemi krenarë të ju njoftojmë se Çmimi përurues i EON Power User Award i është dhënë vizionarit dhe largpamësit, prof. dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së. Prof. Dr. Hajrizi udhëhoqi me sukses zbatimin në tërë institucionin e EON-XR si pjesë e përgjigjes së institucionit ndaj mësimit në distancë, duke e kthyer krizën në një mundësi për të nxitur një mësim më të mirë. Urime Prof. Dr Edmond Hajrizi. Me UBT-në ne po synojmë për të arritur edhe shumë suksese”, thuhet në njoftimin

zyrtar të EON Reality, publikuar edhe në faqet zyrtare të kompanisë.

Kompania më e madhe botërore për teknologji virtuale, EON Reality kishte zgjedhur Kosovën dhe pikërisht UBT-në, si partner implementues, që të bëjë investimin më të madh direkt në Kosovë që nga paslufta, njëherësh edhe dhe të vetmin në Ballkan, për hapjen e Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar.

Kjo qendër u bë burim i gjenerimit të produkteve virtuale dhe i shpalosjes së pasionit dhe talentit për të rinjtë nga Kosova dhe mbarë rajoni.

Rektori Hajrizi pjesë e diskutimeve të XR EdTech Experience - shquhet si një nga emrat më të mëdhenj në fushën e arsimit, teknologjisë dhe industrisë XR

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ishte pjesëmarrës i serive të bashkëbisedimit XR EdTech Experience, të organizuara nga themeluesi dhe presidenti i gjigantit të teknologjisë, EON Reality, Dan Lejerskar. Në këtë bashkëbisedim, rektori Hajrizi ka diskutuar me presidentin e EON Reality, Dan Lejerskar, për arsimin, teknologjinë, industrinë XR, realitetin virtual, si dhe ndikimin e teknologjisë në një gamë të gjerë të fushave të jetës. Presidenti i gjigantit të teknologjisë EON Reality, Dan Lejerskar, ka vlerësuar personalitetin e prof.



dr Edmond Hajrizit, punën e palodhshme dhe angazhimin e tij në shkencë, teknologji, biznes dhe inovacion, duke thënë se ajo që është duke bërë rektori Hajrizi

me UBT-në është diçka unike në Evropë.

“Ju keni krijuar diçka që sipas mendimit tim, është unike në Evropë. Kam vizituar qindra

institucione akademike, por s’kam parë sikurse institucioni juaj. Është vërtetë unike, pasi që ju keni sjellë një qasje të re”, ka thënë presidenti i gjigantit të teknologjisë, EON Reality, Dan Lejerskar.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ka thënë se është i lumtur që UBT ka një bashkëpunim me një gjigant të teknologjisë, siç është EON Reality, duke vlerësuar sjelljen e trendëve të reja të teknologjisë në botë. “Jam i lumtur për një bashkëpunim tejet të frytshëm me EON Reality, sepse ky bashkëpunim bën bashkë dy

ide që trasojnë të njëjtën rrugë, atë të zhvillimit të dijes në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, përmes XR, AR dhe VR, ndaj UBT do të vazhdojë të jetë e përkushtuar ndaj partnerëve të saj dhe sjelljes së trendëve të reja të teknologjisë për studentët dhe të rinjtë e tjerë”, ka thënë rektori Hajrizi. XR EdTech Experience janë diskutime javore, të cilat çdo javë sjellin një nga emrat më të mëdhenj në arsim, teknologji dhe industri XR, që mbulojnë një gamë të gjerë temash rreth fushave të ndryshme inovative dhe shkencore.

Rektori Hajrizi pjesë e panelit për ndryshimet klimatike

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ishte pjesë e panelit debatues për ndryshimet klimatike, të organizuar nga Zyra e Koordinatorës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Ambasada e Italisë në Kosovë.

Para një audience të zgjedhur, midis të cilëve ambasadori britanik, Nicholas Abbott, ambasadori italian, Antonello de Riu, koordinatorja për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Ulrika Richardson, përfaqësuesve nga Presidencia, Qeveria dhe shoqëria civile, rektori Hajrizi foli për rolin e universiteteve në sigurimin e të dhënave të sakta për ndryshimet klimatike.

Ai tha se UBT është plotësisht e përkushtuar që të kontribuojë si institucion akademik e shkencor në sensibilizimin e opinionit për ndryshimet klimatike, e gjithashtu edhe për krijimin e databazës së monitorimit dhe pasqyrimin të saktë të të dhënave që

ndërlidhen me këtë sfidë lokale e globale, mbi bazën e të cilave do të bazoheshin edhe veprimet konkrete në kuadër të përpjekjeve për reduktimin e dioksidit të karbonit dhe ruajtjes së planetit në përgjithësi.

“Studimet në UBT janë plotësisht të ndërlidhura me objektivat globale të zhvillimit të qëndrueshëm, e ku përfshihen edhe ndryshimet klimatike”, u shpreh rektori Hajrizi, duke pasqyruar para kësaj audience të zgjedhur programet dhe specializimet e veçanta që ofron ky institucion arsimor në fushën e eficiencës së energjisë, mjedisit, agrikulturës, bujqësisë, shkencave mjekësore e atyre kompjuterike e të cilat ndërlidhen me secilin prej 17 objektivave globale për zhvillim të qëndrueshëm të njohura si SDG. Ndër të tjerash, rektori Hajrizi tregoi për punën e UBT-së dhe çmimet e fundit ndërkombëtare për impakt real dhe arritje të SDG-ve. Gjithashtu, ai theksoi se



UBT përpos kontributit përmes hulumtimeve shkencore mbi temën e ndryshimeve klimatike, UBT si institucion lider i edukimit në vend, po shkon përtej duke u zgjeruar edhe në impakt shoqëror përmes zhvillimit të shembujve Small Scale, duke ju referuar qytetit të mençur të UBT-së, “UBT Smart City” për të testuar dhe hulumtuar tutje mekanizmat

që promovojnë dhe mundësojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Gjatë diskutimit, rektori Hajrizi i dha rëndësi edhe bashkëpunimit me të gjithë palët e interesit që të krijohen sa më shumë mundësi dhe platforma për zhvillim të qëndrueshëm për shkak se sipas tij, Kosova ka potencial dhe mund të ketë pozitë të rëndësishme në këtë fushë.

Diskutimet u përmbyllën me shfaqjen e dokumentarit: “Breaking Boundaries”, me autor Sir David Attenborough, ku në këtë dokumentar shfaqen shkaktarët e vërtetë të ndryshimeve klimatike dhe bëhet thirrje urgjente për ndërmarrjen e veprimeve konkrete në shpëtimin e planetit. Ky aktivitet u organizua në kuadër të fushatës Kosovo Climate Action Campaign – Climate Change, pjesë e së cilës është edhe UBT dhe si event për t’i paraprirë Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike që do të mbahet nga 31 tetori deri më 12 nëntor në Galsgow të Skocisë.

UBT, po ashtu është ftuar për të marrë pjesë në forumin botëror për ndryshimet klimatike – Climate Impact Forum të organizuar nga revista prestigjioze Times Higher Education në bashkëpunim me programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin.

Prof.dr.Edmond Hajrizi renditet në mesin e personaliteteve botërore të dëshmuar në Extended Reality (XR)

Numrit të personaliteteve botërore që janë dëshmuar në Extended Reality (XR), edukim dhe rrjet global, i është shtuar edhe presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, që me punën e palodhshme që ka bërë ndër vite, ka kontribuar jashtëza-

konisht shumë në zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Rektori Hajrizi është vlerësuar edhe për faktin se ka ndërtuar një institucion me kompetenca të larta, me cilësi në mësimdhënie, si dhe ka aplikuar teknologjitë më të reja,

duke shërbyer edhe si model për universitetet tjera në zhvillimin e inovacioneve teknologjike. Ka krijuar mijëra mësim në platformën e realitetit virtual, në qindra kurse universitare. Kjo ka shtyrë që edhe gjiganti teknologjik EON Reality, muaj më parë, të vlerësojë rektorin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, me çmimin “EON Power User Award”, për suksesin që ka treguar institucioni që ai drejton në zbatimin e teknologjisë EON-XR për më-

simin në distancë, duke e quajtur vizionarë dhe largpamës në rrugëtimin, ekspertizën dhe profesionalizmin që ka treguar ai me UBT-në. UBT, përmes platformës së Realitetit Virtual (VR), 5G, Intelligjencë Artificiale, Robotikë, Siguri Kibernetike, ka bërë Kosovën shtetin e parë në Ballkan që sjellë një nga teknologjitë më të fundit të kohës, kështu duke bërë investimin direkt më të madh në teknologji dhe inovacion në Kosovë që nga

paslufta. Duke qenë tani më qendra më e madhe në rajon, tani UBT në vitin 2021, në kuadër të 20-vjetorit të institucionit, është duke zhvilluar dhe implementuar 20 inovacione për 20 vjetorin e saj. Këtë javë, UBT hapi qendrën më të madhe në Shqipëri për inovacion dhe teknologji në qytetin e Korçës, duke iu mundësuar të rinjëve korçarë hapësira pune dhe trajnimi.

Rektori Hajrizi u prit në Ankara nga kryetari i Parlamentit të Turqisë, Mustafa Şentop

Kryetari i Parlamentit të Turqisë, prof.dr. Mustafa Şentop, ka pritur në një takim të veçantë presidentin dhe rektorin e UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Në këtë takim, kryeparlamentari Şentop dhe rektori Hajrizi kanë diskutuar për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet dy shteteve dhe për nevojën e thellimit të bashkëpunimit sidomos në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë.

Në këtë takim, rektori Hajrizi e ka njoftuar kryetarin e Parlamentit të Turqisë për marrëveshjet që ka nënshkruar me universitetet e njohura turke për shkëmbim të përvojave, të stafit akademik dhe studentëve, si dhe për bashkëpunimin e ngushtë në të ardhmen për programet e përbashkëta mësimore me këto universitete.

"Kryeparlamentarin Şentop e



falënderova për mbështetjen e tyre të madhe për Kosovën.

Po ashtu, i shpreha interesimin tonë për bashkëpunim

më të madh veçanërisht në fushën e arsimit, shkencës,

inovacionit dhe teknologjisë", u shpreh pas takimit rektori Hajrizi. Ai tha se gjatë këtij takimi ka prezantuar edhe mundësinë që ofron UBT për studentët nga Turqia për të ndjekur studimet në Kosovë, në një infrastrukturë moderne e me programe atraktive e të vlerësuara ndërkombëtarisht.

Rektori Hajrizi me këtë rast ka ftuar kryetarin e Parlamentit të Turqisë, Mustafa Şentop, që ta vizitojë UBT-në, për të cilin do të ndaj edhe një mirënjohje për mbështetjen e tij për Kosovën, sidomos në fushën e arsimit.

Rektori Hajrizi e ka përmbyllur suksesshëm vizitën e tij një javore në Turqi me takimet që ka zhvilluar në parlamentin turk me sekretarin e përgjithshëm dhe grupet punuese parlamentare atje.

Rektori Hajrizi vizitoi TOBB Universiteti of Economics and Technology në Ankara



Në vijim të vizitës së tij zyrtare në Turqi, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka qëndruar për vizitë në TOBB Universiteti of Economics and Technology (Universitetin për Ekonomi dhe Teknologji) në Ankara. Rektori Hajrizi është pritur nga rektori i TOBB Universiteti of Economics and Technology, prof.dr. Yusuf Sarinay, me të cilin kanë rënë dakord për nënshkrimin e një marrëveshjeje të bashkëpunimit, mes këtyre dy institucioneve

të arsimit të lartë. Gjatë këtij takimi rektori Hajrizi, njoftoi rektorin Sarinay me punën dhe angazhimin e UBT-së për gjeneratat e reja, si dhe për kontributin shkencor të UBT-së përmes profesionistëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme. Si rektori Hajrizi ashtu edhe rektori Sarinay kanë shprehur interesim për bashkëpunim në projekte të përbashkëta, që ndërlidhin fushën e arsimit, shkencës dhe inovacionit.

Rektori Hajrizi vizitoi TOBB Universiteti of Economics and Technology në Ankara

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit në Ankara të Turqisë, është pritur nga zëvendës-presidenti i Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim – TIKKA, Fuat Oktay. Gjatë këtij takimi, rektori Hajrizi është njoftuar nga zëvendës-presidenti Oktay me aktivitetet e TIKKA-s në Kosovë dhe më gjerë. Rektori Hajrizi dhe zëvendës-presidenti i TIKKA-s shprehën gatishmërinë e plotë për bashkëpunim në fusha të interesit të ndërsjellë. Drejtuesit e Zyrës së TIKKA-s në Kosovë kanë vizituar javë më parë Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së ku nga rektori Hajrizi janë njoftuar me punën e UBT-së, me ekosistemin e krijuar ku dija ndërlidhet me punën praktike, e ku shkollimi cilësor bashkë me teknologjinë



e fundit i japin dimension të pakrahasueshëm shkollimit

në këtë institucion lider të arsimit të lartë në vend.

Rektori Hajrizi mori pjesë në takimin e GEOBIZ



Për dy ditë me radhë në Prishtinë është mbajtur takimi i GEOBIZ, i cili mbështetet nga Erasmus + me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë.

Qëllimi kryesor i projektit GEOBIZ është forcimi i kapaciteteve të institucioneve akademike në mënyrë që këto institucione të jenë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të industrisë gjeoinformatike në zhvillim në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Moldavi dhe Mal të Zi. Dita e parë GEOBIZ, në të cilin është diskutuar për progresin e arritur deri tash në implementimin e këtij projekti, ka filluar me fjalimin e koordinatorit të

projektit, profesorit nga Universiteti i Zagrebit, prof.dr.Zeljko Bacic, Rektorit të UBT-së, prof. dr.Edmond Hajrizit dhe rektorëve nga universitetet tjera partnere.

Sesioni i dytë i punimeve ka qenë i dedikuar për UBT-në, ku profesorët Hazir Çadraku dhe Tomor Çela, kanë prezantuar të arriturat e gjertanishme në kuadër të këtij projekti. Projekti ka si synim krijimin e formave të reja dhe inovative të bashkëpunimit në relacionin biznes-akademi për të mbështetur ndërveprimin në proceset e mësimdhënies/të nxënimit në gjeoinformatikë. Po ashtu, ka për synim krijimin e platformës

që mbështet ekselencën në gjeoinformatikë. Zhvillimi i programeve novatore të trajnimit të mësuesve dhe metodologjive praktike të mësimdhënies/të nxënimit dhe përmbajtjes në kurset e bazuara në teknologji në gjeoinformatikë të mbështetur në nevojat dhe përvojën e drejtuar nga biznesi është një nga qëllimet tjera të këtij projekti.

Në kuadër të punimeve të GEOBIZ, disa prej pjesëmarrësve kanë vizituar edhe Parkun Shkencor të UBT-së, laboratorin e ri të gjeoinformatikës dhe pajisjet tjera që janë blerë në kuadër të këtij projekti.

Rektori Hajrizi në takim me drejtuesit e kompanisë amerikane “Visteon” në Bullgari

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, zhvilloi sot në Sofje të Bullgarisë, disa takime të rëndësishme që kanë për synim avancimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe gjithashtu sjelljen e investimeve të reja teknologjike në fushën e automobilizimit në Kosovë.

Në ditën e parë të vizitës së tij në Sofje, rektori Hajrizi i shoqëruar nga i ngarkuari me punë i Republikës së Kosovës në Bullgari, ambasadori Delfin Pllana, zhvilloi një takim pune me drejtorin e kompanisë globale për Bullgari dhe Rumani, “Visteon”, Ivan Mihaylov.



“Lajme të mira për Kosovën. Me kompaninë amerikane kemi diskutuar për prezencën e saj në Kosovë për të realizuar studime të rëndësishme në fushën e automobilizimit”, u shpreh rektori Hajrizi.

Ndër tjerash, rektori Hajrizi e njoftoi z.Mihaylov për të arriturat e UBT-së që nga themelimi si dhe zhvillimet e fundit në fushën e inovacionit, teknologjisë, ndërmarrësisë në të cilat është e përfshirë UBT.

Drejtori i kompanisë globale amerikane “Visteon”, Ivan Mihaylov, u shpreh i impresionuar me të arriturat e UBT-së duke

konfirmuar interesimin për të gjetur mënyra të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Me këtë rast, ambasadori Pllana tha që ky takim dëshmon se si në Bullgari dhe në Kosovë ekzistojnë kompani dhe institucione serioze të cilat duhet të shfrytëzojnë potencialin e madh që ekziston për bashkëpunim ndërmjet të dyja vendeve.

“Visteon” është kompani lidere globale në fushën e dizajnit dhe prodhimit të pajisjeve elektronike për industrinë automobilistike dhe furnizuesi më i madh i automobilitave.

Rektori Hajrizi pret në takim pune profesorin e Iowa State University, dr. Curtis R. Youngs



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka pritur në një takim pune, profesorin e Universitetit Shtetëror të Iowa-s, dr. Curtis R. Youngs, me të cilin diskutuan rreth aktiviteteve

të mundshme mes UBT-së dhe Universitetit Shtetëror të Iowa-s. Në këtë takim, rektori Hajrizi e njoftoi profesorin Youngs lidhur me punën dhe aktivitetin e UBT-së, si dhe studentët dhe stafin

e këtij institucioni të arsimit të lartë.

Nga ky takim, si dr. Curtis R. Youngs, ashtu edhe prof.dr. Edmond Hajrizi, ranë dakord që të shtrijnë bashkëpunimin e tyre në të ardhmen, në fusha të ndryshme, përmes aktiviteteve të ndryshme që organizon UBT dhe Universiteti Shtetëror i Iowa-s.

UBT dhe shteti i Iowa-s, kanë një lidhje të ngushtë bashkëpunimi, duke bërë që më herët të ketë bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë nga ky shtet, duke u mundësuar studentëve nga shteti i Kosovës dhe Iowa-s shkëmbimin e njohurive dhe përvojave përmes ligjëratave të përbashkëta, të mbajtura virtualisht.

Rektori Hajrizi propozon krijimin e Hub-it kombëtar të digjitalizimit dhe themelimin e qendrës ndërdisiplinare shqiptare

Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në secilën fushë shihet si interes nacional për të dyja shtetet, me theks të veçantë bashkëpunimi në fushën e arsimit, shkencës e teknologjisë. Ky ishte edhe thelbi i takimit midis akademikëve, intelektualëve dhe kontribuesve të arsimit dhe shkencës nga Kosova dhe Shqipëria i cili u zhvillua në kuadër të ceremonisë së organizuar nga kryeministri Rama i cili i ndau dekoratën “Kordoni i Madh me Yll i Medaljes” shkrimtarit Rexhep Qosja.

Në këtë takim ishte i ftuar edhe rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i cili e vlerësoi si të paalternativë thellimin e

bashkëpunimit dhe bashkëkoordinimin në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit midis Tiranës dhe Prishtinës. “Arsimi dhe shkencë është përbashkuesi ynë, përbashkuesi i dy shteteve tona, i trngut tonë të përbashkët – kombit shqiptar”, ka thënë rektori Hajrizi. Në fjalën e tij para të pranishmëve, midis të cilëve edhe kryeministrat Edi Rama dhe Albin Kurti, rektori Hajrizi propozoi themelimin e qendrës së studimeve ndërdisiplinare shqiptare si dhe hapjen e Hub-it kombëtar të digjitalizimit, si dy projekte të mëdha që i japin dimension të veçantë raporteve dhe arritjeve mes dy shteteve.

Rektori Hajrizi priti një delegacion nga Maqedonia e Veriut - mbanë ligjëratë rreth protokollit diplomatik

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka mirëpritur një delegacion nga Maqedonia e Veriut në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, ku me këtë rast ka zhvilluar edhe një trajnim rreth protokollit diplomatik.

Në këtë trajnim, rektori Hajrizi ka diskutuar rreth lidhshimit, menaxhmentit, instrumentit të artit të qeverisjes, sipërmarrësisë, diplomacisë dhe menaxhimit. Ndër të tjera, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka shpalosur koncepte të menaxhimit në diplomaci,

menaxhimit publik, lidhshimit diplomatik, menaxhimit të resurseve njerëzore dhe efikasitetit organizativ. Rektori Hajrizi i njoftoi nga afër delegacionin e Maqedonisë së Veriut me infrastrukturën e UBT-së, punën, angazhimin dhe përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, që institucioni është duke e bërë falë punës së stafit dhe studentëve. Pjesë e delegacionit të Maqedonisë së Veriut ishin studentë, të deleguar nga institucionet shtetërore, ministritë, drejtoritë, si dhe këshilltarë komunash.

Rektori Hajrizi takohet me studentët e UBT-së që po kalojnë një semestër të studimeve në Bullgari



Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka takuar studentët të cilët janë duke përfunduar një semestër të studimeve në Bullgari, përmes programit Erasmus+, si pjesë e programit të shkëmbimit të

studentëve. Rektori Hajrizi ka përgëzuar studentët për arritjet e tyre, punën dhe angazhimin, si dhe përfaqësimin e denjë jo vetëm të UBT-së por edhe të Kosovës. “Përgëzojë studentët për arritjet e tyre

në studime dhe angazhimin e tyre në fushat ku ata janë duke studiuar. Jam i lumtur që përmes UBT-së ua kemi ofruar studentëve mundësinë që të studiojnë në një universitet me renome ndërkombëtare, sepse qëllimi ynë kryesor është që studentët tanë t'i dërgojmë jashtë kufijve për t'u inspiruar e për të sjellë përvojën e tyre që të zhvillojnë shtetin tonë”, Edhe studentët e UBT-së që ishin përfitues të kësaj burse u ndanë shumë të kënaqur me përvojën e fituar, teksa shprehën gatishmërinë e tyre që përvojën e fituar ta inkorporojnë në punën e tyre të përditshme në Kosovë.

Rektori Hajrizi prezanton modelin teknologjik dhe inovativ të UBT-së në Bullgari



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka prezantuar para rektorëve të universiteteve të Ballkanit modelin e UBT-së, në kuadër të programit të Bashkimit Evropian Erasmus+ (Mobility staff), si njëri prej institucioneve që ka bërë revolucion në teknologjinë dhe inovacionin në Kosovë dhe rajon.

Ai shpalosi rolin inovativ të ekosistemit të dijes, me theks sistemin e kërkimit arsimor dhe sistemin e inovacionit për ekosistemet e vogla në vend, teksa Bullgaria u bë nikoqir i prezantimit të konceptit të UBT-së, “UBT Smart City”, që është qendra më e madhe e teknologjisë dhe inovacionit në Kosovë.

Rektorët e universiteteve të Ballkanit dhe të pranishmit e tjerë u njoftuan nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi me punën shkencore të UBT-së, si dhe rolin e madh që ka institucioni në nxjerrjen e kadrove profesionale në fushat e teknologjisë, inxhinierisë, inovacionit dhe sistemeve.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga ministri i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka zhvilluar një takim pune në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku është pritur në takim nga ministri i këtij dikasteri, Elbert Krasniqi.

Në këtë takim, rektori Hajrizi dhe ministri Krasniqi, kanë diskutuar për inovacionin, teknologjinë, zhvillimin lokal, si dhe për bashkëpunimin mes UBT-së dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Rektori Hajrizi ka njoftuar ministrin Krasniqi për aktivitetet që është duke zhvilluar UBT, projektet, me theks të veçantë fushën e zhvillimit lokal, inova-



cionin dhe ndërmarrësinë, duke shprehur gatishmërinë e plotë për bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët.

Nga ana tjetër, ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, gjatë këtij takimi, e ka njoftuar rektorin Hajrizi për disa prej projekteve dhe planeve të MAPL-së, të cilat përfshijnë digjitalizimin, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si E-Komunat dhe Smart Cities, e të cilat kanë për qëllim zhvillimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga komandanti i KFOR-it në Kosovë, Franco Federici



Si vazhdimësi e vizitës së komandantit të KFOR-it në Kosovë, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në kuadër të festivalit global të dijes, "Global UBT Fest 2021", rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, u prit në takim nga

komandanti i KFOR-it në Kosovë, Gjeneralmajor Franco Federici. Në këtë takim, komandanti i KFOR-it në Kosovë, Gjeneralmajor Franco Federici, bashkë me rektorin e UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, diskutuan për çështje

që prekin fusha të ndryshme, por duke i dhënë theks të veçantë, arsimit dhe shkencës në Kosovë dhe tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Rektori Hajrizi e njoftoi komandantin e KFOR-it në Kosovë, lidhur me punën e UBT-së, angazhimin dhe mundësitë që UBT iu ka ofruar studentëve në fusha të ndryshme, si dhe për rolin që ka luajtur UBT në ndikimin pozitiv në shoqëri, teksa u shpreh i lumtur me punën e vazhdueshme të KFOR-it në Kosovë për një jetë më të sigurt për qytetarët e vendit. Nga ky takim, si rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ashtu edhe komandanti i KFOR-it në Kosovë, Gjeneralmajor Franco Federici, lanë të hapur mundësinë për bashkëpunim në të ardhmen, për të dhënë kontribut në fushën e arsimit dhe shkencës.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka qëndruar për vizitë në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë, ku është pritur nga kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka. Në këtë takim rektori Hajrizi, së bashku me kryetarin e Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit mes të këtyre

dy institucioneve, tani edhe me zhvillimin e programit Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes në UBT. Rektori Hajrizi, ka njoftuar kryetarin Kuka për zhvillimin ndër vite të institucionit, si dhe mundësitë që ka krijuar UBT për studentët dhe të rinjtë, sidomos për fushën e sportit, që është një nga fushat që ndërlidh të UBT-në dhe Federatën e Xhudos së Kosovës.

Kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, e ka njoftuar për së afërmi rektorin Hajrizi, për punën, rezultatet dhe planet e federatës, teksa ia prezantoi edhe Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Nga ky takim, të dyja palët u dakorduan që të vazhdojnë bashkëpunimin për të siguruar kushte sa më të mira për të rinjtë të talentuar të kësaj fushe, e që nesër do të përfaqësojnë Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Rektori Hajrizi takohet me ministrin e Ministrisë së Mbrojtjes, Armend Mehaj

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka zhvilluar një takim me ministrin e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Armend Mehaj.

Në këtë takim rektori Hajrizi prezantoi programet e veçanta në fushën e sigurisë që i ofron UBT në nivelin bachelor si dhe nëntë programet ekskluzive të doktoratës që i ofron në bashkëpunim me Institutin e Mbrojtjes së Bullgarisë.

Prof.dr. Edmond Hajrizi i njoftoi përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes për dy programet e studimeve themelore të UBT-së: Siguria Kombëtare dhe Emerg-



jenca Civile, si dhe Siguria Kibernetike. "Shkathtësi konkrete në analizimin dhe menaxhimin e situatave të ndryshme të sigurisë në nivele të sektorit kombëtar ose specifik dhe inkurajimin

për ofrimin e zgjidhjeve problemore janë disa prej elementeve kyçe që i ofrojnë këto programe, duke qenë kështu të nevojshme jo vetëm për vendin tonë por për tërë Evropën Juglindore",

është shprehur rektori Hajrizi. Ndërsa në programet unike të doktoratës që UBT i ofron me Institutin e Mbrojtjes "Profesor Tsvetan Lazarov" në Sofje ofrohen nëntë specializime ekskluzive, tejet të nevojshme për institucionet dhe mekanizmat tjerë që merren me çështje të sigurisë. "Dinamika, balistika dhe kontrolli i fluturimit të aeroplanëve, radiolokimi dhe radio-navigimi, pajisjet radio-transmetuese dhe radio-pranuese, sistemet e automatizuara të procesimit dhe kontrollit të informacionit, pajisjet dhe metodat optike laserike, dizajnimi dhe projektimi i

automjeteve dhe aeroplanëve, metodat për kontrollin dhe testimin e materialeve, pajisjeve dhe makinerisë, teknologjia kimike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, teknologjia e informacionit dhe siguria kibernetike – janë programe të domosdoshme në zinxhirin e sigurisë për secilin shtet e sidomos për Kosovën që po ndërton kapacitetet e saja të sigurisë mbi përvojat më të mira ndërkombëtare", u shpreh me këtë rast rektori Hajrizi, duke bërë të ditur se për pjesëtarët e FSK-së do të ketë bursa dhe lehtësime të tjera.

Rektori Hajrizi priti në takim dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, prof.dr. Sabri Laçi

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka mirëpritur në Parkun Shkencor dhe Inovativ të UBT-së, në Lipjan, dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, prof.dr. Sabri Laçi.

Rektori Hajrizi e njoftoi dekanin Laçi dhe delegacionin nga Universiteti i Tiranës me infrastrukturën, mundësitë, si dhe me po-

tencialin e madh që ofron UBT si institucion i arsimit të lartë i cili mbulon të gjitha fushat e jetës me programe unike universitare dhe me trajnime të licencuara. Rektori Hajrizi dhe dekanin Laçi diskutuan edhe për mundësinë e bashkëpunimit mes UBT-së dhe Universitetit të Tiranës, si dhe për projekte të tjera të përbashkëta në të ardhmen.

Rektori Hajrizi mori pjesë në inaugurimin e Qendrës për Transformim Digjital

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në inaugurimin e Qendrës për Transformim Digjital, në Parkun e Trajnimeve dhe Inovacionit (ITP) në Prizren. Inaugurimi i kësaj qendre u bë nga ministria e Ministrisë së

Industrië, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, si dhe nga drejtori i Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Volker Oel. Qendra e Transformimit Digjital është pjesë e një rrjeti global

qendrash të financuara nga BMZ (Ministria Federale Gjermane për Zhvillimin Ekonomik). Aktivitetet e saj në Kosovë janë të organizuara në ITP, të financuara bashkërisht nga qeveria kosovare dhe ajo gjermane. Brenda Parkut të

Trajnimeve dhe Inovacionit, UBT do të vendosë Hub-in më të madh të teknologjisë dhe inovacionit për qytetin e Prizrenit, një vend unik ku shkencë, inovacioni dhe teknologjia e fundit do të ndërveprojnë mes vete.

Rektori Hajrizi prezantoi para koordinatorëve për Sigurimin e Cilësisë dhe drejtorëve të shkollave profesionale, formulën e financimit për arsimin profesional

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në Samitin e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale - VET Samiti, ku ka prezantuar formulën e financimit të arsimit profesional dhe për mënyrën e ndërlikohjes së arsimit profesional me sektorin privat, formulë kjo e zhvilluar nga UBT për programin ALLED2, financiar nga Komisioni Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

Përgjatë prezantimit, rektori Hajrizi theksoi se formula financiare për sistemin arsimor vjen si nevojë e sistemit, dhe se planifikimi financiar duhet bazuar në indikatorë që përfaqësojnë nevojat për shkollat, ndaj sipas rektorit Hajrizi kjo shërben edhe si një mjet simulimi për skenar të ndryshëm të financimit.

"Propozimi për formulën financiare për arsimin profesional në Kosovë del si nevojë e akceptimit pak më ndryshe të arsimit profes-



sional sepse i ka disa karakteristika më specifike të cilat duhet të trajtohen. Ne jemi munduar ta ndjekim tërë zingjirin e furnizimit, nga klasa e deri te praktika, përfshirë këtu edhe të gjitha komponentët e nevojshme duke i definuar ato, dhe në bazë të kësaj kemi parë se një formulë e tillë e financimit me një ristrukturim pak më ndryshe dhe adaptim më ndryshe, mund të mbetet prapë

në ngjyrën e njëjtë të ligjeve dhe rregulloreve pa ndryshuar dhe komplikuar konceptin legal", ka thënë rektori Hajrizi.

Dokumenti i quajtur "Planifikimi Financiar për Sistemin e AAP-së në Kosovë - Propozim për Përmirësim", publikuar nga programi ALLED2 dhe prezantuar nga rektori Hajrizi shtjellon në detaje skenarët të cilët duhet ndjekur për një zgjidhje efektive,


duke sjellë analiza dhe rekomandime të opsioneve të ndryshme të mundshme rreth financimit të AAP-së në Kosovë, brenda kornizës legislative ekzistuese. Rektori Hajrizi ka thënë se UBT shquhet për kontributin e dhënë për arsimin dhe edukimin profesional, sidomos në fushën që lidhet me STEAM, në ngritjen e infrastrukturës moderne për këtë lloj arsimit, si dhe për sjell-

jen e praktikave më të mira austriake, gjermane, zvicerane, e të shteteve të tjera të botës.

"Arsimi profesional zë një vend të merituar në ekosistemin inovativ që ne po e ndërtojmë në Parkun Shkencor Inovativ, por edhe në qendrat e tjera nëpër regjionet e Kosovës dhe Shqipërisë. Mekatronika, energjia, robotika, ICT, ndërmarrësia, ndërtimi, arkitektura, dizajni industrial, shëndetësia, ushqimi, turizmi, menaxhimi i projekteve e shumë programe të tjera, për herë të parë në Kosovë janë zhvilluar në UBT", ka thënë rektori Hajrizi.

Ky samit është duke u mbajtur për herë të parë në Kosovë, me qëllim diskutimin mbi rolin kyç të arsimit dhe aftësisë profesionale në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës, organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me Fondacionin BESA.

Rektori Hajrizi shpalos para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare platformën digjitale "PlanifikoVET"



Përmes platformës online, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka prezantuar para pjesëmarrësve të institucioneve vendore dhe përfaqësuesve të tjerë, platformën digjitale "PlanifikoVET", e cila është pjesë e formulës së financimit për arsimin profesional. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka thënë se ka qenë kënaqësi që UBT të jep kontributin dhe ekspertizën e saj në procesin e analizimit të financimit të

arsimit profesional. "Për ne ka qenë kënaqësi e veçantë të kemi mundësi të kontribuojmë në procesin e analizës së financimit të arsimit profesional, duke marrë parasysh se kjo formulë është shumë e rëndësishme, dhe gjithmonë e potencojmë si komponentë të rëndësishme të zhvillimit në përgjithësi, për krijimin e kompetencave por edhe ndikimin në zhvillimin e përgjithshëm dhe specifik ekonomik të Kosovës", ka

thënë rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi, para pjesëmarrësve, në mënyrë virtuale ka shtjelluar në detaje edhe formën se si kanë punuar dhe se si kanë ardhur deri tek kjo formulë e financimit, që nga kompletimi i zingjirit të furnizimit, ofrimi i tre skenarëve, si dhe udhërrëfimin për mënyrën se si funksionon platforma "PlanifikoVET", në mënyrë që të rritet cilësia e arsimit profesional.

"Në bazë të gjendjes kemi parë se mund të riorganizohet aspekti financiar pa dëmtuar aspektet ligjore, pa hyrë thellë në ligjet e financimit, prokurimit, komponentëve të ligjeve të arsimit, por me një adaptim, me një ndryshim, duke iu ofruar rrethanave të nevojshme të fushave të caktuara të arsimit profesional mundësi për kompletimin e financimit, në mënyrë që të jemi më cilësor në aspektin e ofrimit të këtij edukimi", ka thënë rektori i UBT-

së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Pjesëmarrës në këtë takim përveç përfaqësuesve të organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ishte edhe ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, e cila përkrahu formulën e financimit për arsimin profesional si dhe platformën e zhvilluar, duke theksuar se tashmë duhet të merret një vendim për mënyrën se si do të shkojë tutje ky proces.

"Si Ministri e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, sigurisht që i jemi shumë mirënjohës të gjithë donatorëve që na kanë mbështetur në këtë proces gjatë viteve, sidoqoftë mendojmë se tani është momenti kur pas shumë diskutimeve, propozimeve, trajtimit të ideve të ndryshme, të marrim vendimin për një zgjidhje konkrete të kësaj problematike sepse tashmë duhet të kemi një situatë

më të mirë dhe një financim që mundëson mbarëvajtjen e punës në shkollat e arsimit dhe aftësisë profesionale", ka thënë ministria Nagavci. Kjo formulë e financimit është zhvilluar nga UBT për programin ALLED2, financiar nga Komisioni Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim, formulë në të cilën shtjellohen në detaje skenarët të cilët duhet ndjekur për një zgjidhje efektive, duke sjellë analiza dhe rekomandime të opsioneve të mundshme të mundshme rreth financimit të AAP-së në Kosovë, brenda kornizës legislative ekzistuese. UBT vazhdimisht është shquar si institucion i arsimit të lartë për kontributin në arsimin profesional, veçanërisht në fushat që ndërlikohen me STEM (Science, Technology, Engineering and Mathematics), në ngritjen e infrastrukturës moderne, si dhe në ofrimin e praktikave më të mira austriake, gjermane, zvicerane, e të shteteve të ndryshme të botës.

Rektori Hajrizi zhvilloi takim me zëvendës ministrin e Punëve të Jashtme, Kreshnik Ahmeti



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi bashkë me profesorin Petrit Ahmeti, kanë zhvilluar një takim pune me zëvendës ministrin e Punëve të Jashtme, Kreshnik Ahmeti, ku diskutuan për mbështetjen që UBT po ofron në fushën e digitalizimit të shumë proceseve të Ministrisë së Punëve të Jashtme

dhe ambasadave të Kosovës. Në këtë takim, rektori Hajrizi bashkë me zëvendës ministrin Ahmeti, diskutuan edhe për aplikimin e realitetit virtual, si një mundësi për promovimin e kulturës dhe të trashëgimisë së Kosovës, në mënyrë që të mbahen më afër bashkëatdhetarët në interes të promovimit dhe

përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.


Ndër të tjera, në këtë takim, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi bashkë me profesorin Petrit Ahmeti dhe zëvendës ministrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, diskutuan edhe për sigurinë kibernetike dhe angazhimin dhe mundësinë e përfshirjes së diasporës në zhvillimet e Kosovës.

Rektori Hajrizi dhe zëvendës ministri Ahmeti, u dakorduan që të vazhdojnë komunikimin duke ofruar mbështetjen e ndërsjelltë lidhur me zhvillimet dhe përmirësimin e përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Nën udhëheqjen e rektorit Hajrizi u mbajt mbledhja e Komitetit Teknik për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

Në kuadër të Agjencisë Kosovare për Standardizim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, është mbajtur mbledhja e Komitetit Teknik për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, e udhëhequr nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi. Në cilësinë e kryetarit të Komitetit Teknik për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, prof. dr. Edmond Hajrizi, së bashku me anëtarët e tjerë të komitetit kanë aprovuar 51 standarde të reja të fushës së sistemit të menaxhimit të cilësisë (standartet EN/ISO dhe ISO/IEC). Kryetari i Komitetit Teknik për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, prof. dr. Edmond Hajrizi, tha se këto standarde pasurojnë listën e

standardeve të Kosovës për standardizim, dhe se luajnë rol të madh në zhvillimin e institucioneve në zbatimin e standardeve të cilësisë. Ai ka shtuar se institucionet janë duke zbatuar standardet e cilësisë, teksa ka bërë thirrje për ngritjen e interesimit dhe kërkesave specifike për standarde, në mënyrë që lista e standardeve të cilësisë e Kosovës të kompletohet. Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS) është një organ kombëtar për udhëheqjen, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së standardizimit në Kosovë, në kuadër të së cilës funksionon Komiteti Teknik për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (KTSMC).





Studentet e Shkencave të Ushqimit në UBT, vizituan kompani të produkteve ushqimore në Mitrovicë

Studentet e Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Aurora Vokshi dhe Dijellza Çerkezi, në kuadër të praktikës profesionale kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën e Kërpudhave "Horano Mushroom", kompaninë "Camell", si dhe në kompaninë "Aldi", në Mitrovicë. Vizita është realizuar në shoqërimin e profesoreshës Dr.Sc. Afete Musliu, teksa studentet janë njoftuar rreth procesit të prodhimit të produkteve nëpër këto kompani, panë sistemin me të cilin funksionon kjo kompani, standardet me të cilat punon dhe rezultatet që kanë arritur që nga themelimi e deri tek prodhimi. Studentet patën rastin të monitorojnë nga faza fillestare deri tek produkti final, si dhe të analizojnë bazat e toksinologjisë, menaxhimin e cilësisë dhe sigurisë në këto produkte.



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë realizuan vizitë studimore në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë realizuan vizitë studimore në IHMK (Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës), të cilët u pritën nga përgjegjësi i institutit njëherësh edhe profesor i UBT-së Shkumbin Shala. Ata patën rastin të shohin nga afër infrastrukturën monitoruese të stacioneve elektronike për parametrat e rrezatimit diellor, shpejtësisë së erës, matjet gjeotermale dhe parametrat

e grimcave ndotëse nga djegjet fosile. Studentët poashtu vizituan edhe labororet e sofistikuara që ka institute për të gjitha analizat e mundshme ndotëse dhe aplikimin e platformës programore për monitorimin dhe menaxhimin e të dhënave në sistemin online. Vizita ka pasur karakter interaktiv ku studentët vazhdimisht parashtuan pyetje duke i ndërlidhur njojtë teorike të fituar përgjatë ligjëratave.

UBT ka mbajtur webinarin "Sondazhet elektorale në Kosovë mes realitetit shkencor dhe politikës"

Fakulteti Shkencat Politike në UBT ka mbajtur webinarin virtual "Sondazhet elektorale në Kosovë mes realitetit shkencor dhe politikës", ku u diskutua për sondazhet elektorale që po realizohen në Kosovë, në prag të zgjedhjeve parlamentare. Panelistët e këtij webinarit trajtuan dhe debatuan matjet e fundit që kompani të ndryshme po bëjnë për të krijuar opinion publik, mbi rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të këtij viti. Visar Berisha nga kompania "Kantar", ka thënë se sondazhet elektorale të publikuara deri më

tani në Kosovë, nuk kanë qenë transparente. "Në shumicën e rasteve kanë munguar apo ka qenë e paqartë mosha e respondentëve, së bashku me teknikën e mbledhjes së të dhënave, si dhe faktin se sa ka qenë refuzimi i mostrës përgjigje, sepse në rast se ka një numër të madh të refuzimit, mundet që shumë lehtë të shtrembërohet i gjithë hulumtimi", ka thënë Berisha. Ndërsa profesori Ridvan Peshkopia ka vlerësuar se sondazhet janë një fenomen i ri në Kosovë dhe Shqipëri, duke shtuar se anketimi i opinionit

publik është proces prodhimi. Ai ka thënë se gabimet e metodologjisë hulumtuese shpesh herë nuk i kapin ndryshimet e strukturës shoqërore, teksa ka marrë si shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Në shumicën e rasteve kompanitë hulumtuese nuk tregojnë saktësisht se çka është matur sepse shumë gjëra pastaj mund të dalin të pasakta dhe të pavlera, si shembull në nuk e dimë sa është faktorizimi i gatishmërisë për të votuar pikërisht te këta respondent", ka thënë Peshkopia.

Biblioteka e UBT-së, një ndërlidhje mes librit fizik dhe atij elektronik

Të gjithë miqtë e librit, shkencës e dijes, tashmë e kanë një vend gjigant ku mund të studiojnë e gjejnë tituj nga më të ndryshmit që biblioteka e UBT-së i posedon. Biblioteka e UBT-së ka bërë gërvshimin e librit dhe teknologjisë, duke u ofruar studentëve dhe lexuesve një vend unik, me hapësira të veçanta për lexim, për të studiuar dhe hulumtuar çështje të ndryshme të shkencës. Biblioteka e UBT-së ofron një ambient të këndshëm për të lexuar, me më shumë se 250 mijë libra fizik dhe 52 mijë tituj në dispozicion. Ky ambient i veçantë i institucionit përmban tituj nga të gjitha drejtimet të cilat i ofron UBT, duke përfshirë këtu edhe enciklopedi dhe fjalorë të ndryshëm. Librat të cilat gjenden në bibliotekën universitare të UBT-



së janë në gjuhën shqipe, angleze, gjermane dhe në atë serbe. Përpos kësaj, për të gjithë studentët e rinj dhe ambicioz që dëshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre, UBT ka bërë digitalizimin e bibliotekës, duke e shndërruar në bibliotekë elektronike, duke

u anëtarësuar në tri bibliotekat më të njohura elektronike, përfshirë EBSCO-n, SAGE Journals dhe J-Store. Biblioteka gjendet në magistrallen Prishtinë – Ferizaj afër rrethit të QMI-së, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Studentët e Fakultetit Juridik të nivelit master realizojnë vizitë studimore në ARKEP

Studentët e nivelit master, drejtimi Forenzikë Kompjuterike në Fakultetin Juridik në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Studentët u pritën nga shefi i njësies për siguri kibernetike, Shpend Lutfiu, si dhe nga profesoresha Rrezarta Ajeti, shefe e departamentit ligjor në këtë institucion, ku u njoftuan për së afërmi mbi punën dhe fushëveprimtarinë që ky institucion zhvillon. Ndër të tjera studentët u njoftu-

an rreth kodeve të internetit, sigurisë kibernetike, krimeve kibernetike, standardeve teknike dhe organizative të sigurisë dhe integritetit të rrjeteve të internetit, vlerësimit të rrezikut, masave të sigurisë, raportimin e incidenteve si dhe shkëmbimin e informacionit. Fakulteti Juridik në UBT, përmes standardeve të larta të studimit vazhdon që të fuqizojë studentët, duke i mbështetur ata profesionalisht në sfidat e tyre në fushën e juridikut, me ekspertët më të mirë të kësaj fushe.

Studentët e Fakultetit Shkencat Politike marrin pjesë në webinarin e organizuar nga DEMOS

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit Shkencat Politike në UBT, kanë marrë pjesë në webinarin e organizuar nga Projekti për Decentralizim dhe Përkrahja Komunave/DEMOS, me temë "Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarëve në kohë pandemie". Në këtë webinar studentët diskutuan dhe u njoftuan më shumë me sfidat rreth

pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale gjatë pandemisë. Në këtë webinar pjesëmarrës ishin edhe kryetarët e komunave të Kamenicës dhe Rahovecit si dhe organizata dhe pjesëmarrës të tjerë nga shoqëria civile, ku bashkë me studentët patën një bashkëbisedim të frytshëm rreth kësaj teme.

Studentët e Shkencave të Ushqimit në UBT, realizuan vizitë studimore në mullirin "Anidoni Grup"



Studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit në UBT, specializimi Teknologji Ushqimore, kanë realizuar vizitë studimore në mullirin

"Anidoni Grup", të cilët u pritën nga pronari i kompanisë në fjalë. Përgjatë vizitës studimore studentët patën rastin të shohin nga

afër klasifikimin e grurit, bluarjen, llojet e sitave që përdoren, tërë linjën e prodhimit deri në ambalazhim. Studentët rëndësi të madhe i kushtuan edhe cilësisë së miellit dhe përmbajtjen proteinike të saj. Ndërlidhja e teorisë dhe praktikës përgjatë studimeve në UBT, i aftëson studentët në marrjen e njohurive profesionale dhe siguron që studentët të jenë shumë të përgatitur për tregun e punës.

UBT mbajti simpoziunin ndërkombëtar virtual “Qytetet në ballkan – sfidat zhvillimore, proceset dhe përmbajtja e dokumenteve, në linjë me trendët dhe normat e BE-së”

Është mbajtur simpoziunimi ndërkombëtar virtual “Qytetet në ballkan – sfidat zhvillimore, proceset dhe përmbajtja e dokumenteve, në linjë me trendët dhe normat e BE-së”, organizim i UBT-së në bashkëpunim me institucionet akademike dhe të shoqërisë civile nga Kosova dhe Shqipëria, mbështetur nga Asociacioni Ndërkombëtar i Planerëve Urban dhe Regional (SOCARP).

Ky simpoziun mblodhi fizikisht dhe virtualisht ekspertë, profesionistë, akademikë e aktivistë të shoqërisë civile nga Kosova, Shqipëria, Rumania, Belgjika, Italia, Skocia e SHBA, të cilët diskutuan për proceset dhe dinamikat e planifikimit hapësinor dhe urban në rajon, me fokus Prishtinën dhe Tiranën, analizimin e këtyre proceseve dhe dinamikave në kontekst të dinamikave të planifikimit në BE, si dhe për propozimet e ekspertëve ndërkombëtarë, njohës të realitetit në rajonin tonë, për



krijimin e modeleve origjinale si dhe univerzale të planifikimit për rajonin dhe shoqëritë tona.

Në fjalën hyrëse rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka thënë se ky organizim është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për Kosovën dhe Shqipërinë në tërësi, por për tërë qytetet e ballkanit.

“Duke e marrë parasysh se ne jemi duke jetuar në një revolucion konvergjent, të gjitha këto transformime në të cilat po kalojmë, qytetet janë një element i rëndësishëm për t’u studiuar, ndaj duhet të parashtrahet pyetja se si do të jetë e ardhmja e qyteteve, dhe si do të organizohen që

të kenë një qëndrueshmëri”, ka thënë prof.dr. Edmond Hajrizi. Me këtë simpoziun u shënuar edhe themelimi i “Forumit Ballkanik të Qyteteve”, i cili synon të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse në të cilën ekspertë, profesionistë, akademikë, institucione qendrore e lokale si dhe aktivistë të sho-

qërisë civile do të mund të diskutojnë dhe të kërkojnë zgjidhje për sfidat e përditshme të qyteteve, rrjedhimisht të shoqërive tona në Ballkanin Perëndimor; teksa UBT ka shprehur edhe njëherë gatishmërinë për të përkrahur në të gjitha format këtë forum.

Ky simpoziun mblodhi fizikisht dhe virtualisht ekspertë, profesionistë, akademikë e aktivistë të shoqërisë civile nga Kosova, Shqipëria, Rumania, Belgjika, Italia, Skocia e SHBA, të cilët diskutuan për proceset dhe dinamikat e planifikimit hapësinor dhe urban në rajon, me fokus Prishtinën dhe Tiranën, analizimin e këtyre proceseve dhe dinamikave në kontekst të dinamikave të planifikimit në BE, si dhe për propozimet e ekspertëve ndërkombëtarë, njohës të realitetit në rajonin tonë, për krijimin e modeleve origjinale si dhe univerzale të planifikimit për rajonin dhe shoqëritë tona.

UBT në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Sport ka mbajtur konferencën: “Futboli dhe ndikimi i tij në promovimin e shtetësisë së Kosovës”

Në ambientet e Kampusit Inovativ në Parkun Shkencor të UBT-së në Lipjan, UBT në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Sport ka mbajtur konferencën me temë: “Futboli dhe ndikimi i tij në promovimin e shtetësisë së Kosovës”, disa ditë para ndeshjeve shumë të rëndësishme që do të zhvillojë Kombëtarja e Kosovës në futboll.

Në këtë konferencë morën pjesë fizikisht dhe virtualisht rektori i UBT-së si nikoqir, prof.dr. Edmond Hajrizi, ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington znj. Vlora Çitaku, z. Eroll Salihu nga Federata e Futbollit të Kosovës, si dhe gazetari i njohur nga Brukseli, z. Augustin Palokaj. Në këtë konferencë profesor i Richard Giulianotti nga Mbretëria e Bashkuar dhe z. Juan Manuel Montoro nga Spanja, prezantuan

an dy tema të lidhura me rolin e sportit dhe shoqërisë, si dhe ndikimin e futbollit në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Spanjës.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, u shpreh se marrëdhënia e shëndetshme midis sportit dhe shoqërisë, me ndërmjetësimin e akademisë dhe diplomacisë, është e rëndësishme për rritjen e nivelit të talentit dhe impaktit të sportit në Republikën e Kosovës.

“Imazhi më i mirë që Kosova mund t’i tregojë botës, është një imazh i një shoqërie të shëndetshme, gjithashtu përmes sporteve, një shoqëri që është sa konkurruese edhe aq bashkëpunuese në arritjen e interesit të përbashkët”, u shpreh profesor Hajrizi duke shtuar se diplomacia jonë më e mirë

është përmes fuqizimit të sportistëve në sportet individuale dhe ekipore brenda Republikës së Kosovës, në mënyrë që të përfaqësojmë me krenari shtetin tonë në nivelet më të larta.

Nga ana e saj, znj. Vlora Çitaku është shprehur mbi lidhjen e pashmangshme të sportit me politikës.

“Marrëdhënia e sportit me politikën dhe me identitetin është e lashtë dhe e pashmangshme. Sporti si koncept që në lashtësi është përdorur për qëllime politike dhe ushtarake, për të përzgjedhur ushtarët më të mirë për të arritur qëllimet politiko-ushtarake. Në rastin e Kosovës, sporti ka rrëzuar muret e mosnjohjes për Kosovën, me atletët e sportistët tanë që kanë udhëtuar në mbarë botën, edhe në vende mos-njohëse, duke

shkëlqyer dhe ngritur flamurin tonë në majat më të larta”, u shpreh ajo duke thënë se sporti i Kosovës ka qenë më i suksesshëm në arritjen e kufijve të rinj ndërkombëtar, se sa vetë politika e Kosovës.

“Jemi të bekurur që fëmijët tanë kanë si heronj sportistë të suksesshëm të Kosovës. Jam e bindur që në ndeshjen e futbollit me Suedinë, Kosova do të fitojë”, është shprehur ish-ambasadorja Çitaku.

Profesor Giulianotti argumentoi në këtë konferencë se arritja e balancës mes investimeve në sport dhe vendosmërinë për të arritur rezultate gjithëpërfshirëse brenda Kosovës, është kyçe për ndërtimin e një kulture sportive në vend.

Ai theksoi se sporti është një dritare e rëndësishme për promovimin e një edukimi shoqëror bazuar mbi barazi gjinore, luftë ndaj diskriminimit dhe promovimin e paqes. Në të njëjtën linjë, Montoro shtoi se aktivitetet sportive ndërkombëtare janë të rëndësishme për promovimin e Republikës së Kosovës. Ai iu

ka referuar ndeshjes së kombëtares së futbollit të Kosovës me Spanjën javën e ardhshme, si një moment historik për prezantimin e Kosovës si një entitet i veçantë e i pavarur tek publiku spanjoll.

“Kjo do t’iu mundësojë autoriteteve politike spanjolle të rrisin vëmendjen ndaj rritjes së komunikimit me Republikën e Kosovës, dhe t’i tejkalojnë edhe barrierat politike imagjinare”, u shpreh ai.

Në përfundim, pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë më gjerësisht mbi këtë temë duke iu përgjigjur pyetjeve nga publiku virtual të cilët ishin pjesëmarrës në këtë konferencë. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, falënderoi pjesëmarrësit dhe folësit për kohën dhe angazhimin e tyre për këtë temë, duke shtuar se ka besim që do të shohë një rritje të nivelit të sportit në Kosovë, si fryt i bashkëpunimit të të gjitha institucioneve në vend.

Studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji realizojnë vizitë studimore



Studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, programi master, kanë realizuar vizitë studimore në dy industri, në fabrikën “Birra Prishtina” dhe fabrikën e përpunimit të qumështit “TEOS-E”.

Ata kanë parë nga afër mënyrën se si realizohet procesi i prodhimit dhe përpunimit, në

secilën prej këtyre dy industrive, duke u interesuar edhe për detajet se si zhvillohet ky proces. UBT vazhdimisht është duke organizuar vizita studimore për secilën fushë studimi, duke kombinuar në mënyrë unike praktikën me teorinë, me qëllim që studentët të kenë më të qartë procesin e punës në industri.

UBT shënoi Javën e Shëndetit Oral

Me qëllim të vetëdijesimit lidhur me rëndësinë dhe rolin e shëndetit oral, studentët e Fakultetit të Stomatologjisë në bashkëpunim me Grupin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, me anë të disa aktiviteteve simbolike, kanë shënuar Ditën Botërore të Shëndetit Oral, në qendrat e Viva Fresh nëpër Kosovë. Kjo javë u shënuar me moton “Buzëqeshi jetës” ku studentët e Fakultetit të Stomatologjisë, kanë shpërndarë fletëpalosje me përmbajtje sensibilizuese dhe informuese për qytetarët lidhur me rëndësinë e vizitave të rregullta të stomatologu.

Në këtë aktivitet përfituan shumë qytetarë të rastit përfshirë edhe fëmijë, të cilëve edhe u janë dhuruar brusha të dhëmbëve për higjienë të mirë të dhëmb-



bëve dhe gojës. Dita Botërore e Shëndetit të Oral e vendosur nga Federata Dentare Botërore (FDI), organizohet çdo vit më datë 20 mars. Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin, si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien e

qytetarëve. “UBT është pararojë në Kosovë si fituese edhe në nivel rajonal e ndërkombëtar i kompedicioneve të sporteve virtuale. Do të rrisim përfshirjen tonë të akademisë me sportin duke synuar që të hapim edhe një program të studimeve për sportin në UBT”, theksoi rektori Hajrizi.

UBT pjesë e rrjetit të universiteteve që kanë nënshkruar dokumentin Magna Charta Universitatum

Institucioni lider i arsimit të lartë në vend – UBT, nga sot është bërë pjesë e rrjetit të universiteteve që kanë nënshkruar dokumentin Magna Charta Universitatum.

Dokumentin e ka nënshkruar rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, duke u bërë pjesë e një rrjeti të madh global të më shumë se 900 institucioneve të arsimit të lartë të të gjithë botës që kanë nënshkruar këtë dokument. Rektori Hajrizi është shprehur i lumtur me nënshkrimin e këtij dokumenti duke thënë se UBT me këtë rast ka shënuar edhe një tjetër sukses në arenën ndërkombëtare.

“Nënshkrimi i dokumentit që daton nga 18 shtatori i vitit 1988, është një hap tjetër i madh dhe shumë i rëndësishëm i UBT-së në përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një do-



kument që bazohet në parime të lirisë akademike dhe autonomisë institucionale është në përputhshmëri me atë që UBT prezanton, ndaj si e tillë është diçka shumë e rëndësishme për ne”, ka thënë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi.

UBT me nënshkrimin e Magna Charta Universitatum, dëshmon edhe njëherë lidhësinë, cilësinë dhe profesionalizmin në fushën e arsimit, duke respektuar gjithmonë parimet themelore të fushëveprimit dhe misionit të institucioneve të arsimit të lartë. Magna Charta Universitatum është një deklaratë e nënshkruar në vitin 1988, me rastin e 900 vjetorit të Universitetit të Bolonjës, e cila dëshmon dhe përkrah parimet themelore mbi të cilat duhet të bazohet misioni i universiteteve.

Profesorë e studentë të UBT-së, prezantojnë punimet dhe projektet shkencore në Bullgari



Profesorët e Fakultetit Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, prof.dr Zhilbert Tafa dhe prof.dr Besnik Qehaja, njëherësh edhe studentët e UBT-së që po kalojnë një semestër të studi-

meve në Bullgari, kanë prezantuar projektet dhe punimet e tyre shkencore në kuadër të programit të Bashkimit Evropian Erasmus+.

Në punimet hulumtuese ata tra-

jtuan tema që për fokus kishin Internet of Things si dhe infrastrukturën e telekomunikacionit të UBT-së dhe projektet që janë duke u zbatuar si “UBT Smart City” dhe rrjeti 5G, që ndryshe njihet si gjenerata e pestë e teknologjisë së rrjeteve celulare pa tela.

UBT vazhdimisht mbështet të rinjtë dhe të rejtat në ambiciet e tyre për t’u zhvilluar profesionalisht në rrugëtimin e tyre në karrierë, përmes ekspertëve më të mirë të fushave përkatëse, duke zhvilluar interaktivitetin profesorë-studentë në një nivel krejtësisht tjetër.

Studentët e Shkencave Politike vizitojnë Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Një grup i studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike të udhëhequr nga profesor Arian Kadriu, kanë realizuar vizitë studimore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ku u takuan me dekanin e Fakultetit të Sigurisë Publike, Bejtush Gashin, prodekanin Nexhat Jasharin dhe stafin tjetër të FSP-së.

Qëllimi i vizitës ishte që studentët të njihen më për së afërmi me funksionimin e Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Gjatë kësaj vizite para studentëve të UBT-së u bë një

prezantim për rolin, misionin e akademisë dhe për programin studimor të FSP-së.

Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike, Bejtush Gashi, para studentëve bëri një përmbledhje në pika të shkurta rreth historikut dhe sfidave më të cilat janë përballur gjatë procesit deri në hapjen e Fakultetit të Sigurisë Publike.

Studentët e UBT-së gjatë kësaj vizite patën rastin të shkëmbejnë përvoja dhe të shtjellojnë çështje të ndryshme me stafin akademik të Fakultetit të Sigurisë Publike.

UBT ka mbajtur webinarin: “Financial instruments in securities markets in the European Union”

Fakulteti Juridik në UBT ka mbajtur webinarin e zhvilluar përmes platformës online me temë: “Financial instruments in securities markets in the European Union”, ku është diskutuar dhe janë ndarë përvoja për instrumentet financiare në Bashkimin Evropian.

Pjesëmarrës në këtë webinarin ishin dekanin e Fakultetit Juridik në UBT, prof.dr. Visar Hoxha, si dhe drejtori menaxhues i kompanisë

Anepremicnine, Gregor Žvipelj. Si profesori Hoxha, ashtu edhe drejtori menaxhues i kompanisë Anepremicnine, Gregor Žvipelj, dhanë shpjegime dhe përfundime për shërbimet e investimeve dhe tregjet e rregulluara, tregjet në instrumentet financiare, kapitalin e Bashkimit Evropian, bazën ligjore, si dhe monitorimin dhe investimet jashtë vendit.

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT certifikohen për platformën për biznes “Capsim”

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në nivelin master, kanë ndjekur ligjërata në platformën unike të menaxhimit “Capsim”, platformë në të cilën iu është mundësuar simulimi i funksionimit të një biznesi. Ligjëratat dhe simulimi përgjatë gjithë semestrit u bë nga eksperti i njohur i fushës së biznesit, ligjëruesi në UBT, Carlos Gutierrez, dhe i përkrahur nga ligjëruesi Bejtush Ademi, në kuadër të lëndës “Konsulencë menaxheriale”. Gjatë këtij simulimi, studentët janë ndarë në grupe, teksa secili

grup ishte një kompani në vete, brenda së cilës, secili student kishte një funksion të caktuar menaxhimi. Grupet gjetën metodat më efektive të të bërit biznes, ndërkaq, sikurse edhe një biznes i vërtetë, bizneset e tyre të simuluar patën uljet dhe ngritjet e veta, duke i marrë për bazë të gjithë faktorët ekonomikë. “Capsim” është një platformë që zhvillon simulime të biznesit dhe vlerësime të bazuara në simulime, që matin dhe zhvillojnë aftësitë kritike të biznesit, të nevojshme për sukses në karrierë biznesi.

Studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor vizitë studimore në objektin e Qendrës më të madhe të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë “UBT Smart City”



Studentët e vitit të tretë të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, kanë përcjellë nga afër punimet që po bëhen gjatë ndërtimit të objektit të Qendrës më të madhe të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë “UBT Smart City”, e cila do të jetë qendra e parë e këtij lloji në Kosovë dhe do të mundësojë rritjen e vendeve të punës, ndërmarrësisë,

inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë.

Ata në kuadër të lëndës mësimore “Puna Praktike në Terren”, u informuan dhe panë për së afërmi punimet që janë duke u zhvilluar në objektin e ri të UBT-së, me organizimin e punës, kontrollimin e kualitetit të punës, betonimin, teksa u njohën më shumë me përgjegjësitë dhe kompetencat që ata do t’i kenë

në të ardhmen, në ushtrimin e këtij profesioni.

Qendra e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të jetë e vendosur në Parkun Shkencor dhe Teknologjik të UBT-së, me një hapësirë rreth 28 mijë metra katrorë, ku kjo qendër përveç tjerash do të ketë edhe vende për punë praktike, laboratorët, konviktin, bibliotekën, kuzhinën, inkubatorin, industrinë të vogla, hapësira për biznese të reja, qendrat kreative, hapësira sportive dhe të gjitha elemente të tjera të nevojshme për të plotësuar një ekosistem inovativ.

UBT i konsideron tejet të rëndësishme vizitat studimore, pasi që studentët e shohin nga afër zhvillimin dhe mënyrën se si realizohet puna në profesionin dhe fushën që ata kanë zgjedhur të studiojnë.

UBT mbajti debatin “Ushtrimet ndërkombëtare të FSK-së, Defender - Europe 21”



Në ambientet e Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, është mbajtur debati me komandantin e Njësisë Elitare të FSK-së në Gjiilan, nënkolonel, Albert Kuqi, organizuar nga Fakulteti Shkencë Politike në UBT.

Në këtë debat u diskutua për rrugëtimin dhe transformimin e FSK-së në ushtri, nga përvoja dhe eksperiencia e komandantit

të Njësisë Elitare të FSK-së, në Gjiilan, nënkolonel, Albert Kuqi. Ndër të tjera është diskutuar edhe për misionet paqeruajtëse ndërkombëtare të FSK-së dhe sfidat e sigurisë, teksa stafi dhe studentët e UBT-së janë informuar më shumë për stërvitjen e përbashkët të FSK-së me NATO-n në kuadër të Defender - Europe 21.

Në UBT u diskutua virtualisht për rëndësinë e informimit dhe efijencës mediatike

UBT gjithmonë ka shtyrë përpara rëndësinë e informimit nga mediat, edukimin medial dhe lirinë e shtypit, kështu edhe duke krijuar Fakultetin Media dhe Komunikim, që ka sjellë gjenerata e gjenerata që përcjellin dhe ruajnë informacionin e drejtë tek opinioni publik.

Mu për këtë, me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, UBT në bashkëpunim me Fakultetin Media dhe Komunikim, ka mbajtur konferencën online me temë: "Rëndësia e informimit dhe efijencia mediatike", ku është diskutuar rreth rëndësisë së vlerësimit të informacionit si një nga asetet e interesit të përgjithshëm publik.

Kjo konferencë mbledhi virtualisht shumë ekspertë e profesionistë të fushës së gazetarisë të cilët nxorën në pah tri çështje, transparencën, efijencën në konvergencën mediatike informative, si dhe qëndrueshmërinë e vërtetësisë së lajmeve në media.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Ferid Selimi, në hapje të konferencës vlerësoi se edukimi medial dhe informativ do të duhej të ishte një ndër



Rëndësia e informimit dhe efijencia mediatike

proceset që do të ndodhte në Kosovë, në mënyrë që të vlerësohej, mbrohej dhe ruhej edhe më mirë gazetaria e mirëfilltë si një nga sferat jetësore, duke fuqizuar edhe më shumë rëndësinë dhe dobinë e informacionit.

Profesori në UBT, Musa Sabedini, tha se media online ende ka probleme të cilat duhen zgjidhur bashkërisht me institucionet pasi që sipas tij mediat janë partnere të tyre.

"Institucionet duhet të bashkëpunojnë me mediat sepse me-

diat janë partnere. E keqja është se në Kosovë ka media online paralele me ato profesionale të afërta me parti politike, e që bëjnë një problematikë të verifikimi i këtyre mediave", ka thënë profesori i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Musa Sabedini. Ish-kryetari i KPM-së, njëherësh ligjërues në UBT, Adnan Merovci, në këtë konferencë vuri theksin te Komisioni i Pavarur i Mediave, mediat e shkrjuara, mediat online si dhe te vetërregullimi i mediave. "Është një trend që duhet fa-

vorizuar rreth vetërregullimit të mediave, dhe nuk ka më mirë se sa mediat vet të rregullohen. Problemet kryesisht lindin te mediat online, çështja e ilegalitetit e të tjerat, sepse askush nuk i lejon dhe as ndalon ato në veprimet që ndërmarrin, pasi që bota njihë realitete të ndryshme rreth kësaj", ka thënë ai.

Për institucionet e shtetit dhe raportin që kanë ata me mediat foli profesori dhe eksperti i fushës së medias, Safet Zejnullahu, i cili më shumë vuri theksin tek qasja që institucionet kanë drejtuar mediave.

"Më shumë jam pro qasjes së ndarjes së mediave profesionale dhe atyre joprofesionale, pasi që media në Kosovë duhet të zhvillohet në media profesionale, që e hedh jashtë lojë median joprofesionale, dhe ta bëjë një kategori mediash cilësore dhe të pa ndikuar", tha profesori Zejnullahu. Gazetarja dhe profesoresha e UBT-së, Dafina Lata, ka theksuar se institucionet duhet të bëjnë më shumë në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të gazetarëve ndaj sulmeve të ndryshme ndaj secilit medium apo gazetar.

"Institucionet, gjykatat dhe prokuroria duhet të bëjnë më shumë për mbrojtjen e gazetarëve me ligjet që janë në fuqi, ndaj sulmeve dhe rreziqeve që iu kanosen atyre përgjatë raportimit që ata bëjnë, duke mos harruar asnjëherë se ata bëjnë raportime edhe në kushte të jashtëzakonshme, siç është rasti me pandeminë", ka thënë ajo.

Në fund, nga kjo konferencë u konkludua se edukimi medial duhet të jetë aktiv, mediat duhet të kenë më shumë përgjegjësi në atë që raportojnë, të ekzistojnë trajnime të ndryshme me staf të ri për gazetar të rinj, si dhe niveli i etikës të respektohet.

UBT me zhvillimin e Fakultetit Media dhe Komunikim vazhdimisht është duke prodhuar kuadro profesionale në fushën e gazetarisë që luftojnë në të drejtën e tyre për të informuar lirshëm, gjithmonë duke u mbështetur në format e komunikimit dhe parimet e demokracisë.

Koordinatorja për Zhvillim e OKB-së në Kosovë, Ulrika Richardson, vizitoi UBT-në



Koordinatorja për Zhvillim e Agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT), Ulrika Richardson, javën e kaluar, vizitoi Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, ku u prit nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i cili prezantoi ekosistemin e këtij institucioni lider arsimor në Kosovë.

Në këtë takim, rektori Hajrizi foli edhe për arritjet e shënuara në sferën ndërkombëtare ku UBT në renditjen globale "Impact Rankings 2021" të publikuar nga revista prestigjioze, Times Higher Education, është pozicionuar në mes të institucioneve më të mira në botë për impaktin në zhvillimin e qëndrueshëm, e që ndërlihet edhe me objektivat e agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë që funksionojnë nën ombrellën e UNKT-së.

"UBT është vlerësuar nga Impact Rankings 2021 për rezultate të larta në zbatimin e politikave të qëndrueshme në të cilat lidhen me industrinë, inovacionin dhe infrastrukturën (SDG 9), kontributin për paqen, drejtësinë dhe institucione të forta (SDG 16), mirëqënien shëndetësore dhe fizike (SDG 3), partneritetin

shumë-dimensional për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17) si edhe zhdukjen e varfërisë (SDG 1)", u shpreh me këtë rast rektori Hajrizi.

"Në veçanti, në këtë vlerësim UBT dallohet për impaktin për partneritetin shumë-dimensional për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17), ku përveç renditjes së shkëlqyer në këtë rankim, vlerësohet me notën më të lartë për impaktin në zhvillimin e kapaciteteve dhe strukturave për STEAM, që për ne si UBT dhe Kosovën është një arritje e shkëlqyer", shtoi ai.

Rektori Hajrizi po ashtu vlerësoi mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë përmes projekteve të shumta, duke veçuar me këtë rast punën e mirë të bërë nga UNDP.

Veprimi i përbashkët drejt aritjes së qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm, zgjidhje të bazuara në njohuri dhe inovacion ishin temat kyçe të këtij takimi gjithmonë duke u bazuar në investime të reja në arsim dhe zhvillim në shoqëri.

UNKT dhe UBT diskutojnë për krijimin e HUB-it për monitorimin e zbatimit të SDGs

Një delegacion nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNKT) zhvilloi sot një vizitë pune në UBT. Kjo vizitë ishte në kuadër të angazhimeve të përbashkëta për krijimin e një platforme të veçantë të të dhënave – një HUB-i të nivelit qendror përmes të cilit synohet që në kohë reale të monitorohet përmbushja e Sustainable Development Goals (SDGs), si objektiva globale për të cilat janë zotuar njëzëri të gjitha shtetet anëtare të OKB-së në vitin 2015.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, i njoftoi përfaqësuesit e UNKT-së se UBT nga revista prestigjioze globale, Times Higher Education është ranguar në mesin e institucioneve më të mira në botë për impaktin në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në rankimin e Times Higher Education, UBT është vlerësuar për rezultate të larta në zbatimin e politikave të qëndrueshme në të cilat lidhen me industrinë, inovacionin dhe infrastrukturën (SDG 9), kontributin për paqen, drejtësinë dhe institucione të forta (SDG 16), mirëqënien shëndetësore dhe fizike (SDG 3), part-



neritetin shumë-dimensional për zhvillimin e qëndrueshëm (SDG 17) si edhe zhdukjen e varfërisë (SDG 1).

Duke e marrë për bazë përvojën dhe ekspertizën profesionale të UBT-së në këtë fushë, gjatë këtij takimi u dakordua që të punohet bashkë me përfaqësuesit e Kuvendit dhe Zyrës për Planifikim Strategjik në Kryeministri për krijimin e një HUB-i qendror në të cilin do të përfshihen të gjitha të dhënat nga niveli lokal e qendror, nga secili sektor publik e

privat e të cilat ndërlihet me përmbushjen e Sustainable Development Goals (SDGs).

UBT dhe UNKT e shohin si domosdoshmëri krijimin e një HUB-it në të cilin do të integroheshin të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të qëndrueshme, për të monitoruar përmbushjen e 17 objektivave të përcaktuara në kuadër të luftimit të varfërisë, krijimit të barazisë dhe gjithpërfshirjes si dhe balancimit të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Profesori i UBT-së, Arsim Gërxhaliu dekorohet me çmimin "Kryqi i Nderit të Argjendtë"



Profesori i UBT-së, njëherit drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxhaliu është dekoruar me çmimin "Kryqi i

Nderit të Argjendtë", nga Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge. Këtë çmim, profesori Gërxhaliu, e ka marrë nga am-

basadori gjerman në Kosovë, Jörn Rohde, me kërkesë të presidentit të komisionit të Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge, gjeneral Wolfgang Schneiderhan. Nga Oda e Mjekëve të Kosovës vlerësojnë se ky çmim është shumë i rëndësishëm si për profesorin Gërxhaliu, ashtu edhe për gjithë Odën e Mjekëve të Kosovës. Ky çmim, profesorit Gërxhaliu i është dhënë për njohjen e shërbimeve të veçanta në zbulimin e varreve të të pagjeturve të luftës, në shërbim të paqes në vend.

UBT zyrtarisht hap Qendrën për Realitet Virtual dhe të Shtuar “EON Reality, Augmented and Virtual Center”

Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, dy gjigantë nga dy fusha të ndryshme, njëri nga teknologjia virtuale e njëri nga arsimit, “EON Reality” dhe UBT, kanë inauguruar Qendrën për Realitet Virtual dhe të Shtuar “EON Reality, Augmented and Virtual Center”, qendër kjo më e madhe dhe e vetmja në Ballkan.

Në ceremoninë solemne të inaugurimit të kësaj qendre pjesëmarrës ishte rektori njëherit edhe themelues i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, presidenti i kompanisë gjigante të teknologjisë virtuale “EON Reality”, Dan Lejerskar, ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, si dhe zëvendësmintirja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, hapjen e kësaj qendre të madhe virtuale e vlerësoj si shumë të rëndësishme për Kosovën dhe të rinjtë në vendin tonë, duke thënë se kjo qendër do të jetë në shërbim të të rinjve në fushat e edukimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

“Ne jemi duke përmblytur një investim 30 milionë dollarësh dhe me këtë ne mendojmë se do të ketë indikator shumë të rëndësishëm në edukim, në rritje të vendeve të punës, në eksport, poashtu edhe në promovimin e aftësive digjitale të Kosovës në aspektin e inovacionit. Gjeneratat e reja do të mësojnë me teknologjitë më të reja botërore që ndikojnë në krijimin e kompetencave më të qëndrueshme, dhe ky është



vetëm fillimi i një epike digjitale që UBT po e zbaton në Ballkan”, ka thënë rektori Hajrizi.

Presidenti i kompanisë së teknologjisë virtuale “EON Reality”, Dan Lejerskar, u shpreh i lumtur që është edhe njëherë në Kosovë, konkretisht në UBT, kësaj radhe për të bërë inaugurimin e një qendre shumë të rëndësishme për të rinjtë e Kosovës dhe Ballkanit në tërësi, që atyre u kontribuon shumë në zhvillimin e aftësive të tyre për shkencë, teknologji, edukim dhe inovacion, duke theksuar se ky investim do të mund të rritet edhe më shumë viteve të ardhshme.

“Unë jam shumë i lumtur që jam këtu për ta zyrtarizuar këtë qendër. Siç ju e dini, ju keni bërë një punë të jashtëzakonshme tashmë, dhe më duhet të them se jam i super impresionuar me vullnetin dhe gatishmërinë

tuaj, të studentëve dhe stafit të fakultetit për teknologjinë e re. Gjithashtu, jam shumë i kënaqur të ju njoftoj se ne jemi duke diskutuar, dhe kam qenë në gjendje të siguroj fonde shtesë përmes organizatave ndërqeveritare, kështu që një nga arsyet pse jam këtu është që t'i ofroj Kosovës aftësinë për të zgjeruar këtë projekt në një grant prej 150 milionë dollarëve, duke e zgjeruar në nivel kombëtar përmes arsimit dhe inovacionit, duke ndërvepruar me industrinë”, ka thënë presidenti i kompanisë gjigante të teknologjisë virtuale “EON Reality”, Dan Lejerskar.

Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka mirëpritur këtë investim të bërë, i cili sipas saj i kontribuon shumë imazhit të vendit, si dhe rinisë kosovare, e cila sipas saj është e përkushtuar

dhe ka shumë talent.

“Duke pasur një rini me shumë talent, shumë përkushtim, shumë zotim dhe shumë dëshirë për të mësuar, ky investim është një mesazh që përçon te të gjithë investitorët në Republikën tonë dhe jashtë, sepse tani pas covid-19 janë shumë kriza që kanë ardhur nga disa industri dhe shumë industri rreth botës të cilat krijojnë diversifikim të furnizimeve”, ka thënë ministria Hajdari.

Zëvendësmintirja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka thënë se inaugurimi i kësaj qendre Kosovës po i sjellë një teknologji të re dhe të dobishme në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, duke thënë se ky bashkëpunim i UBT-së me “EON Reality” ofron mundësi të reja të pasurimit pedagogjik në klasë.

“Unë sot kam nderin dhe kënaqësinë që të marr pjesë në inaugurimin e Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar që sjell në Kosovë një teknologji të re, të dobishme në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Përrurimi i kësaj qendre sot këtu është sa i nevojshëm e i mirëseardhur për komunitetin arsimor në Kosovë, aq edhe inspironues për ne për shkak se shndërohet në pikëtakim ku arsimit, teknologjia, inovacioni dhe shkenca bashkëveprojnë për të mirën e komunitetit dhe të gjithë shoqërisë”, ka thënë, zëvendësmintirja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna.

Nga të gjithë të pranishmit, ky investim u vlerësua si investim madhor dhe i qëlluar duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë virtuale dhe nevojën e krijuar së fundmi për këtë teknologji në fusha të ndryshme, duke krijuar kështu edhe një botë bindëse dhe shumë atraktive për mësim dhe mundësi të artë për të eksploruar në fusha të ndryshme studimi.

UBT është qendra më e madhe e teknologjisë virtuale në Ballkan, ku këtë platformë dëshiron ta instalojë në sistemin arsimor në Kosovë, me qëllim që gjithë studentët e të gjitha institucioneve arsimore në vend, publike dhe private, të përjetojnë teknologjinë e shekullit 21, njëherësh edhe të përfitojnë aftësitë e duhura në përgatitjen profesionale duke përdorur teknologji si kjo.

Kosova edhe këtë vit mori pjesë në garën më të madhe ndërkombëtare të robotikës, FIRST Global Challenge

Sikurse edhe viteve të kaluara, UBT edhe sivjet ka përfaqësuar Kosovën në garën më të madhe ndërkombëtare në fushën e robotikës, FIRST Global Challenge, që për shkak të situatës aktuale me COVID-19 po mbahet në formën online.

Kosovën u përfaqësua, Elta Bajrami, Vlera Saraçi, Riona Krosa, Alba Ratkoceri dhe Mërgita Alija, të cilët nën mentorimin e Elita Hajrizit, janë duke u përgatitur dhe punuar në laboratorët e UBT-së.

Ekipi përfaqësues i shtetit të Kosovës do ta sfidojë vetën në mesin e të rinjve nga rreth 170 shtete të ndryshme të botës të cilët këtë vit, ndryshe nga ga-



rat e organizuara më herët po përdorin njohuritë kreative dhe teknologjinë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në ko-

munitetin ku jetojnë ata. Të rinjtë nga Kosova në fazën e parë të kësaj gare kanë ideuar dhe dizajnuar projektin për qasjen e barnave në mënyrën online,

projekt ky shumë interesant dhe i nevojshëm për gjithë shoqërinë. Projekti “E-Pharm” është barnatore digjitale, që përbën lehtësim në blerjen dhe dërgesën e barnave online për të gjithë personat e specifikisht për të moshuarit dhe personat në viset rurale.

Sipas ekipit përfaqësues nga Kosova, “E-Pharm” përbëhet nga të gjitha llojet e barnave, vitaminave, suplementeve, të cilat lehtësisht mund të gjenden në barnatoren digjitale përmes faqes kryesore (home) të “E-Pharm”.

E veçanta e “E-pharm” është se dërgesa e çdo barne bëhet përmes postës apo droneve (për viset jo të përshtatshme për qasje), përderisa secila dërgesë

është e shoqëruar me një përshkrim, ku përpos komponentëve të tyre gjenden dhe këshilla pasesue.

UBT e përfaqëson Kosovën në këtë garë tash e disa vite, ku përmes ekipit të përbërë nga studentët e UBT-së dhe nxënës të tjerë, bëhet përgatitja në mënyrë profesionale në laboratorët inovativ të mekatronikës.

Kujtojmë se nga kjo garë UBT është vlerësuar nga organizatorët dhe ka marrë medalje të artë për kontributin dhe mbështetjen që po jep institucioni për FIRST Global Challenge dhe për zhvillimin e STEM në botë (Science, Technology, Engineering and Mathematics).

UBT virtualisht mbajti ceremoninë e gradimit të studentëve

Në formë ceremoniale, gjenerata e tetëmbëdhjetë e të diplomuarve të UBT-së, i dhanë kuptim rrugëtimin të tyre akademik, që i përcolli me një përvojë unike dhe të papërsëritshme.

Kosova tashmë, ka mbi 1 mijë të diplomuar të rinj në UBT, profesionistë në secilën fushë, që do t'i shërbejnë vendit me njohuritë dhe aftësitë e përfutuara përgjatë një rrugëtimit të gjatë dhe me sfida, rrugëtim i cili rezultoi që të ishte shumë i suksesshëm.

Në këtë ceremoni të mbajtur në formën online, rektori i UBT-

së, prof.dr Edmond Hajrizi, iu drejtua studentëve i lumtur e krenar që kjo gjeneratë do të sjellë profesionistë të përkushtuar e të përgatitur, në saje të punës disavjeçare në UBT.

“Kjo ceremoni është si rezultat i një përkushtimi disavjeçar, për të studiuar, dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërin prej profesioneve të zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për ju dhe shoqërinë tuaj. Nevoja për një lider profesional është kërkesë e

përditshme kudo në botë, e po ashtu edhe këtu në Kosovë, ndaj edhe ne si UBT po mundohemi që t’iu ofrojmë juve të gjitha arrijet e fundit në shkencën e menaxhimit, biznesit, ekonomisë, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, programim, dizajn, drejtësi, arkitekturë, marrëdhëniet ndërkombëtare e diplomaci”, ka thënë rektori Hajrizi.

Një nga studentet më të dalluara, Adonisa Musliu në emër të studentëve ka ndarë përvojat e tyre dhe sukseset që ata korren përgjatë studimeve në UBT, duke falënderuar rektorin Hajrizi, profesorët, si dhe të gjithë stafin e UBT-së për kontributin, punën dhe angazhimin e secil-

it prej tyre për këto vite të paharrueshme studimi për ta.

“Sot jemi këtu të gjithë së bashku, studentë e profesorë, në një moment festiv, për të kurorëzuar rrugëtimin tonë akademik, një rrugëtim të bukur trevjeçar, me shumë punë e angazhim, me ditë të lodhshme e netë pa gjumë, por me shumë rezultate që para nesh hapin horizonte të reja. Në emrin tim dhe të studentëve të tjerë, falënderojmë UBT-në për gjithçka që ofroi për ne që ta finalizojmë me sukses këtë etapë të rëndësishme të jetës sonë”, ka thënë studentja Adonisa Musliu. Për argëtimin dhe atmosferën e studentëve në këtë ceremoni virtuale të gradimit, u përkujdesën studentët e Fakultetit

Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT, Elit Hoti me këngën “Everything I wanted”, si dhe Ertiola Ademi me këngën “Hero”, të përcjellur në piano nga profesori Artan Hasani.

Duke vlerësuar situatën epidemiologjike në vendin tonë me pandeminë Covid-19, si dhe rëndësinë e këtij eventi për studentët, UBT organizoi këtë ceremoni në formën online, me studentët të cilët nga distanca edhe njëherë ripërsëritën premtimin se do i shërbejnë vendit dhe shkencës, si dhe do të kontribuojnë me përgjegjësi të lartë në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë.

Majlinda Kelmendi dhe Driton Kuka i bashkohen UBT-së



Numrit të madh të profesionistëve dhe ekspertëve të cilët janë pjesë e UBT-së i janë shtuar edhe kampionia botërore dhe olimpike në xhudo, Majlinda Kelmendi, dhe trajneri i mirënjohur

me një bagazh të jashtëzakonshëm në sportin e xhudos, Driton Kuka. Tani, studentët e Fakultetit Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes në UBT, do të kenë mundësi që të marrin njohuri dhe praktika nga

njerëzit më të suksesshëm që ka Kosova, të cilët ishin dhe mbeten ambasadorët më të mirë që ka vendi ynë.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, iu ka uruar mirëseardhje

në shtëpinë më të madhe akademike në vend, dy personaliteteve që Kosovës i kanë sjellë shumë suksese përmes sportit të xhudos.

“Pjesë e UBT-së po bëhen edhe dy kampionë të cilët kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë në përfaqësimin dinjitoz të vendit tonë në arenën ndërkombëtare. Dritoni dhe Majlinda, përvojën e tyre do ta ndajnë me studentët dhe gjerat e reja në UBT, dhe ardhja e tyre do të forcojë edhe më shumë nivelin e cilësisë dhe krijimit të kuadrove me mentalitet fitues në UBT”, ka thënë rektori Hajrizi.

Trajneri i mirënjohur, që së fundmi është bërë pjesë e UBT-së, Driton Kuka, ka thënë se duke bashkëpunuar me UBT-në, ai do të ndajë njohuritë dhe përvojat

e tij me studentët e Fakultetit Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes në UBT.

“Në Fakultetin Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes në UBT, të angazhuar do të jemi edhe unë dhe Majlinda. Drejtimet do të jenë atraktive për të gjithë, dhe një drejtim do të jetë edhe për Coaching, aty do të jem unë si ligjërues dhe do të shpërndaj njohuri për botën e trajnerëve të ardhshëm”, ka thënë Kuka.

Fakulteti Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes në UBT, studentëve përpos që është duke u ofruar një kurrikulë moderne, të bazuar kryesisht në lëndë të cilat janë praktike, tani po sjell profesionistët më të mirë që ka vendi, e të cilët do të jenë në secilin hap të tyre në rrugëtimin akademik.

QKRMT dhe UBT mbajtën konferencën mbi traumën ndërbrezore “Transgenerational trauma: Evidence-based research on transgenerational trauma, the psychological and social impact of the trauma”

Në bibliotekën inovative të Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, me organizim të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Fakultetit të Psikologjisë në UBT, është mbajtur konferenca: “Transgenerational trauma: Evidence-based research on transgenerational trauma, the psychological and social impact of the trauma”.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, drejtoresha ekzekutive e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Feride Rushiti, psikanalistja, Wiola Rebecka, hulumtuesja në Institutin Danez kundër Torturës “DIGNITY”, Sharlen Wang, profesoresha e asociuar në psikologjinë sociale dhe të traumave, njëherit bashkë-udhëheqëse e grupit të kërkimit të traumave, izolimit social dhe shëndetit mendor në Nottingham Trent University, Blerina Kellezi, si dhe pjesëmarrës të tjerë.

Në këtë konferencë është paraqitur një hulumtim i bazuar në fakte mbi traumën ndërbrezore, ndikimin psikologjik dhe social të traumës, ku profesorë të njohur dhe profesionistë të psikologjisë diskutuan dhe shkëmbyen mendimet e tyre rreth kësaj çështje dhe këtij hulumtimi.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka uruar Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetu-



arve të Torturës për 22-vjetorin e themelimit, për punën, si dhe për angazhimin përgjatë gjithë këtyre viteve në rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës.

“Dua të uroj fillimisht Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës për 22-vjetorin e themelimit dhe t'i përgëzojë për punën e mirë dhe të madhe që e kanë bërë përgjatë viteve, duke u marrë me trajtimin e njëres prej plagëve më të dhimbshme të luftës, që të dihet që të mbijetuarit e torturës, veçanërisht të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, përmes shërbimeve të ndryshme rehabilituese, mjekësore, psikosociale, si dhe sigurime të qasjes në drejtësi”, ka thënë fillimisht rektori Hajrizi.

Ai ka shtuar se kjo qendër është pikë referente për raste të tilla dhe që sipas tij ka krijuar një ndërlidhje të dijes që në të ardh-

men mund të përdoret edhe për raste studimore.

“Emri i qendrës dhe i zonjës Feride ka qenë pika kryesore referente, dhe mendoj se kjo ka krijuar një ndërlidhje të dijes, një lloj knowledge generation që mund ta përdorim edhe për studime, edhe për raste të së ardhmes që mund t'i njoftojmë dhe prezantojmë për rrethana tjera, qoftë për edukim, qoftë për hulumtim, qoftë për trajnim klinik, në mënyrë që të kemi sa më pak gjëra të tilla në të ardhmen”, ka thënë rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Drejtoresha dhe themeluesja e Qendrës për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Feride Rushiti është ka thënë sot janë në një situatë të atillë me shumë informacione, me raste që po vazhdojnë të trajtohen, duke u përkrahur vazhdimisht e më shumë nga të gjitha kategoritë e

njerëzve.

“Është hera e parë që 22-vjetorin e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës po e shënojmë në bashkëpunim me një kolegji tani që është i njohur brenda dhe jashtë vendit, pra me UBT-në. Qendra ndër vite ka grumbulluar informacione, ka prodhuar njohuri profesionale, dhe këto njohuri profesionale, po ashtu do të jenë pjesë edhe e akademisë dhe pjesë e këtij institucioni dhe studentëve të cilët marrin dije pranë këtij institucioni të arsimit të lartë”, ka thënë Rushiti.

Rreth asaj se pse i bashkoi sot UBT-në dhe Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, ajo ka shtuar se trauma është vërtetuar se bartet ndërbreza, dhe për këtë duhet hulumtim më të gjerë dhe trajtim për këtë kategori.

“Studime të ndryshme psikolog-

jike e kanë vërtetuar se trauma bartet ndër breza, mirëpo studime shkencore epigjenetike janë të rralla, pasi që edhe ato shumë vonë janë realizuar, që pothuajse janë në pesëvjeçarim e fundit, dhe fatkeqësisht nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë studim ku si grup të interesit i ka vetëm viktimat e dhunës seksuale të konfliktit apo të luftës”, ka potencuar, drejtoresha e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Feride Rushiti.

Në fund të konferencës, u mbajt edhe një panel, ku pjesëmarrësit: psikanalistja, Wiola Rebecka, profesoresha e psikologjisë në UBT, Violeta Zefi dhe psikologjia në QKRMT, Selvi Izeti-Krasniqi kanë diskutuar me të pranishmit e tjerë për njohuritë praktike dhe të bazuara në dëshmi të ekspertëve brenda fushës së traumave, traumave të gjeneratave, psikologjisë sociale, si dhe shërimit të traumave.

Psikanalistja, Wiola Rebecka, ndër të tjera, për të pranishmit dhe pjesëmarrësit e tjerë, shtjelloi detaje të librit të saj të titulluar: “Rape: A History of Shame, Diary of Survivors”, që ndërlidhë me aspektin psikosocial të të mbijetuarve të torturës, teksa më gjerësisht ka diskutuar rreth pasojave të traumave në kontekstin më të gjerë socio-ekonomik, si dhe për mënyrën e shërimit të tyre, në mënyrë që kjo gjë të mos kalojë ndër-breza.

Studentët e Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT kuruan ekspozitën “Dead Dogs Walking”

Studentët e Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT, në kuadër të praktikës, së bashku me profesorin Gazmend Ejupi, kanë demonstruar mënyrën e organizimit të një ekspozite në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

19 studentët pjesëmarrës fillimisht kanë punuar mbi realizimin e konceptit në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, hulumtimin për ekspozitën, e më pastaj kanë vazhduar me punëtorinë rreth rrjeteve sociale për promovimin e saj, si dhe me menaxhimin e përgjegjësive të studentëve.

Ndër të tjera, studentët e Fakultetit Art dhe Media Digjitale, së bashku me profesorin Gazmend Ejupi, kanë zhvilluar punëtori të



tjera rreth menaxhimit të sponsorëve për ekspozitën, rreth rëndësisë së mediave dhe komunitetit, komunikimit me publikun, si dhe në fund për mënyrën e instalimit të punimeve në bashkëpunim me profesionistë të fushës.

Fakulteti Art dhe Media Digjitale në UBT ofron një prej programeve më moderne, shembull të një platforme profesionale për zhvillimin e mëtejshëm për inkuadrimit në fushat profesionale për punësim në industrinë kreative.

Në UBT u mbajt trajnimi: “Raportimi mbi standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë”

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe UN Women Kosovo me temë: “Raportimi mbi standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë”.

Në këtë trajnim u prezantuan konceptet kryesore të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë nga redaktorja në organizatën e pavarur mediatiqe, Kosovo 2.0, Dafina Halili.

Ky trajnim kishte për fokus aftësimin e gazetarëve për të raportuar mbi standardet e sigurisë dhe të shëndetit në punë në një mënyrë të paanshme.

Zgjerimi i njohurive të studentëve se si mund të trajtohen pabarazitë gjinore përmes raportimit mbi standardet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, ishte një pikë tjetër e këtij trajnimi për të cilin studentët shfaqën interesim duke qenë mjaft aktiv me pyetjet e tyre.

Raportimi mbi standardet e sigurisë dhe të shëndetit në punë është i rëndësishëm, pasi mund të ndikoj në rritjen e ndërgjegjësimin tek qytetarët se cilat janë shkeljet në vend të punës e po ashtu edhe në rritjen e llogaridhënies brenda institucioneve përkatëse në nivelin lokal dhe qendror.

Promovohet libri “Seksualiteti i Njeriut”, i profesorit të UBT-së, Hajrullah Fejza

Në prani të mysafirëve, studentëve dhe profesorëve, në ambientet e UBT-së, në Prishtinë, është promovuar libri “Seksualiteti i Njeriut”, i profesorit të UBT-së, Hajrullah Fejza.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se botimi i këtij libri ishte shumë i nevojshëm për këtë kohë pasi që shpesh herë mënyrat jo të sakta të informimit përmes internetit dhe kanaleve tjera të internetit nuk ofrojnë njohuri të duhura.

“Kohëve të fundit, edukimi seksual është bërë një temë e cila po vërehet se në shoqërinë tonë ka nevojë të trajtohet, dhe konsiderojmë që është pikërisht akademia dhe aspekti profesional i trajtimit të saj, ai i cili prinë drejt kësaj teme në shqyrtimin dhe dhënien e përgjigjeve drejt pikëpyetjeve konkrete, në aspektin e edukimit dhe të ngritjes së debatit e trajtimit për informimin dhe edukimin mbi shëndetin seksual”, tha rektori Hajrizi.

Dekan i Shkencave Mjekësore në UBT, prof.dr Fitim Alidema, njëherësh edhe recenzent i librit, ka vlerësuar tejet lartë këtë libër



të autorit Hajrullah Fejza duke thënë se edukimi mbi seksualitetin duhet të fillojë nga familja, nga prindërit, në shkollë nga mësimdhënësit të përgatitur për të trajtuar tema të tilla.

“Ky libër dhe disa kapituj me rendësi të këtij libri do të ju shërbej studenteve tanë të Shkencave Mjekësore të edukohen më mirë rreth jetës seksuale po ashtu të marrin më shumë informacione rreth jetës seksuale të shëndetshme, Këto informacione t'i

shpërndajnë edhe te moshatarët e tyre”, tha prof.dr Fitim Alidema. Specialisti i sëmundjeve infektive, njëherit edhe recenzent i librit, prof.dr Ilir Tolaj, ka vlerësuar punën e profesorit Fejza, duke thënë se ai i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edukimit seksual për nga aspekti shkencorë.

“Seksualiteti është një pjesë integrale e të qenit njeri dhe një diskutim i hapur i çështjeve të seksualitetit është i rëndësishëm

për promovimin e shëndetit dhe përgjegjësisë seksuale. Libri i doktorit të mjekësisë dhe shkencave, Hajrullah Fejza, i cili është i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe, i adreson shumë aspekte seksuale, dhe zotëri Fejza seksualitetit të njeriut dhe shëndetin seksual i referohet përmes shumë faktorëve që ndikojnë në funksionimin seksual dhe riprodhimin”, ka thënë Tolaj.

Profesoresha e Psikologjisë në UBT, Violetë Zefi, nënvizoi

rëndësinë e edukimit seksual duke theksuar se një lëndë e tillë do të ishte shumë e mirëseardhur në shkolla.

“Kjo e ka vënë në pah rëndësinë që e ka edukimi seksual dhe rrjedhimisht domosdoshmërisht një lëndë e tillë të fillohet të ligjërohet, personalisht do të preferoja ta quaja jo edukim seksual por edukim shëndetësorë”, ka thënë ajo.

Autori i librit, Hajrullah Fejza ka treguar se ky libër ju dedikohet atyre që duan të mësojnë për seksualitetin e që vijnë nga fusha e shkencave mjekësore, psikologjike e sociale e pastaj edhe gjithë atyre njerëzve kureshtar që duan të informohen për seksualitetin, duke filluar nga parahistoria e deri në ditët e sotme.

Tutje, Hajrullahu tha se shpreson shumë që ky libër do t’iu shërbej për të mësuar ato gjëra për të cilat lexuesit kanë nevojë më shumë, duke qenë i sigurt se të gjitha informatat e dhëna kanë mbështetje në evidencë të bazuar shkencore.

Promovohet libri “Bazat e Vlerësimit të Riskut”, në bashkautorësi të profesorëve të UBT-së, Hazir Çadraku dhe Muhamet Ahmeti

Në prani të profesorëve dhe studentëve, si dhe pjesëmarrësve të tjerë, në ambientet e UBT-së, në Prishtinë, është bërë promovimi i librit: “Bazat e Vlerësimit të Riskut”, në bashkautorësi të profesorëve të UBT-së, dr.sc. Hazir Çadraku dhe prof.dr. Muhamet Ahmeti. Në këtë promovim pjesëmarrës ishte edhe rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ku me këtë rast ka përgëzuar autorët Çadraku dhe Ahmeti, për një punë dhe angazhim në përgjegjësinë intelektuale për shpërndarjen e dijes, përderisa ka vlerësuar shumë librin për të cilin kanë punuar të dy autorët.

“Përgëzoj të dy autorët, profesor Çadrakun dhe profesor Ahmetin për punën dhe angazhimin e tyre për realizimin e këtij libri. Menaxhimi i riskut është një fushë dhe aspekt i rëndësishëm, që ndërlihet me shumë fusha të tjera e që kanë lidhje me shëndetin e njeriut, ndaj edhe është shumë e rëndësishme të kemi



një kalkulim më të mirë të riskut nga aspekte të ndryshme”, ka thënë rektori Hajrizi.

Recensenti i librit, prof.dr. Agim Shaqiri, konsultenti profesional, mr.sc. Fatmir Saraçini, si dhe redaktori gjuhësor, prof.ass.dr. Ferid Selimi, kanë vlerësuar librin:

“Bazat e Vlerësimit të Riskut”, duke falënderuar autorët për një udhërrëfyes siç e quajten ata, të studentëve dhe akterëve të tjerë që ndërlihen me sigurinë e shëndetit në punë.

Ata njëzëri kanë thënë se ky libër do të kontribuojë shumë jo

vetëm në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, por edhe në programet arsimore për arsimin e lartë.

Ndërkaq, dy autorët e librit, dr.sc. Hazir Çadraku dhe prof.dr. Muhamet Ahmeti, kanë falënderuar të gjithë kontribuuesit e librit, në veçanti, rektorin e UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi për mbështetjen e pakursyeshme deri në realizimin e këtij libri.

“Fillimisht falënderoj rektorin e UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, për mbështetjen e tij të deritanishme për realizimin e këtij libri dhe të gjithë kontribuuesit e tjerë që kanë ndihmuar që ky libër të bëhet realitet. Të gjithë folësit paraparak shtjelluan se çka në të vërtetë është trajtuar dhe përmban libri “Bazat e Vlerësimit të Riskut”, dhe neve na mbetet që këtë libër ta shpërndajmë tek studentët, profesionistët, si dhe akterët e tjerë që merren me lëmin e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, ka thënë bashkautor i

librit, dr.sc. Hazir Çadraku.

“Ky libër, ose thënë ndryshe ky udhërrëfyes do të ju shërbej jo vetëm studentëve e profesorëve, por të gjithë atyre që merren me sektorin e ndërtimit, pasi që e dimë se ky sektor është një prej profesioneve më të rrezikshme dhe rrezikshmëria është shumë e lartë, ndaj edhe menaxhimi i riskut është një prej aspekteve të rëndësishme në këtë fushë dhe fusha të tjera”, ka thënë bashkautor i librit, prof.dr. Muhamet Ahmeti.

Ky libër vjen si kërkesë e zhvillimeve të përgjithshme në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe kërkesë e programeve arsimore për arsimin e lartë. Libri “Bazat e Vlerësimit të Riskut”, është rezultat i punës disavjeçare të autorëve, i gërshetuar me eksperiencën dhe përvoja analoge në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe shëndetit në vende dhe mjedise pune.

Promovohet libri “Udhëzues Pune në ArcGIS ArcMap, Hapa Fillestarë Pjesa Parë”, i profesorit të UBT-së, Hazir Çadraku



Në prani të profesorëve dhe studentëve, në ambientet e UBT-së, në Prishtinë, është promovuar libri: “Udhëzues Pune në ArcGIS ArcMap, /Hapa Fillestar/ Pjesa e Parë”, i profesorit të UBT-së, Hazir Çadraku.

Në këtë promovim ishte i pranishëm edhe rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi i cili tha se ky libër ishte i nevojshëm dhe se tema për të cilën profesori Çadraku ka hulumtuar dhe shkruar i kontribuon shumë shkencës.

“Vlerësoj punën dhe kontributin që profesori ynë, Hazir Çadraku, si dhe gatishmërinë e tij për t’i shtyer gjërat përpara, duke konkretizuar vizionin për shkencën, zhvillimin dhe edukimin”, tha rektori Hajrizi.

Ndërkaq, autori i librit është shprehur i lumtur që ky hulumtim ka marrë formën e vet, dhe që do iu shërbej si udhëzues studentëve dhe profesorëve, të cilët në një formë apo tjetër e përdorin këtë udhëzues.

Ky Udhëzues Pune në ArcGIS ArcMap (Hapa Fillestarë-Pjesa e Parë) vjen si kërkesë e zhvillimeve të përgjithshme në fusha të ndryshme sociale, shkencore dhe programeve arsimore të mbështetura në konceptin dhe metodologjinë për arsimin e lartë të sistemit të Bolonjës.

Certifikohen 200 pjesëmarrës në trajnimin për Artificial Intelligence



UBT në bashkëpunim me Microsoft ka mbajtur trajnimin për Inteligjencë Artificiale, trajnim ky që mbledhi rreth 200 pjesëmarrës të interesuar për të ardhmen e teknologjisë së fundit. Në këtë trajnim, i cili është mbajtur në formën online, pjesëmarrësit patën mundësi që të marrin njohuri dhe praktika nga ekspertët e Microsoft, nga ku mësuan rreth teknikave më efektive të Inteligjencës Artificiale, që do iu shërbejnë atyre në të

ardhmen për eksplorim, praktikim dhe implementim të këtyre metodave. Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit përfituan bazën e nevojshme me praktika efektive për të zgjidhur problemet e reja të botës reale, përmes Inteligjencës Artificiale. Pjesëmarrësit e trajnimit Artificial Intelligence janë certifikuar, trajnim ky i organizuar nga Departamenti për Produkte dhe Zhvillime Profesionale në UBT dhe Microsoft.

Mbahet koncerti për nder të Ditës së Evropës - UBT Band sjell hitet e artistëve më të njohur botërorë

Në ambientet e Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, është mbajtur koncert për nder të Ditës së Evropës, organizuar nga Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT dhe UBT Band.

Në këtë koncert pjesëmarrës ishte edhe rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili u shpreh i lumtur me organizimin e këtij koncerti dhe me bendin e UBT-së, që tashmë është bërë pjesë e pandashme e organizimeve të institucionit.

Ai vlerësoi faktin për çka është organizuar ky event, duke thënë se



ditët e tilla janë të rëndësishme, dhe se si kjo e Ditës së Evropës, na bënë që të jemi pjesë e saj dhe të tregojmë vlerat që posedojmë. Ndërkaq, prodekani i Fakultetit Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT, Korab Shaqiri, tha se nderimi i një dite si kjo është i rëndësishëm dhe se Kosova është pjesë e pandashme e Evropës, duke vlerësuar lartë punën dhe angazhimin e studentëve të këtij fakulteti në organizimin e një eventi si ky. Në këtë koncert performuan studentët të Fakultetit Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe

Menaxhment si dhe UBT Band, ku të pranishmit patën rastin që të dëgjojnë hite të ndryshme të artistëve botërorë.

Me këtë koncert, studentët e Fakultetit Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT bashkë me UBT Band, dëshmuar edhe njëherë se kanë cilësi dhe janë në nivele të larta në këtë fushë, duke qenë artistë që premtojnë shumë në të ardhmen për përfaqësimin sa më të denjë të Kosovës në evenimentet dhe festivalet më të njohura të botës.

Me koncert madhështor, Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT përmbyllë semestrin veror të vitit akademik 2020/21

Sukseset e tyre përgjatë semestrit veror të vitit akademik 2020/21, Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT i kurorëzoi me një koncert madhështor.

Nën tingujt e instrumenteve që morën vëmendjen e të pranishmëve e që dirigjoheshin nga studentët dhe bendi i UBT-së, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, u krijua një atmosferë e jashtëzakonshme e cila u përcoll me hite të artistëve më të njohur të muzikës moderne, si dhe me këngë origjinale të kompozuar nga vet studentët.

I pranishëm në këtë koncert ishte edhe rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi i cili falënderoi studentët dhe stafin e Fakultetit Muzikë Moderne, Produksion

Digjital dhe Menaxhment, për organizimin e këtij koncerti, duke thënë se ky event është një vlerë e shtuar për UBT-në.

“Ky koncert i organizuar nga Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT, bashkë me studentët e këtij programi, dëshmon punën e palodhshme dhe angazhimin e tyre përgjatë gjithë vitit akademik. Kompozimet e reja që studentët personalisht i kanë punuar janë një vlerë e shtuar për artin dhe muzikën kosovare, dhe kjo me të vërtetë është një ndjenjë e mirë për të gjithë ne”, ka thënë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

“N’menën tem”, “Delja Rude”, “Too Late”, “Kalorësit e asfaltit”, si dhe “Variacione mbi temën

Lulebore të Simon Gjonit”, ishin vetëm disa prej kompozimeve të cilat u prezantuan në koncertin e mbajtur në ambient të hapur në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Ky organizim, tashmë i shndërruar në tradicional pas përfundimit të suksesshëm të semestrit veror nga Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT, edhe këtë herë nxorri fytyra të reja të studentëve të cilët performuan në mënyrë fantastike, duke dhënë një shenjë se në të ardhmen do të ketë një garë të fortë mes talentëve të muzikës në Kosovë për përfaqësimin e vendit në festivalet më të mëdha të muzikës në arenën ndërkombëtare.

Studentët e Dizajnit të Integruar kanë dizajnuar veshje për shoqatën e personave me Down Syndrome



Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Dizajn i Integruar në Ferizaj bashkë me profesorët e këtij fakulteti kanë realizuar veshje për shoqatën e personave me Down Syndrome. Studentët me këtë rast shpalosën kreativitetin dhe punën e tyre

përgjatë studimeve në UBT, ku punimet kreative dhe unike ia dhuruan kësaj shoqate. Studentët e UBT-së tash e disa vite janë duke organizuar aktivitete të shumta bamirëse, nga të cilat po përfitojnë personat me aftësi të veçanta në shoqërinë tonë.

Studentët e Fakultetit të Dizajnit të Integruar bëhen pjesë e kampanjës “Fustani ty, sa mirë të rri”

Studentët e Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT bashkë me profesorët e këtij fakulteti kanë realizuar kreacione unike të fustaneve dhe veshjeve për nënat dhe vajzat.

Ky aktivitet u bë me rastin e festës së 8 marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, një dedikim për të gjitha gratë, nënat dhe vajzat, në kuadër të kampanjës “Fustani

ty, sa mirë të rri”, organizuar nga organizata “Nëna dhe Fëmijë të Lumtur”.

Përmes kësaj pune kreative, studentët shpalosën kreativitetin dhe punën e tyre, përgjatë studimeve në UBT, njëherit treguan mbështetjen e fuqishme për të gjitha gratë, nënat dhe vajzat në shoqëri.

Studentët e Artit dhe Mediave Digjitale vizituan kompaninë “Pixel Production Advertising Agency”



Studentët e vitit të parë të Fakultetit Art dhe Media Digjitale, realizuan vizitë studimore në kompaninë “Pixel Production Advertising Agency”, të cilët u pritën nga drejtori i kompanisë Gëzim Avdiu.

Në kuadër të kësaj vizite ata u njoftuan nga afër me përmbajtjen

e mediave sociale, me pajisjet profesionale si dhe procesin e redaktimit të materialeve.

Ndërkaq, drejtori i kompanisë Pixel Production Advertising Agency, shprehu gatishmërinë e plotë për t’i përfshirë studentët e këtij drejtimi në praktikë profesionale.

Me koncert madhështor, Fakulteti Muzikë Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment në UBT përmbyllë semestrin veror të vitit akademik 2020/21

Studentët e Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT, kanë zhvilluar një aktivitet në Liqenin e Badovcit, duke bërë mbledhjen dhe grumbullimin e materialeve fizike dhe atyre digjitale për krijimin e instalacioneve dhe veprave të tjera skulpturore.

Profesori në Fakultetin Art dhe Media Digjitale në UBT, Burim Berisha, ka vlerësuar se ky aktivitet është një praktikë e mirë për të fituar përvoja të reja, për të grumbulluar materiale që përdoren edhe si instalacion por edhe në skulptura të ndryshme, teksa ka thënë se ideja e tërë këtij aktiviteti ka qenë që të zhvillohet mendësia kritike tek artistët e rinj. Studentët treguan se përveç ini-



ciativës që kanë marrë si grup për të bërë mbledhjen e mbetjeve në natyrë, ata kanë dashur edhe të kontribuojnë në ruajtjen e hapësirave publike. Profesori Berisha tha se ky nuk do të jetë aktiviteti i vetëm i tyre,

pasi që do të ketë edhe të tjera organizime në kuadër të Fakultetit Art dhe Media Digjitale në UBT, në mënyrë që të arrihet një komunikim artistik me publikun në hapësira të ndryshme.

UBT pjesë e festivalit ndërkombëtar të artit: “Nën brazatë të kohës”

Peja do të jetë nikoqir i edicionit të tretë të festivalit ndërkombëtar të artit: “Nën brazatë të kohës”, i cili këtë edicion për fokus ka tri pika kryesore: Elfriede Jelinek, Christoph Schlingensiefel dhe Rosa Luxemburg, të cilat nën titullin: “Nanë! Pse nuk ma dhe një trup tjetër?” do të prezantohen më 10 korrik në stadiumin e futbollit në Pejë.

UBT si institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, edhe këtë vit do të jetë pjesë e këtij festivali, kështu duke vënë në dispozicion rrjetin universitar në Ballkan, duke i ftuar dhjetëra studentë e profesorë ndërkombëtarë në këtë festival. Në këtë festival në të cilin do të marrin pjesë shumë universitete partnere të UBT-së nga

Evropa Qendrore dhe Ballkani, do të marrin pjesë edhe shumë performues, muzikantë, artistë, të arteve pamore, arkitektë, regjisorë filmi dhe shkencëtarë. Festivali: “Nën brazatë të kohës”, do të mbahet nga data 5 korrik deri më 11 korrik 2021, në stadiumin e futbollit “Shahin Haxhiislami”, në Pejë.

Një delegacion i “Universal Peace Federation” vizitoi Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

Një delegacion i “Universal Peace Federation” ka vizituar Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, nga ku janë pritur nga drejtori për Çështje Akademike në UBT, prof.dr. Muhamet Ahmeti, dekani i Fakultetit Juridik në UBT, prof.dr. Visar Hoxha, dekani i Fakultetit Shkenca Politike në UBT, prof.dr. Dritëro Arifi, si dhe prodekanja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Hajdi Xhixha.

Delegacioni i përbërë nga kryetari i “Universal Peace Federation”, dr. Katsumi Otsuka, presidenti i “Universal Peace Federation”, dr. Jacques Mari-



on dhe Mark Brann, sekretarja e përgjithshme e “Universal Peace Federation” për Kosovë,

Ejona Icka, si dhe sekretari i përgjithshëm i “Universal Peace Federation” për Shqipëri, Gani


Rroshi, u njoftuan me punën, angazhimin dhe të arriturat e UBT-së ndër vite, në shërbim të

zhvillimit të arsimit, shkencës dhe inovacionit në Kosovë dhe rajon.

Ndër të tjera, ata u njoftuan nga menaxhmenti i UBT-së për funksionimin e institucionit më të madh akademik në vend, infrastrukturën moderne të institucionit, si dhe për projektet e realizuara nga studentët e UBT-së.

Nga ky takim, të dy palët lanë të hapur mundësinë e bashkëpunimit mbi studime të paqes, me fokus shkëmbimin e studentëve dhe stafit, si dhe hulumtime dhe kërkime të përbashkëta në fushën e paqes.

Kopshtit Botanik të UBT-së i shtohet pemishtja demonstruese



Një pemishte demonstruese i është shtuar Kopshtit Botanik të UBT-së, një kopsht i cili ka bërë një ndërlidhje unike mes Fakultetit Inxhinieri e Agrikuturës dhe Mjedisit me një ekosistem të madh të dijes, të bazuar në teori dhe praktikë.

Kopshti Botanik i UBT-së, që është i pari i këtij lloji në vendin tonë, me mbi 560 bimë të ndryshme të cilat reprezentojnë bimët të cilat rriten në Kosovë dhe jashtë vendit, tashmë në brendi të sistemit të saj do të ketë edhe një pemishte demon-

struese për qëllime hulumtimi dhe mësimi.

Profesori i UBT-së, Maxhun Shehaj ka thënë se përmes këtij aktiviteti studentët e Fakultetit Inxhinieri e Agrikuturës dhe Mjedisit në UBT, po përvetësojnë disa nga teknikat e kultivimit të mollës, teknika për të cilat ata i kanë mësuar dhe zhvilluar nga ana teorike në laboratorët e UBT-së.

“Ne po ngritim një pemishte demonstruese në Kopshtin Botanik të UBT-së, e cila stu-

dentëve do t'i kontribuojë shumë në mësimin praktik të kultivimit të kulturës së mollës. Praktikisht do të mësojmë për përzgjedhjen e kultivarëve, për tipin e nënshartës, për teknikat e mbështetjes, teknikat e krasisjes, do të mësojmë teknologji të mbrojtjes nga sëmundja dhe dëmtues, gjithmonë duke pasur parasysh një qasje miqësore ndaj ambientit, duke shtuar këtu edhe demonstrimin e teknikave të krasisjes”, ka thënë profesori i UBT-së, Maxhun Shehaj.

Kjo pemishte gjithashtu do të jetë edhe në shërbim të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, kështu duke krijuar një gërshetim të pjesës praktike me Fakultetin Inxhinieri e Agrikuturës dhe Mjedisit, si një ndërmarrje e përbashkët me qëllime studimi e hulumtimi.

Kopshti Botanik i UBT-së, me sistemin e pemishtes demonstruese është duke rritur vlerat e zhvillimit të mëtejshëm të këtij ekosistemi me qëllim studimi e hulumtim përbrenda Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së.

Studentët e UBT-së realizojnë vizitë studimore në Turqi



Studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë, si dhe Dizajn i Integruar në UBT, së bashku me drejtorin për Çështje Akademike në UBT, prof.dr. Muhamet Ahmeti, si dhe prof.dr. Ajhan Bajmaku kanë realizuar një vizitë studimore në Turqi, me qëllim rast studentët patën mundësi të vizitojnë vende të ndryshme kulturore.

Studentët e fakulteteve përkatëse vizituan qytetin Edirne, ku nga afër panë objektin e projektuar nga Mimar Sinan, si dhe muzeun e shëndetit “Complex Of Bayezid II Health Museum”.

Tutje, studentët patën mundësi të vizitojnë Panairin Ndërkombëtar të Materialeve Ndërtimore, që është një nga më të mëdhenjtë dhe më të rëndësishmit në Evropë dhe rajon.

Studentët përgjatë kësaj vizite u njohën me kulturën turke dhe panë nga afër shumë objekte e muze të ndërtuara para qindra viteve, duke përfshirë galeritë më të njohura të Turqisë, panairë ndërkombëtare, objekte të famshme, vepra të dizajnit dhe arkitekturës, si dhe patën mundësi të shëtisin nëpër sheshet më të njohura të Stambollit.

Studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT bëjnë testimin e materialeve në Laboratorin e Materialeve Ndërtimore në UBT

Studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, kanë realizuar aplikimin e testeve të ndryshme të materialeve, në kuadër të lëndës së materialeve në arkitekturë.

Studentët patën mundësi të aplikojnë testimet në laboratorin e akredituar të materialeve në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, nga ku u praktikua aplikimi i pjesëve të rëndësishme studimore të materialeve, duke bërë që studentët të përforcojnë edhe

më shumë aspektin teorik dhe praktik, që në të nesërmen ata të kenë mundësi të garantimit të cilësisë së ndërtimeve të tyre.

Ndërkohë, studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, dega në Ferizaj, vizituan laboratorin për testimin e materialeve “Struktura”, në Ferizaj, ku aplikuan teste të ndryshme të materialeve, me ç'rast arritën të përvetësojnë në nivel të lartë materialet e ndryshme të aplikueshme në

arkitekturë, duke i dhënë theks vlerësimit të cilësisë së tyre.

Gjatë gjithë kohës studentët ishin nën monitorimin e teknikëve të laboratorit, inxh. Hajriz Mazreku, inxh. Leuart Osmani, si dhe profesorëve të lëndës, prof.dr Muhamet Ahmeti, prof. Driton Kryeziu, dhe prof. Visar Krelani.

Përgjatë gjithë kësaj kohe, studentët bashkë me profesorët kishin një interaktivitet të frytshëm, ku u diskutuan aspekte



të cilësisë së betonit dhe përcjelljes së tij, konstruksioneve

të çelikut, si dhe materialeve të tjera inovative.

Shpallen ekipet fituese të garës “Datathon Business Analysis”

Me rastin e Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, ka mbajtur një konferencë online ku është diskutuar rëndësia që ka siguria dhe shëndeti në punë.

Në këtë konferencë morën pjesë drejtori për Çështje Akademike, prof.dr. Muhamet Ahmeti, specialisti i sigurisë në punë, prof. Agim Shaqiri, profesoresha e juridikut, Jorida Xhafaj, profesoresha Violeta Lajçi-Makolli, profesoresha Afete Musliu, si dhe

prof.dr. Hazir Çadraku. Në këtë konferencë, rëndësi të veçantë i është dhënë sigurisë dhe shëndetit në punë në të gjithë sektorët, pa dallim veprimtarisë dhe aktivitetit të punës që bëhet, duke vlerësuar se duhet të bëhet një bashkëpunim dhe koordinim për t'i dhënë përgjigje problemeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohen punëdhënësit dhe të punësuarit sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë.

Nga kjo konferencë u nxorën përfundime nga të cilat u tha se duhet rishikuar avancimi i in-

frastrukturës ligjore, të bëhet monitorimi dhe implementimi i kuadrit ligjor nga inspektorati, të investohet më shumë në sigurinë dhe shëndetin në punë, të aplikohen masa nga ana e punëdhënësve për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe të zbatohen dispozitat ligjore për sigurinë në punë, si dhe të rritet bashkëpunimi institucional me institucionet e arsimit të lartë për gjetjen e zgjidhjeve teknike, teknologjike dhe shkencore.

UBT shënon Ditën Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Ka përfunduar gara dyditore “Datathon Business Analysis”, organizuar nga UBT dhe Raiffeisen Bank, ku morën pjesë shumë studentë të nivelit bachelor dhe master të universiteteve publike dhe private në Kosovë.

Ata garuan të ndarë në grupe, prej të cilëve tri grupe kanë zënë vendet e para.

Nga mbi 100 pjesëmarrës, ekipi “Data Sense” i përbërë nga studentja Fjolla Krasniqi dhe Ariana Tahiri, fituan vendin e parë dhe u shpërblyen me 1500 euro. Vendi i dytë i takoi ekipit “Data

Whispereres” i përbërë nga Arian Fazliu dhe Valdrin Smakiqi, të cilët u shpërblyen me 1000 euro. Ndërkaq, vendi i tretë i takoi grupit të përbërë nga Diellza Bytyqi, Lisan Bajrami dhe Lorik Reshiti të cilët u shpërblyen me 500 euro.

Kjo garë, sipas organizatorëve, kishte për qëllim që të gjithë të rinjtë e talentuar dhe që kanë aftësi në sektorin e teknologjisë dhe kanë zgjidhje kreative të problemeve në të dhënat dhe punën me big data, të shfaqin njohuritë dhe shkathësitë e tyre.

Interesim i madh i vajzave dhe grave për të studiuar në fushën e inxhinierisë

Inxhinieria është një fushë e cila ka shtrirje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, ku si qëllim kryesor ka plotësimin e nevojave të njerëzve, përmes aplikimit të metodave dhe teknikave të ndryshme, bazuar në shkencë, teknologji dhe inovacion, dhe si e tillë gëzon një rëndësi të veçantë. Në Ditën Ndërkombëtare të Grave në Inxhinieri, UBT vlerëson jashtëzakonisht shumë punën, angazhimin dhe përkushtimin e vajzave dhe grave në fushën e inxhinierisë. Për këtë, UBT ka të zhvilluar Fakultetin Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura, Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, si dhe Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit, nga ku një pjesë e konsiderueshme e studentëve, janë vajza dhe gra, dhe në të ardhmen ato do të jenë inxhinierë të suksesshëm, pas



studimeve profesionale në këtë institucion. Dita Ndërkombëtare e Grave në Inxhinieri e gjen UBT-në me mbi 4000 studente që kanë filluar ndërtimin profesional në fushën e inxhinierisë në këtë in-

stitucion, të cilat konkretisht po zhvillojnë aftësitë e tyre në infrastrukturë moderne dhe në laboratorët më të sofistikuar për inxhinieri.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof.

dr Edmond Hajrizi, theksoi se ky sektor është zgjedhje e mirë për të studiuar vajzat dhe gratë, në mënyrë që ato të jenë të barabarta karshi çdo profesioni dhe pune në jetë, teksa inkurajoi vajzat e reja

dhe gratë që të fillojnë studimet në fushat e inxhinierisë. "Hapësira që UBT u ofron grave për t'u zhvilluar profesionalisht në secilën fushë, por me theks të veçantë në fushën e inxhinierisë, është në tjetër nivel, dhe këtë e dëshmon edhe numri i studenteve të cilat studiojnë në fushat e inxhinierisë", tha rektori Hajrizi. Shumë vajza e gra të diplomuara tashmë janë punësuar në kompani të ndryshme botërore, janë angazhuar në pozita udhëheqëse dhe si staf akademik e administrativ, por edhe në shumë institucione shtetërore. UBT çdo vit u bashkohet institucioneve botërore që shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Grave në Inxhinieri me qëllim për të tërhequr vëmendjen e vajzave dhe grave në fushën e inxhinierisë.

UBT ndërton fabrikën e dytë Smart Factory

UBT si lider në fushën e edukimit në Kosovë, është duke vazhduar të jetë në hap me trendet e fundit të teknologjisë dhe inovacionit, nga ku në kuadër të këtij zhvillimi ka filluar ndërtimin e fabrikës së dytë Smart Factory, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së. Teknologji e avancuar, zgjidhje të shpejta e të besueshme dhe shërbim i shkëlqyeshëm janë ato që kërkohen, në një botë dinamike si kjo, e të cilat mund t'i ofrojnë Parku Shkencor e Inovativ i UBT-së, ku përmes ndërtimit të kësaj fabrike si pjesë e Smart City, po vendosen bazat e gjen-eratës së ardhshme të teknologjisë në Kosovë. Smart Factory

bën të mundur prodhimin në kohë reale, saktësinë e planifikimit, lidh lëndën e parë me makineri pa ndërprerje, bën ruajtjen e materialit, si dhe punon e prodhon në shumë ndërrime me efikasitet të lartë. Qytetet e mençura (Smart City) brenda të cilave përfshihen edhe fabrikat e mençura janë e ardhmja dhe kjo që po ndërton e zhvillon UBT është lidhja më e mirë dhe më e qëndrueshme e të ardhmes teknologjike me të ardhmen prosperuese të Kosovës. Investimet e mençura si këto e bëjnë Kosovën pjesë globale të arritjeve teknologjike dhe inovative.

Në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, bëhet thirrje për mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit

Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura në UBT, për nder të 5 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, ka mbajtur një forum online, ku është diskutuar për mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, si dhe për vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore. Pjesëmarrës në këtë forum ishin profesorë, përfaqësues nga institucione të nivelit qendrorë dhe lokal, organizata jo-qeveritare, kompani private, studentë dhe pjesëmarrës të tjerë.



Në këtë forum, u diskutua rreth rëndësisë që ka mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, që duhet të jetë një nga prioritetet e para, teksa u përçua mesazh ndërgjegjësi-mi dhe veprimi për ruajtjen e mjedisit. Nga ky forum u konkludua se mjedisi duhet trajtuar

qysh nga niveli fillor, duhet bërë më shumë investime dhe projekte për mbrojtjen e mjedisit, me zbatim të ligjit dhe forcim të kapaciteteve inspektuese, si dhe bashkëpunim dhe koordinim në zhvillimin e projekteve për mbrojtjen e mjedisit.

UBT krijon Asociacionin e Studentëve të Diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi dhe Infrastruktura

Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura në UBT ka krijuar Asociacionin e Studentëve të Diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi dhe Infrastruktura. Ky asociacion përfshin alumnin e angazhuar si në institucione publike ashtu edhe

në ato private, duke hapur mundësi bashkëpunimi për sfida të reja, duke mos harruar studentët aktual dhe studentët e ardhshëm. Në këtë takim, përveç inicimit të asociacionit u diskutua edhe për çështje të tjera, siç janë: aspekti i organizimit



të studimeve, angazhimit për punën praktike të studentëve aktual në kompanitë që tashmë alumni është i kyçur, tutorimet për studentët, e çështje të tjera. Studentët u ndanë të kënaqur dhe të lumtur me hapësirën që UBT është duke iu dhënë atyre përmes Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura, për të dhënë idetë dhe kontributin e tyre për zhvillimin e mëtutjeshëm të programit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura.

Fakulteti Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT mbajti ligjëratë tematike me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë

Fakulteti Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ka mbajtur ligjëratë tematike online me temën: "Organizimi, fushëveprimtaria dhe aktivitetet e autoritetit për garantimin e sigurisë së ushqimit".

Kjo ligjëratë u drejtua nga zyrtari i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Festim Rexhepi dhe koordinatore së Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Lorikë Salihu, ku u diskutua për fushën e sigurisë së ushqimit në aspektin legjislativ, kontrolleve zyrtare, organizimit dhe fushëveprimtaria të autoritetit kompetent, si dhe për procedurën e marrjes së mostrave.

Studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, u njoftuan me parimet dhe kërkesat e Planit të Monitorimit



të Mbetjeve, si dhe për organizatat evropiane për sigurinë e ushqimit.

Në këtë ligjëratë, studentët dhe pjesëmarrësit e tjerë shtruan pyetje me interes për temën për të cilën u diskutua, teksa si studentët ashtu edhe nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë u ndanë të kënaqur me organizimin e kësaj ligjërate.

Studentët e UBT-së korrin sukses në futsall, organizim nga FSUNK

Studentët e UBT-së kanë dëshmuar këtë radhë se përveçse janë të suksesshëm në pjesën akademike ata janë të suksesshëm edhe në sport.

UBT u përfaqësua denjësisht nga studentët në Ligën e Futsallit të organizuar nga Federata e Sporteve Universitare e Kosovës (FSUNK), duke u renditur në pozitën e dytë në tabelë.

Studentët: Liridon Hyseni, Edmond Zahiti, Vështrim Mulaku, Kreshnik Hyseni, Vigan Xhamba-

zi, Jeton Gashi, Muhamed Havolli, Lorik Buja dhe Festim Mulaku, të udhëhequr nga profesori Masar Gjaka, treguan rezultate të larta në këtë garë, duke përfaqësuar UBT-në denjësisht nga një këndvështrim më ndryshe të përfaqësimit të UBT-së. Përgjegjësi i skuadrës, profesor Masar Gjaka, ka thënë se ndihet i lumtur me rezultatin e arritur dhe përfaqësimin e duhur të UBT-së. "Jam i kënaqur me arritjen e ekipit, pasi që kjo është hera e parë

që UBT merr pjesë në evente të tilla. Qëllimi i pjesëmarrjes në këtë garë ka qenë përfaqësimi dinjitoz i UBT-së, si dhe socializimi i studentëve të UBT-së me studentët e tjerë përmes sportit", ka thënë profesori Gjaka. Ekipi i UBT-së, mbylli garat në futsall në vendin e dytë me 22 pikë të grumbulluara me një golaverzhë prej 37 golave të shënuar dhe 9 të pësuar.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimi Hapësinor ka marrë pjesë në samitin e organizuar nga Asociacionit Evropian për Edukim Arkitekturale (EAAE)

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, si anëtar i Asociacionit Evropian për edukim Arkitekturale, ka marrë pjesë në samitin e organizuar nga ky asociacion. Kosova është përfaqësuar denjësisht nga UBT, gjegjësisht nga dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor prof.

dr.Lulzim Beqiri. Në kuadër të këtij samiti janë diskutuar tema të frytshme ku pjesë e rëndësishme e diskutimit ka qenë SDG (sustainable development goals) të përcaktuara nga kombet e bashkuara për periudhën 2020-2030. Samiti trajtoj po ashtu mundësinë e implementimit të

qëllimeve SDG dhe integrimin në procesin e edukimit arkitekturale në nivel global. Qëllimi i Asociacionit Evropian për Edukim Arkitekturale (EAAE) është të avancojë cilësinë e arsimit arkitektonik dhe gjithashtu të promovojë cilësinë e arkitekturës në Evropë.

Studentja e UBT-së ideon dhe projektin Qendrën për Strehimin e Fëmijëve “Foleja”



Studentja e vitit të tretë në Fakultetin Dizajn i Integruar në UBT, Agnesa Lusnjani, ka dizajnuar projektin e qendrës “Foleja”, projekt ky i ideuar dhe dizajnuar për fëmijët që kanë probleme financiare dhe nuk mund të ndjekin shkollimin, e që në këtë qendër do të kenë mundësinë të ushqehen, pushojnë e mësojnë gjatë ditës. “Koncepti për zhvillimin e kësaj qendre vjen si frymëzim i drejt-


përdrejtë nga puna e palodhur e disa qendrave të këtij lloji për t’u ofruar fëmijëve siguri, ngrohtësi dhe t’i inkurajoi ata të vazhdojnë arsimimin e tyre”, ka thënë Agnesa.

Sipas saj, UBT i ka ofruar shumë mundësi, që kanë kontribuar në ngritjen akademike, kështu duke e ndihmuar profesionalisht dizajnimin e një qendër të tillë.

“UBT më ka ofruar shumë mundësi, nga ku unë munda të

shikoja veten dhe të mendoja se si mund të përfitoja dhe të rritem profesionalisht nga kjo përvojë”, ka shtuar studentja e Fakultetit Dizajn i Integruar, Agnesa Lusnjani.

E dëshira e saj për të jetësuar projektin e qendrës “Foleja” është e madhe, pasi siç thotë ajo, kjo qendër do t’i bashkëngjitej shumë qendrave të tjera që kanë një mision të ngjashëm.



Burhanudin Tivari, studenti që përfitoi bursë për shkëmbim semestral në Letoni

UBT i ka mundësuar shkëmbim semestral studentit të Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë, Burhanudin Tivari, në Riga Technical University, një nga universitetet prestigjioze në Letoni.

Ëndrra e tij për të qenë pjesë e universitetit me mbi 150 vite eksperiencë në fushën e shkencave teknike, i është realizuar falë mundësive unike që UBT ekskluzivisht i ofron për studentët e vet. Burhanudini do të udhëtojë për Letoni në shkurt të këtij viti, teksa pret që të përfitojë eksperiencën profesionale.

“Shkëmbimi studentor është një përvojë e re, që mendoj se do të më ofroj njohje me njerëz të rinj në të njëjtën fushë të studimit, shkëmbim të ideve dhe sigurisht zgjerim të dijes, sidomos duke marrë parasysh faktin që



RTU (Riga Technical University) gëzon reputacion të lartë në nivel ndërkombëtar”, theksoi ai. Tutje, ai theksoi se këto mundësi i bëjnë të veçanta studimet në UBT, përfshirë, siç tha, komunikimin dhe bashkëpunimin e profesorëve dhe përkushtimin e madh të tyre për të ndihmuar që studentët të arrijnë zhvillim

akademik.

UBT ka partneritet dhe bashkëpunim me rreth 500 universitete dhe institucione të shquara në botë, falë së cilave bëhet shkëmbimi i studentëve, stafit akademik, si dhe ka krijuar bashkëpunim në aspektin shkencor dhe teknik, vizita studimore, etj.

Annea Futko, studentja e Mekatronikës që përftoi aftësi akademike dhe profesionale në UBT



Mekatronika është profesion që kombinon aftësitë mekanike, elektrike, kompjuterike dhe softuerike për të punuar me teknologji të zgjuara, të tilla si robotë, sisteme të drejtuar automatikisht dhe pajisje prodhimi të integruara në kompjuter.

Pavarësisht kompleksitetit që ka si profesion, Annea Futko vendosi të studiojë në Fakultetin Menaxhim i Mekatronikës në UBT, program unik që i ndihmoi asaj të përfitojë aftësi në modelimin e pajisjeve robotike dhe inteligjente. Annea si studente përfitoi edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UBT ka me qindra universitete botërore. Ajo pati mundësinë të përfundojë trajnime dhe mobilitete në Evropë dhe ShBA. Pas mbarimit të studimeve dhe mobiliteteve, u kthye në Kosovë dhe u punësua në pozitën e asistentes në Fakultetin Menaxhim i Mekatronikës, njëherësh është edhe asistente në drejtorinë për Çështje Akademike në


UBT. “Lista e faktorëve të cilat e bëjnë UBT atë që është, të veçantë dhe numër një në arsimin e lartë në vende dhe rajon, është listë e gjatë. Por, ajo çka i bënë studimet më të veçanta është së pari cilësia që u jep studentëve çoftë nga ana e ligjëruesve, ashtu edhe nga kushtet laboratorike, vizitat brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, me anë të bashkëpunimit që ka mes universiteteve të tjera anë e mbanë botës, studimi në UBT ofron kooperimin me këto universitete ku studentët kanë mundësinë të degjojnë ligjërata nga profesorë ndërkombëtar, por edhe të fitojnë eksperiencë duke vizituar këto universitete”, theksoi ajo. Annea tregoi se aktualisht po mbanë ushtrime për lëndë të ndryshme shkencore në fushën e Mekatronikës, teksa inkurajoi vajzat që ta zgjedhin këtë profesion për të studiuar dhe të bëhen pjesë e qendrës më të madhe teknologjike dhe shkencore, institucionit arsimor siç është UBT.

Studenti i UBT-së zgjidhet anëtar i Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit

Studenti i nivelit master në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Veron Tara është zgjedhur anëtar në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit.

Aftësimin paraprak për këtë fushë Veroni e ka fituar në UBT, gjegjësisht në lëndën Restaurimi dhe Mirëmbajtja e Trashëgimisë Kulturore, ku nga aty ai ka vazhduar rrugëtimin në këtë drejtim. Sipas tij, lëndët e ndryshme dhe gërshetimi unik që ka bërë UBT në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, kanë bërë që ai të përfitojë shumë njohuri dhe përvoja të ndryshme nga ekspertë dhe profesionistë të arkitekturës në UBT.

“UBT më ka ofruar avancim në



drejtimet të cilat unë veçse jam i kycur, ku dhe jam në përfundim të studimeve Master Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor”, është shprehur studentin Veron Tara.


Fakulteti Arkitekturë dhe Plan-

ifikim Hapësinor në UBT, vazhdimisht ka nxjerrë kadro profesionale për tregun e punës, duke u ofruar studentëve të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetet e tyre teorike dhe praktike.

Studentët e UBT-së dhe të Universitetit të Iowa-s shkëmbyen njohuri dhe përvoja në fushën e ekonomisë

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, kishin mundësinë të mbajnë ligjërata të përbashkëta me studentët e Universitetit të Iowa-s, meqë rast ata mund të shkëmbejnë njohuri dhe përvoja të ndryshme nga perspektivat e tyre. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që të gjenerohet sa më shumë dije në mes dy institucioneve duke bërë kështu që këta studentë të mësojnë sa më shumë nga njëri-tjetri. Në këtë ligjëratë të përbashkët pjesëmarrës ishte edhe përfaqësuesja e Konsulatës së Kosovës

në shtetin e Iowa-s, Kim Heideman, e cila ka diskutuar me studentët rreth lidhjes së ngushtë që ka Kosova me shtetin e Iowa. Falë bashkëpunimit që UBT ka me Universitetin e Iowa-s, studentët e UBT-së, do të ndjekin ligjërata të përbashkëta nga profesorë e ekspertë ndërkombëtarë, teksa ky bashkëpunim do t'i kontribuojë shumë studentëve të UBT-së në marrjen e njohurive dhe përvojave të ndryshme nga këta ekspertë, në rrugën e tyre drejt një karriere profesionale.



Arbër Asllani, krijoi brendin e tij "23456 Faces", përmes materialeve të ripërdorueshme



Studenti i Fakultetit të Dizajnit të Integruar Arbër Asllani, ka themeluar brendin e tij "23456 Faces", i cili po dizajnon rroba unike, kapele, çanta, maska, bluza, këmbisa, dhe gjera të ndryshme me karaktere të animuara. Ai përgjatë kohës se karantinës duke i zhvilluar ligjëratat online, është inspiruar dhe me patronët të cilit i kishin punuar gjatë ushtrimeve filloi të dizajnojë dhe të i qepë rrobat. "Gjithçka filloi online, fillova të postoj punime të ndryshme në rrjete sociale e tani kemi më shumë se 100 produkte të postuara e shumë të tjera në pritje për

të dal në shitje. Tani fokusohemi që të sjellim një frymë të re në shoqërinë tonë. Me këtë brend un dua të rris vetëdijesimin për ripërdorimin e materialeve të ndryshme ngase kjo është çfarë ne bëjmë, marrim materiale të cilat më herët kishin një funksion tjetër dhe nga to krijojmë produkte të reja", potencoi ai. Ai po ashtu shtoi se në kuadër të brendit "23456 Faces", do të sjell edhe gjëra kreative në botën digjitale si: dizajnim i GIF-s, Stickers dhe Instagram Filters. Gjithashtu herë pas here do të dizajnohen edhe produkte speciale të cilat i përshtaten sezonit,

si: kartolina të ndryshme, aksesori si vath, byzylyk dhe zingjirë të ndryshëm", theksoi ai. Tutje, Arbri ka theksuar se është shumë falënderues për stafin profesional të UBT-së, të cilët e kanë motivuar dhe i kanë dhënë njohuri profesionale për të ndjekur këtë drejtim në mënyrë më të mirë të mundshme, ku sipas tij secili profesor u bë udhërrëfyes dhe mbështes i punës së tij. Ndërkaq, në të ardhmen Arbri synon të hap studion e tij ku do t'i shkëmbejë njohuritë për të rinjtë që janë të interesuar të mësojnë qepje dhe teknikat e përdorimit të patronit.

Studenti Flakrim Krasniqi punësohet në Korporatën Energjetike të Kosovës

Studenti i nivelit master në Fakultetin Inxhinieri e Energjisë Efiçiente, Flakrim Krasniqi ka filluar punën në Korporatën Energjetike të Kosovës. Ai është duke punuar në departamentin e mirëmbajtjes elektrike, në pozitën "Inxhinier i kryerjes për gjenerator dhe furnizimi njëkohor (AC) nga aku-bateritë". Më parë ai ishte pjesë e departamentit të Mijes Sipërfaqësore të Thëngjillit në Mirash, para se të transferohej në TC Kosova A. Flakrimi ndjehet i lumtur që falë përvojës akademike po jep kontribut profesional në vendlindjen e tij. "Interesimi im për fushën e inxhinierisë ka lindur shumë herët. Jam shumë falënderues të gjithë profesorëve, që me njohuritë dhe këshillat e tyre, më kanë nxitur të punoj më shumë dhe me përkushtim për të realizuar ëndrrën time", ka thënë ai. Fakulteti Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment në UBT, është një nga fakultetet me programin më inovativ, që studentëve u mundëson aftësimin profesional me praktikën më të mira ndërkombëtare, që zhvillohen nga ekspertët e UBT-së në Laboratorin e Inxhinierisë së Energjisë



Studentët e UBT-së vazhdojnë studimet në Letoni përmes programit Erasmus+



Margarita Shala dhe Natyra Asllani janë studente të UBT-së që kanë përfituar nga shkëmbimi semestral në kuadër të programit Erasmus+. Ato janë duke vazhduar studimet në Riga Technical University në Letoni, falë bashkëpunimeve të shumta që UBT ka me universitetet ndërkombëtare. Margarita e Natyra nuk janë studentet e vetme që kanë bërë

shkëmbim semestral në universitete të ndryshme të botës, pasi që edhe shumë studentë të tjerë kanë përfituar nga bashkëpunimi që UBT ka me institucione të ndryshme arsimore në të gjithë botën. Përmes bashkëpunimeve të tilla, studentët shkëmbejnë përvoja të ndryshme, si dhe përfitojnë njohuri dhe praktika ndërkombëtare, të cilat i sjellin në vendin tonë.

Studentja Fatbardha Fejzullahu synon t'i japë "jetë" Shtëpisë së Kulturës në Hajvali

Dikur ishte Shtëpi e Kulturës, por tani hapësirat e sallave ku zhvilloheshin aktivitetet kulturore të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve "Hajvalia" dhe kinemaja, janë shndërruar në depони të mbeturinave.

E mu për këtë gjë, studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Fatbardha Fejzullahu, ka bërë gati projektin për t'i dhënë prapë jetë, Shtëpisë së Kulturës në Hajvali. Ajo vendosi që projektin e saj



ta publikojë gjatë periudhës së karantinës si pasojë e Covid-19, për t'i ofruar diçka pozitive rrethit. Dëshira për të parë gjallëri

në këtë ndërtesë, përmes aktiviteteve të ndryshme nga të rinjtë e Hajvalisë, solli projektin e Fejzullahut, pasi që ky ob-



jekt i ndërtuar nga Miniera e Kishnicës në vitet e 1950-ta, i kanë mbetur vetëm disa mure e rrënoja. Sipas saj, rikonstruk-

timi dhe adaptimi për ripërdorim jo vetëm që do të rikthen ndërtesën, por rikthen historinë në këtë objekt dhe në lagje.

Studenti i Shkencave të Ushqimit angazhohet në kompaninë Limagrain në Gjermani



Marrëveshjet që UBT ka me universitete e kompani prestigjioze jashtë vendit, që ndërlihen me fushën që studentët e UBT-së studiojnë, ka bërë që studentin e Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, Jasin Kadrija, të nis punën praktike në kompaninë Limagrain në Gjermani. Ai është angazhuar në këtë kompani për të shkëmbyer për-

voja e për të përfutur njohuri të reja praktike mbi fushën që ai ka studiuar viteve të fundit. E këto përvoja padyshim që studentin Jasin Kadrija do t'i sjellë në Kosovë e do t'i ndajë me studentët e profesionistë të fushës së Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë.

Sipas tij, UBT i ka ofruar një mjedis të përshtatshëm për stu-

dime në mënyrë profesionale, e në veçanti në drejtimin Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, me infrastrukturë moderne dhe laboratorë të sofistikuar.

"UBT na ka ofruar një mjedis i cili është i përshtatshëm për studime në mënyrë profesionale. Në drejtimin shkencat e ushqimit, kemi pasur mundësinë të vizitojmë shumë fabrika, reparte prodhuese, e të bëjmë eksperimente të ndryshme. Kjo na ka mundësuar që t'i përcjellim nga afër të gjitha proceset që më parë i kemi mësuar, dhe tani mundësia e punës praktike jashtë vendit, është një eksperiencë shtesë për të zgjeruar edhe më shumë diapazonin tonë të dijes", ka thënë Jasin Kadrija, student i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT.

Në kompaninë Limagrain, ai bashkë me disa studentë të tjerë që janë përfutur të kësaj mundësie për punë praktike, do të përfutur shumë njohuri në degën e bioteknologjisë dhe studimit të farave, e që do iu kontribuojnë në të ardhmen për eksperiencat e reja të tyre dhe ndërtimin e një karriere sa më profesionale.

Egzon Salihu, studenti që po vazhdon studimet në Technical University of Sofia, Bullgari



Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Egzon Salihu është duke vazhduar studimet në Technical University of Sofia, atje ku po përfutur njohuri dhe përvoja të reja, në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë. Ai ka përfutur nga mundësia për shkëmbim semestral në Bullgari, që UBT u ofron studentëve të dalluar, falë bashkëpunimeve që ka me universitete prestigjioze në gjithë botën.

Për këtë mundësi ai ka thënë se UBT i ka dhënë kushtet e nevojshme, jo vetëm atij por të gjithë studentëve, në mënyrë që ata të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për fushën që kanë zgjedhur për të studiuar.

"UBT më ka ofruar të gjitha mundësitë e mundshme për të studiuar, duke filluar prej transportit që organizon për studentët, kampusit universitar në të cilin studentët mund t'i shfrytëzojnë të gjitha hapësirat, ato sportive, bibliotekën, sallat e leximit, laboratorët e shumtë, si dhe sallat e ligjërimit", ka thënë studentin i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Egzon Salihu.

Prej eksperiencave të tij në UBT ai ka veçuar cilësinë e stafit akademik, mësimdhënien, thjeshtësinë, si dhe dëshirën dhe angazhimin e madh të secilit prej tyre për të ofruar dijen dhe përvojën që ata kanë.

Studentja Flaka Ajeti filloi punën praktike në RTK

Studentja e vitit të dytë të Fakultetit Media dhe Komunikim, Flaka Ajeti, ka nisur punën praktike me mundësi punësimi në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).

Ajo aktualisht është e angazhuar si gazetare në dhomën e lajmeve dhe po i mbulon ngjarjet ditore në radio dhe televizion.

"Është një thënjë për mësuesit dhe për profesorët që thotë: "një nxënës dhe një mësues i mirë mund të ndryshojë botën", të njëjtën e bënë edhe profesorët në rrugëtimin tim profesional si një gazetare e së ardhmes", potencoi Flaka. Ndërkaq, Flaka theksoi se nëse studentët duan mësim kualitativ dhe cilësor, atëherë UBT është zgjidhja më e mirë për të gjithë.



Studentja e Shkencave Kompjuterike, Gentiana Blakaj, përfituese e bursës së programit Erasmus +


Studentja e nivelit master të Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Gentiana Blakaj, është përfituese e bursës për shkëmbim semestral për të vazhduar studimet në “Technical University of Sofia”, Bullgari. Ajo ka përfituar nga kjo mundësi unike, për të vazhduar studimet jashtë vendit, falë partneriteteve të UBT-së me universitete prestigjioze, si dhe programit Erasmus+, meqë rast do të shkëmbejë dhe marrë përvoja të ndryshme nga ky universitet. UBT si një institucion që ofron mundësi të shumta për secilin



student, dhe falë cilësisë, profesionalizmit e përkushtimit të profesorëve, ka bërë që Gentiana të bindet dhe studimet e saj t'ia besoj institucionit më të madh të arsimit të lartë në vend. Sipas saj, UBT ofron shumë mundësi të ndryshme të cilat janë të dobishme për ndërtimin e një karriere profesionale për secilin student që synon të arrijë të bëhet një profesionist në fushën që studion. “UBT ofron mundësi unike për rritje dhe zhvillim individual, ndaj edhe për këtë arsye kam vendosur të aplikoj në “Technical

University of Sofia”, në mënyrë që të përfitojë nga eksperiencia që ofron ky program”, ka thënë Gentiana, studente e Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT. Nga ky shkëmbim studentor, ajo pret që të krijojë lidhje të reja të studentëve me profesorët me qëllim që të mësojnë sa më shumë nga puna e tyre, si dhe të mësojnë praktika të reja të punës, në mënyrë që të avancojnë njohuritë e tyre në fushën e shkencave kompjuterike dhe inxhinierisë.

Studenti i UBT-së, Saimir Dinaj angazhohet në kompaninë “Limagrain”, në Gjermani



Ambasadorët e Kosovës janë të rinjtë tanë dhe studentët që dinjitetshëm po përfaqësojnë vendin përmes punës, ideve e aftësive të tyre në fusha të ndryshme, dhe ata po dalin nga UBT, institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend. I tillë është edhe Saimir Dinaj, student i nivelit master në Fakultetin Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, i cili është angazhuar në kompaninë “Limagrain” në Gjermani, kompani kjo e cila merret me prodhimin dhe shitjen e farërave bujqësore, siç janë: farërat e misrit, drithërave, proteinave dhe kulturave vajore. Të diplomuarit e UBT-së me kualitet të lartë të cilët dalin si

kuadro profesionale, me institucionin që u ofron mbështetje në çdo kohë, me profesionistë të fushave të ndryshme, si dhe me kushte infrastrukturore, kanë bindur që Saimiri të zgjedhë UBT-në që të zhvillohet edhe më shumë në rrugëtimin e tij akademik në karrierë. Sipas Saimirit, UBT ishte zgjedhja e duhur, që sot i ka hapur një tjetër horizont në rrugëtimin e tij profesional në fushën e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. “UBT më ka ofruar shumë mundësi, duke filluar nga komunikimi i lehtë me profesorët, qasja dhe kujdesi i tyre ndaj studentëve, kushtet infrastrukturore për analiza laboratorike, si dhe gërshetimi i teorisë me

praktikën, e që më bindën se kisha bërë zgjedhjen e duhur”, ka thënë studenti i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, Saimir Dinaj. Ai theksoi se UBT-në e bën të veçantë mundësia që ky institucion u ofron studentëve të dalluar që të dëshmojnë vetën në shumë aspekte dhe në shumë fusha, përmes konferencave shkencore, trajnimeve të shumta, akademive verore, e praktikave të ndryshme. Saimir Dinaj nuk është i vetmi studentë i UBT-së që përmes aftësive dhe njohurive po përfaqësojnë Kosovën me punën e tyre profesionale, duke ndihmuar në ndërkom-bëtarizimin sa më të denjë të vendit tonë.

Studentja e Medias dhe Komunikim, Sara Shehu, punësohet menjëherë pas përfundimit të studimeve

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Sara Shehu, menjëherë pas përfundimit të studimeve është punësuar në televizionin Festina, një media lokale në Ferizaj, në cilësinë e gazetares së terrenit. Sara poashtu po realizon lajme për rubrika të ndryshme përfshirë këtu edicionin qendrorë të lajmeve. “Unë pasi kam diplomuar në Fakultetin Media dhe Komunikim, kam arritur që të punësohem në bazë të asaj që mësova në UBT dhe arrita që të siguroj një vend të punës në profesionin që gjithmonë e kam ëndërruar”, ka thënë studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Sara Shehu. Ndërkaq, ajo theksoi se ligjërimi i profesorëve përgjatë tre vite studimeve në Fakultetin Media dhe Komunikim ka ndikuar shumë në zhvillimin e karrierës të saj. Sipas Sarës, studimet në UBT e kanë ndihmuar atë të avancohet dhe të bëhet më profesioniste në fushën e gazetarisë, ku tani ajo po i vazhdon edhe studimet e nivelit master në UBT. “Përshtypjet e mia për UBT-në që nga fillimi kanë qenë pozitive, pasi që bachelorin e kam përfunduar në UBT, edhe masterin e kam regjistruar në fushën e Politikave Publike dhe Menaxhim.

Arsyeja që i kam vazhduar studimet në nivelin master në UBT është sepse kam kaluar tre vite të shkëlqyera në studimet para-prake”, tha ajo. Sara nuk është e vetmja studente e cila është sistemuar në tregun e punës menjëherë pas studimeve në UBT, pasi që edhe shumë studentë të tjerë të UBT-së nga fusha të ndryshme studimi, kanë arritur që të ambientohen në vende të ndryshme të punës. Studentja e UBT-së, Gresa Shala, do të vazhdojë studimet në Linnaeus University të Suedisë Numrit të studentëve të shumtë që janë duke studiuar jashtë vendit përmes mundësive të shumta që UBT është duke i ofruar të gjithë studentëve i është shtuar edhe studentja e Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Gresa Shala. Gresa është një nga përfitueset e bursës për shkëmbim studentor në Linnaeus University të Suedisë, përmes programit Erasmus+, bashkëpunim ky i UBT-së me shumë universitete prestigjioze të botës. Ajo është e lumtur që ka zgjedhur UBT-në për të vazhduar studimet akademike dhe që ka përfituar bursë nga ky institucion i arsimit të lartë. Gresa ka vlerësuar lartë mundësitë

që UBT i ka dhënë, jo vetëm asaj por të gjithë studentëve gjatë gjithë rrugëtimin akademik. “Përveç profesorëve të kualifikuar, kampusit dhe laboratorëve të përshtatshëm, mundësitë e ofruara nga UBT kanë qenë të mëdha. Gjatë kohës së studimeve, UBT rregullisht na ka lajmëruar për oferta pune dhe punë praktike në institucione prestigjioze, si dhe mundësi të arta për ndjekje të studimeve jashtë vendit”, ka thënë Gresa Shala, studente e vitit të dytë në Fakultetin Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT. Gresa do të ketë mundësinë të studiojë në njërin prej universiteteve më prestigjioze dhe do të jetë një mundësi shumë e mirë për të që të njihet me kultura të reja, si dhe të përfitojë eksperiencat e ndryshme nga profesionistë e ekspertë të fushës ku ajo ka zgjedhur që të vazhdojë rrugëtimin e saj drejt një karriere profesionale. Studentë nga Bullgaria zgjedhin UBT-në për të realizuar punimet e tyre të diplomës Në kuadër të bashkëpunimit të UBT-së me Universitetin Teknik të Sofias në Bullgari, dy studentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të Universitetit Teknik të Sofias kanë zgjedhur UBT-në për përfundimin e temës



së diplomës. Nën mentorimin e prof.dr. Besnik Qehaja, të dy studentët janë duke realizuar punimet e tyre të diplomës të nivelit bachelor në fushën kërkimore të telekomunikacionit. Studenti Georgi Angelov është duke punuar në temën “Developing WSN Application in Smart City” ndërsa Kolyo Petrov në temën “Developing WSN Application for Energy Efficiency”, dhe që të dy janë duke punuar me labora-

torët e IoT, 5G dhe Cisco në UBT, për testimet dhe kërkimet e tyre shkencore. UBT gjatë dy viteve të fundit ka shkëmbyer studentë me Universitetin Teknik të Sofias në Bullgari, në të dy nivelet e studimit, kështu duke mbetur institucioni më kredibil dhe serioz sa i përket vlerave të studentëve dhe stafit gjatë mobiliteteve në gjithë Evropën.

Studentja e UBT-së do të vazhdojë studimet në Linneaus University në Suedi

Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Nita Berisha është studentja e radhës që është përfituese e bursës për shkëmbim semestral për të vazhduar studimet në "Linneaus University", në Suedi. Falë shtrirjes së bashkëpunimit të UBT-së në gjithë botën me universitetet më të mira ndërkom-bëtare, si dhe programit Erasmus+, Nita do të ketë mundësinë që të fitojë eksperiencë dhe kulturë të reja në zhvillimin e saj akademik dhe profesional.

Ajo ka vlerësuar UBT-në maksimalisht duke mos pasur dyshime për zgjedhjen e institucionit ku ajo do të zhvillohet profesionalisht në fushën e Shkencave

Kompjuterike dhe Inxhinierisë. "Vendimi për të studiuar në një mjedis cilësor si UBT, ishte diçka e bazuar nga puna e mirëfilltë e UBT-së gjatë viteve dhe UBT ka qenë një zgjedhje e duhur për mua pasi që më ka ndihmuar të zhvilloj aftësitë e mia profesionale dhe akademike. Falë studimeve në UBT, përkushtimi dhe vendosshmëria ime vetëm janë rritur. Njohuritë e mia rreth fushës së Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë po pasurohen çdo ditë e më shumë", ka thënë studentja e UBT-së, Nita Berisha. Sipas saj, UBT i ka ofruar një mjedis cilësor dhe profesional, duke përfshirë kampuset, libraritë laboratorët e ndryshëm, si

dhe hapësirën e nevojshme në mënyrë që ajo dhe studentët e tjerë të zhvillojnë aftësitë e tyre drejt një karriere të suksesshme në rrugëtimin që ata kanë zgjedhur.

Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Nita Berisha, ka inkurajuar të gjithë studentët që të zgjedhin UBT-në, njëherë prej shtëpive më të mëdha akademike në vend dhe të përfitojnë nga shumë mundësi që ky institucion arsimor ofron, pasi që sipas saj, ata do të përfitojnë shumë aftësi komunikuese e sociale, si dhe do të bëhen më të përkushtuar në rrugëtimin e tyre jetësor.

#SUCCESSTORY

Studentët e UBT-së drejt botës



Nita Berisha, nga Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, fitoi bursë përmes programit Erasmus+ të vazhdojë studimet në Universitetin Linneaus në Suedi



Studenti i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT angazhohet në kompaninë "Limagrain", në Gjermani

Ish-studenti i UBT-së, Ardit Hoti, është angazhuar në kompaninë e cilat merret me prodhimin e farava dhe kultivimin e tyre, "Limagrain".

Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, me ç'rast është ndarë i kënaqur që ka pasur mundësinë të studiojë në këtë universitet.

"Përfitimet e mia në UBT kanë qenë të mëdha, ndaj dhe i kanë tejkaluar pritshmëritë e mia, dhe u jam mirënjohës dhe falënderues stafit të UBT-së. Përgjatë studimeve kemi pasur mundësinë të vizitojmë industri të ndryshme ushqimore në kuadër të praktikave dhe ushtrimeve, e kjo na



ka ndihmuar shumë që të marrim njohuri të mjaftueshme", ka thënë ai.

Ish-studenti i UBT-së, Ardit Hoti, ka vlerësuar se UBT ka potencial të madh për t'i dhënë tregut të punës njerëz të kualifikuar dhe të dijshtëm. Ai ka theksuar se UBT-në e bën të veçantë infrastruktura dhe stafi profesionist, të cilët janë mundësi e mirë për t'u ngritur profesionalisht.

"UBT-në e bën të veçantë avancimi në mënyrën e të mësuarit dhe të studiuarit, mundësia për të arritur qëllimet e parashikuara duke përfshirë kryerjen e analizave në laboratorë e pajisje më të avancuara, mundësia për praktika në industri ushqimore

të ndryshme, si dhe komunikimi i lehtë me stafin ligjërues, të cilët kanë një eksperiencë të lartë në fushën e teknologjisë ushqimore", ka shtuar Hoti, i cili shprehet se në kompaninë "Limagrain", do të marrë njohuri dhe eksperiencë në fushën e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë.

UBT vazhdimisht i ka përkrahur studentët, të cilët kanë shprehur gatishmërinë për t'u ngritur profesionalisht në këtë institucion. Kjo tashmë po dëshmohet me studentët tanë, të cilët po punësohen dhe po angazhohen nëpër ndërmarrje publike dhe private, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Xheneta Velju, punësohet në RTV 21



Studentja e nivelit master e cila njihëherësh i ka vijuar edhe studimet të nivelit bachelor në Fakultetin Media dhe Komunikim, Xheneta Velju, është punësuar në cilësinë e gazetares në RTV 21. Ajo aktualisht po merret

me "Mobile Journalism", proces i cili përfshinë fotografimin, xhirimet, transmetimet e drejtpërdrejta dhe montazhin në telefon mobil. Xheneta theksoi se studimet ishin baza e njohjes me fushën e gazetarisë dhe pro-

fesionalizmi i stafit akademik, i kontribuoi njohjes profesionale në një lëmi të tillë.

"Në prag të përfundimit të studimeve master, nuk mund të lejoja të mos kem eksperiencë në media më të mëdha, ani pse kisha punuar edhe më herët në njërën nga televizionet në Ferizaj, tani kam filluar punë si gazetare në RTV 21", tha ajo. Sipas Xhenetës, puna të cilën po e zhvillon tani në fushën e "Mobile Journalism", krahasuar me gazetarinë tradicionale është më fleksibile, më pak e kushtueshme dhe më lehtë e realizueshme. Gjithsesi, ky lloj i gazetarisë ka edhe mangësitë e veta, duke qenë se në Kosovë është ende në fazë fillestare, dhe mund të përcillet edhe me probleme teknike. Ndërkaq, ajo potencoi se UBT është institucion i cili ofron për studentët profesionalizëm, korrektësi si dhe mundësi për tu avancuar, të cilët edhe po kanë qasje shumë të lehtë në tregun e punës.

Studentja e UBT-së, Ariana Tahiri zë vendin e parë në garën "Datathon Business Analysis"



Janë shpallur fituesit e garës më të madhe në vend "Datathon Business Analysis", me ç'rast në vendin e parë është renditur studentja e UBT-së Ariana Tahiri. Nga mbi 100 pjesëmarrës sa ishin në këtë garë, ekipi "Data Sense" i përbërë nga studentja

Ariana Tahiri si dhe garuesja Fjolla Krasniqi, ka arritur të triumfoi, në garën e organizuar nga UBT dhe Raiffeisen Bank, në të dhëna dhe punën me big data. Të dy garueset kanë thënë se ndihen të lumtur me triumfin dhe eksperiencën që kanë pasur në garën "Datathon Business Analysis", teksa kanë theksuar se gjatë kësaj gare kishin fatin të monitorohen nga profesionistë dhe ekspertë të kësaj fushe.

Kjo nuk është hera e parë që UBT bashkë me Raiffeisen Bank organizojnë një garë të tillë, pasi që edhe herëve të kaluara këto dy institucione kanë organizuar gara të tilla, përfshirë këtu edhe njëherë prej garave më të mëdha në vend "Data Science Hackathon".

Profesori i UBT-së dr. sc. Petrit Ahmeti, i certifikuari i parë në Kosovë si Projektues i Certifikuar për Shtëpitë Pasive



ekspertët e certifikuar nga Instituti Passive House, dr. sc. Petrit Ahmeti, profesor i UBT-së, arriti të marr vlerësim pozitiv në ekzaminim nga ky institut i nivelit ndërkombëtar duke u certifikuar si Certified Passive House Designer/Consultant.

Përmes këtij certifikimi, dr. sc. Petrit Ahmeti u bë pjesë e databazës ndërkombëtare të Certified Passive House Designer/Consultant, si projektuesi i parë i këtij niveli në Kosovë dhe duke futur Kosovën në databazë ndërkombëtare, pjesë e së cilës janë mbi 80 shtete, duke përfshirë ShBA-të, Gjermaninë, Kinën, Kanadanë, Britaninë e Madhe, Zvicrën, Emiratet e Bashkuara etj.

Në kuadër të një trajnimi të veçantë dhe intensiv për standardin e ndërtimit të cilësisë së lartë dhe efijencës së energjisë Passive House, të mbajtur nga

Njëherësh, dr. sc. Petrit Ahmeti tashmë është edhe anëtar i International Passive House Association.

Studenti i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, punësohet në portalin Lajmi.net



Studenti i vitit të dytë të Fakultetit Media dhe Komunikim, Uranik Emini, ka filluar punën në portalin Lajmi.net. Ai aktualisht po i mbulon shkrimet dhe postimin e lajmeve, raportimin mbi lajme të ndryshme që

lidhen me fushën e sportit, zhvillimin e intervistave varësisht prej aktualitetit dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira me institucione, personazhe dhe medime të tjera.

Si shumica e studentëve, edhe Uraniku falë bashkëpunimeve të UBT-së me medimet prestigjioze në Kosovë, që nga viti i parë i studimeve ka treguar sukses në tregun e punës, ku ai ka përfunduar edhe praktikë në agjencinë e lajmeve Kosovalive. “Studimet dhe puna e profesorëve kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin e karrierës sime. Mësimet, këshillat, ndarja e përvojave personale kanë ndikuar shumë që ne të kemi një koncept më të pastër dhe më të qartë mbi atë se çfarë është në të vërtetë puna e një gazetari. Sukseset tona, janë meritë e punës së jashtëzakonshme që kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë profesorët në UBT”, theksoi ai.

Ndërkaq, ai potencoi se UBT është institucioni më profesional në vend dhe më gjerë, ku punën e suksesshme e dëshmon bashkëpunimi që e ka me mbi 450 universitete partnere si dhe suksesi i studentëve ndërvite.

“Sa i përket drejtimit Media dhe Komunikim, vlerësojë shumë faktin se ka llojshmëri në mesin e studentëve, për arsye se jo të gjithë dëshirojnë të bëhen gazetarë të së ardhmes, e në këtë drejtim mund të dilni si producent, kameraman, si specialist i marketingut, ekspert të komunikimit etj.”, tha Uraniku.

Uranik Emini nuk është studenti i vetëm i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, që ka arritur të ambientohet në tregun e punës, pasi që më parë edhe shumë studentë të këtij drejtimi kanë arritur që të punësohen në media dhe kompani të ndryshme marketingu.

Studentja e Ndërtimtarisë në UBT, Ninëz Kosumi, punësohet në organizatën UNOPS

Studentja e nivelit master në Fakultetin Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, Ninëz Kosumi, është punësuar në organizatën UNOPS, organizatë kjo që operon dhe implementon projekte në Kosovë në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

Përgjatë studimeve në nivelin master, Ninëzës iu ofrua një mundësi unike për të ndjekur një praktikë në terren në kompaninë Bechtel Enka, si pjesë e bashkëpunimit që UBT ka me kompani të ndryshme në Kosovë.

E shkathtësitë dhe cilësia e studimeve, me gërshetimin e praktikës profesionale, bëri që Ninëza të vazhdojë rrugëtimin e saj profesional në organizatën UNOPS,

si “Junior Project Engineer”, fillimisht si praktikante, e më vonë edhe si punonjëse e rregulltë.

Projekti “Integrated Border Management – Common Crossing Points in Merdare, Mutivoda, and Bernjak” i dha mundësinë asaj që ajo të punojë në pikë-kalimet kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

“Punët e mia profesionale në këtë organizatë fillimisht nisën me punët e implementuara në terren në projektin për “Integrated Border Management – Common Crossing Points in Merdare, Mutivoda, and Bernjak”, ku pata mundësinë të punoj në pikë-kalimet kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pika Merdare dhe

Mutivode, ku bashkë me kolegët kemi mbikëqyrur punët ndërtimore të këtyre dy pikave”, ka thënë studentja e Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë në UBT, në nivelin master, Ninëz Kosumi.

Sipas saj, UBT i ka krijuar asaj dhe studentëve të tjerë mundësitë e nevojshme për të kryer punën praktike në kompani të ndryshme.

“Falë mundësisë së krijuar nga UBT që të jem pjesë e praktikës në Bechtel Enka ku fitova shumë informata në lidhje me punët ndërtimore në terren, si dhe përcjelljes së ofertave të ndryshme për punë nga Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe In-



frastrukturë më UBT, unë arrita që t'i krijoj vetes mundësi të ndryshme për zhvillim profesional”, ka thënë ajo.

Mbi 98% e studentëve të Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë në UBT, të cilët

mbarojnë studimet janë të punësuar në sektorë të ndryshëm të ndërtimtarisë, brenda dhe jashtë vendit, gjë që e bën UBT-në, institucionin me shkallën më të lartë të studentëve të punësuar.

Studenti i UBT-së, Lend Sylejmani, përfitues i bursës për shkëmbim studentor në Universitetin Anhalt - Gjermani

#SUCCESSTORY

Studentët e UBT-së drejt botës



Lend Sylejmani, nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, fitoi bursë përmes programit Erasmus+ të vazhdojë studimet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Anhalt në Gjermani.



Studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Lend Sylejmani është përfituesi i radhës i bursës Erasmus+, për të vazhduar studimet për një semestër në Universitetin Anhalt të Gjermanisë.

Lendi, synimet e tij për të ardhmen i gërshetoi vite më parë me UBT-në, duke zgjedhur këtë institucion për të studiuar dhe ngritur profesionalisht në fushën që ai është profilizuar.

“Duke qenë një person ambicioz, me synim të arritjeve të mëdha në të ardhmen, vendimi për përzgjedhjen e universitetit për studime ka qenë diçka shumë e rëndësishme për mua, dhe pikërisht përzgjedhja që kam bërë

unë që të studioj në UBT më ka vërtetuar këtë gjë”, ka thënë studentin e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Lend Sylejmani.

Platformat digjitale, programet cilësore dhe sistemet inovative e moderne e kanë bindur Lendin që UBT është zgjidhja e duhur dhe më e mira për t'u bërë më i miri, dhe kësaj ai shtyri vetën për të aplikuar edhe për shkëmbim studentor.

“Përmes infrastrukturës moderne dhe laboratorëve të sofistikuar, UBT ofron studimet më cilësore që e kompletojnë formimin tim si student. Arritjet e deritanishme në UBT gjatë studimeve më kanë mësuar shumë,

përtej pritshmërive të mia, kështu që unë dua të vazhdoj edhe më tutje, meqenëse bagazhi im i njohurive duhet të plotësohet, jo vetëm në aspektin arsimor, por edhe në atë kulturor, ndaj edhe kam vendosur të aplikoj për shkëmbim studentor, në Universitetin Anhalt të Gjermanisë”, ka thënë ai.

Përmes programit Erasmus+ dhe bashkëpunimeve të shumta me universitete të ndryshme evropiane, UBT është duke u ofruar studentëve mundësinë për të vazhduar studimet për një semestër në universitetet më të njohura evropiane, kështu duke shkëmbyer dhe fituar përvoja dhe njohuri të reja.

Kompania e themeluar nga studentët e UBT-së, partner i zhvillimit të projekteve në territorin e Ballkanit



Studenti i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Rigon Statovci, dhe student i Fakultetit Dizajn i Integruar, Çlirim Bajcinca, kanë themeluar agjencinë kreative "Zebra Agency". "Zebra Agency" merret me zhvillimin e uebsajteve, video-animacioneve 2D, 3D Motion Graphics, shërbimet e brenndimit, të cilat kanë për qëllim avancimin e arritjeve në fushën e biznesit për klientë. Puna e palodhshme dhe kreative e studentëve tanë ka bërë që kjo agjenci të jetë partner i zhvillimit të projekteve në territorin e gjithë Ballkanit, specifikisht në projektet CBC.

"Zebra Agency" është duke zhvilluar projektin për punësim (punëmarrje dhe punëdhënie), projekt i cili do të përdoret në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Malin e Zi, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i cili implementohet nga ADP-Zid. Kjo agjenci ka ofruar zhvillimin e kampanjave të ndryshme socializuese si: "Voda Je Pravo", kampanjë kjo e zhvilluar për Ministrinë e Kulturës të Malit të Zi, si dhe ka ofruar zhvillimin e kampanjës për vetëdijësim të popullatës në kohë të pandemisë: "#MOSUSHLIRO".

Studenti i UBT-së, Genc Abazi, do të vazhdojë për një semestër studimet në Linnaeus University të Suedisë



"Në krahasim me institucionet e arsimit të lartë lokale dhe rajonale, UBT veçohet me llojshmërinë e programeve të studimit, me afërsinë që kanë me studentët, si dhe me numrin e madh të studentëve të punësuar pas përfundimit të nivelit bachelor të studimeve", ka thënë student i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Genc Abazi.

Përveç kësaj mundësie të ofruar nga UBT, Genc Abazi ka numëruar edhe organizime të tjera që UBT u ka ofruar studentëve në mënyrë që ata të kenë hapësirën e nevojshme për t'u bërë profesionistë në fushën ku ata studiojnë.


"Përpos mundësisë të vazhdimin të shkollimit jashtë vendit, UBT poashtu ka ofruar edhe evente verore (Summer Academy), konferenca ndërkombëtare, ligjëratat tematike, e takime dhe trajnime mbi çështje apo lëndë me interes global", ka thënë ai.

Duke zgjedhur UBT-në, shumë studentë kanë përfituar nga mundësitë unike të vazhdimin të studimeve jashtë vendit përmes programeve të përbashkëta me universitete të ndryshme ndërkombëtare.

Linnaeus University në Suedi do të jetë destinacioni i radhës në rrugëtimin akademik të studentit të Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Genc Abazi. Ai do të vazhdojë studimet për një semestër në këtë universitet, pasi që është përfitues i bursës për shkëmbim semestral në kuadër të programit Erasmus+. Genci, falë shtrirjes së bashkëpunimit të UBT-së me institucionet dhe universitetet

më të mira të arsimit të lartë në Evropë, do të ketë mundësinë që të marrë njohuri nga ekspertë dhe profesionistë ndërkombëtarë në fushën e shkencave kompjuterike, si dhe të shoh nga një dimension tjetër kulturat e shtetit të Suedisë. Ai veçon UBT-në si institucion i arsimit të lartë që ka krijuar një afërsi me studentët duke iu qëndruar në çdo hap dhe sfidë të tyre me stafin profesional akademik të institucionit.

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, bëhet pjesë e portalit UBTNEWS



Arjeta Ibishi është studentja e radhës e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, që është ambientuar në tregun e punës, duke u punësuar në portalin UBTNEWS, me ç'rast është angazhuar në cilësinë e gazetares e cila përcjell ngjarjet e ditës nga fusha të ndryshme të jetës.

Studimet në programin Media dhe Komunikim Arjetës i kanë dhënë kompetenca të larta në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, duke punuar me profesionistët më të mirë që ka fusha e medias, e që ligjërojnë në UBT.

"Programi Media dhe Komunikim në UBT më ka bindur menjëherë

se kjo është ajo çfarë unë realisht kërkoja, një gërshetim unik i komunikimit me median, pra gazetari, marrëdhënie me publikun, fotografi, kamerë dhe marketing", ka thënë fillimisht studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Arjeta Ibishi.

Sipas Arjetës, ky kombinim i programit i ka sjellë asaj benefitet më të mira për një përgatitje profesionale, që e ka ndihmuar atë të jetë e denjë dhe e gatshme për tregun e punës.

"Gërshetimi i programit ishte diçka ndryshe, dhe monotonia asnjëherë nuk kishte vend te studentët e medias, sepse gjithmonë kishte diçka të re, diçka ndryshe, vizitë studimore ose sfidë e re që na bënte me dije se kjo është media dhe ky është komunikimi, ndaj kjo ishte zgjidhja më e mirë për mua", ka thënë ajo.

Arjeta, i është bashkuar numrit të madh të studentëve që kanë studiuar në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, dhe menjëherë janë ambientuar në tregun e punës, teksa UBT me zhvillimin e portalit UBTNEWS, studentëve të këtij programi u ka ofruar mundësi unike për t'u inkuoruar në botën mediale

Studentja e Fakultetit të Infermierisë, Shqiponja Berisha, punësohet në klinikën "Pharm-Aorta"



Studentja e Fakultetit të Infermierisë në UBT, Shqiponja Berisha, është punësuar në klinikën mjekësore "Pharm-Aorta", në cilësinë e infermieres së përgjithshme. Përzgjedhjen e UBT-së si institucion që do të zhvillohet profesionalisht në fushën e infermierisë, Shqiponja e ka pasur të lehtë, bazuar në përputhjen e kërkesave të saj me atë që ofron UBT. "Duke kërkuar për një institucion të arsimit të lartë sa më të përshtatshëm për shkollimin tim në nivelin bachelor në drejtimin e infermierisë, morra shumë informata përmes

rrjeteve sociale dhe rrethit tim shoqërorë në lidhje me UBT-në, dhe bazuar në këtë pashë se ky institucion i përgjigjej edhe kërkesave të mia për shkollim të lartë", ka thënë ajo.

Sipas saj, UBT e ka ndihmuar shumë që të aftësohet në rrugëtimin e saj akademik e profesional, falë qasjes që ky institucion arsimor e ka me të gjithë studentët.

"Nga programi i studimit në UBT kam përfituar mjaft shumë, duke filluar nga ligjëratat dhe pjesa praktike të cilat kryhen me shumë korrektësi nga pro-

fesorët, të cilët janë të kualifikuar dhe të aftë për lëndët që i ligjërojnë, dhe kjo qasje më ka aftësuar edhe më shumë në profesionin tim", ka thënë studentja e Fakultetit të Infermierisë në UBT, Shqiponja Berisha.

Shqiponja është duke punuar si infermiere e përgjithshme, duke u ofruar shërbime qytetarëve si: dhënia e ineksioneve, infuzioneve, kryerja e EKG-së, si dhe është duke shërbyer edhe si instrumentare në repartin e kirurgjisë.

Studenti i UBT-së, Eron Mekolli, punësohet në kompaninë “Hidroing - DK”

Studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, Eron Mekolli, është punësuar në kompaninë inxhinierike “Hidroing - DK”, në pozicionin e inxhinierit të hidroteknikës.

Cilësia e studimeve në UBT, infrastruktura moderne, ekspertët e fushës, si dhe parimet të cilat i kanë ndjekur Eroni, kanë bërë që ai të zgjedhë UBT-në, si institucion i arsimit të lartë që do t'i ndihmojë atij në zhvillimin profesional e akademik në karrierë. “Për një inxhinier është i rëndësishëm ekuilibri dhe

si i tillë ekuilibri bazohet në parime njerëzore, ndaj shfrytëzova parimet për të gjetur ekuilibrin, dhe si rezultat mora UBT-në”, ka thënë studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, Eron Mekolli.

Sipas tij, programi i larmishëm i studimit e ka ndihmuar atë që mjaftueshëm të marrë njohuritë dhe eksperiencat e profesionistëve të fushës, duke e ndihmuar atë në qëllimet e tij drejt suksesit.

“Puna praktike, vizitat e ndryshme studimore, bashkëpunimet që UBT ka

me kompani të ndryshme që ndërlidhen me fushat përkatëse, si dhe transparencën e treguar me studentët, i bënë studimet në UBT më të veçanta, më të ndryshme, si dhe më unike, për dallim nga universitetet tjera”, ka thënë ai.

Ndërlidhja unike e teorisë me praktikën, ka bërë që UBT të shtrijë bashkëpunimin me industrinë, kështu duke rritur numrin e studentëve që ambientohen në tregun e punës, menjëherë pas studimeve ose edhe përgjatë tyre.



Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Blerta Gashi, punësohet në portalin Insajderi



Studentja e vitit të dytë në Fakultetin Media dhe Komunikim, Blerta Gashi, është punësuar në portalin Insajderi. Ajo aktualisht mban pozitën e gazetares në redaksinë e lajmeve dhe merret me redaktimin e lajmeve të medias rozë.

Blerta theksoi se falë bashkëpunimeve të UBT-së me industrinë i është dhënë mundësia që të punësohet në njërin nga portalet më prestigjioze në Kosovë.

“Profesorët me ligjërata

cilësore, si dhe me profesionalizëm, duke bërë kombinimin e teorisë me praktikën na kanë përgatitur për tregun e punës, ku fillimi i karrierës time në këtë profesion, filloi me shumë sukses”, tha ajo.

Ndërkaq, Blerta potencoi se kur ka filluar hulumtimin se ku do t'i zhvillojë studimet e saj, e ka vërtetuar që UBT është vendi i duhur.

“Sigurisht që u ndikova edhe duke parë se ligjëruesit ishin prej më të

mirëve, dhe që doli ashtu si kam menduar, ku falë studimeve në UBT arrita të filloj të punoj në profesionin që gjithmonë e kam dashur”, tha ajo.

Shumë studentë të Fakultetit Media dhe Komunikim, menjëherë pas studimeve, ose edhe gjatë studimeve, arrijnë që të punësohen në vende të ndryshme të punës, kjo edhe si rezultat i bashkëpunimeve të UBT-së me kompani të ndryshme mediatike.

Studenti i UBT-së, Rinor Krasniqi, vazhdon studimet master në “Anhalt University of Applied Sciences”



Studenti i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Rinor Krasniqi, është duke vazhduar studimet e nivelit master në “Anhalt University of Applied Sciences”, në Gjermani, në fushën e ushqimit dhe teknologjisë.

Ai është duke realizuar punën praktike në kuadër të lëndës: “Teknologjia e drithërave dhe produktet e drithërave”, kështu duke bërë analizimin e përbërjes cilësore dhe sasiore të hirit në miell, analizimin e përmbajtjes së lagështisë në miell, indeks glutenin, zgjatueshmërinë e glutenit, përmbajtjen e ujit në bukë, aktivitetin e ujit në bukë, vëllimin e bukës, falling number,

si dhe vlerën e sedimentimit.

Rinori, përgjatë studimeve atje, është duke vazhduar studimin rreth kapacitetit të lidhjes së ujit në mish, stabilitetin e emulsionit, temperaturën e mishit dhe përpunimin e tij, si dhe fortësinë e penetrimit të mishit dhe produkteve të tij.

Falë UBT-së dhe ndërkombëtarizimit të madh të saj, marrëveshjeve të shumta me universitete të ndryshme të botës, Rinori dhe studentët e tjerë të UBT-së, po kanë mundësi të përfitojnë nga mundësia unike e studimeve jashtë vendit, duke njohur kultura të reja dhe përvoja të ndryshme.

Përmes UBT-së, studenti i Mekatronikës, Art Nela, do të vazhdojë studimet për një semestër në Gjermani

Rekomandimet e shumta për të studiuar në UBT dhe cilësia e studimeve me programe të larmishme kanë bërë që Art Nela, student i Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës, të zgjedhë UBT-në për rrugëtimin e tij në karrierë, dhe sot ai është përfitues i bursës për shkëmbim studentor në Anhalt University of Applied Sciences – në Gjermani, në kuadër të programit Erasmus+.

Dy vite studimi me profesionistë dhe ekspertë të fushës së mekatronikës e kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë Artin në këtë fushë, si dhe kanë luajtur rol kyç në rritjen e ambicieve të tij për të fituar përvoja të reja dhe kultura të ndryshme.

“UBT më ka ofruar mundësi shumë të mira me kushte jashtëzakonisht të mira infrastrukturore për studentët, kështu duke përfituar njohuri të reja, të cilat janë shumë të nevojshme për profesionin tim, të gjitha këto falë përkrahjes së stafit të UBT-së në të gjitha lëmitë ku unë kam pasur nevojë”, ka thënë studenti i Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në UBT, Art Nela. Ideja për të studiuar një semestër jashtë



vendit Artin i ka pëlqyer shumë, dhe kjo edhe e ka shtyrë atë që të ndërmarrë një hap të tillë. “Unë kam aplikuar për shkëmbim studentor sepse më ka pëlqyer ideja që për një semestër të studioj jashtë vendit, të bëj krahasimin e studimeve, studentëve dhe profesorëve, të marr njohuri të reja, eksperiencat e reja, si dhe njohuritë e mia t'i shkëmbejë me studentët

e tjerë që ndodhen atje”, ka thënë ai.

Shkëmbimet e tilla studentore kontribuojnë në ngritjen profesionale të studentëve, si dhe njohjen e kulturave të reja, ndaj UBT do të vazhdojë të krijojë ura lidhëse dhe bashkëpunimi me universitete dhe institucione arsimore ndërkombëtare.

Studenti i UBT-së, Arxhend Jetullahu, punësohet si asistent në laboratorin e mekatronikës në UBT


Puna profesionale dhe suksesi në studimet akademike kanë bërë që studenti i Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në UBT, Arxhend Jetullahu, të punësohet në UBT, në cilësinë e asistentit në laboratorin e mekatronikës. Paraprakisht, Arxhendi vendosi që të bëhet pjesë e UBT-së duke parë laboratorët e sofistikuar të mekatronikës, profesionistët e kësaj fushe, si dhe teknologjitë më të fundit që posedon institucioni.

“Duke parë trendet e zhvillimit në fusha të ndryshme lidhur me teknologjinë, sikurse në mjekësi, agrikulturë, e shërbime, kuptova se i vetmi drejtim që i përfshin të gjitha këto është mekatronika dhe UBT është insti-

tucioni më i mirë për këtë gjë”, ka thënë ai.

Arxhendi e sheh UBT-në si institucion lider në fushën e edukimit, institucion që i ka dhënë mundësinë që njohuritë e fituara t’i aplikoj në të njëjtin vend ku edhe i ka fituar ato, kështu duke i mundësuar atij që të jap kontribut në përgatitjen e gjenertave të reja të inxhinierëve të mekatronikës.

Shumica e studentëve të këtij drejtimi janë ambientuar lehtësisht në tregun e punës, duke bërë që numri i profesionistëve dhe ekspertëve të këtij drejtimi që janë diplomuar në UBT t’i kontribuojnë Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme.



Studenti i UBT-së, Auron Deva, triumfon në festivalin ndërkombëtar të muzikës për të rinj, në Ohër të Maqedonisë së Veriut



Më të mirët janë në UBT, dhe Auron Deva është një prej tyre që Kosovës i sjellë çmimin kryesor “Grand Prix”.

Studenti i Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhim Digjital dhe Menaxhment në UBT, Auron Deva, suksesshëm ka triumfuar në festivalin ndërkombëtar të muzikës për të rinj, MUSI-CLAND, në Ohër të Maqedonisë së Veriut, duke fituar çmimin kryesor “Grand Prix”.

Në mesin e nëntë shteteve, Kosova është renditur në vendin e parë, falë performancës së studentit të Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhim Digjital dhe Menaxhment në UBT, Auron Deva, kështu duke u bërë artisti i parë në histori nga Kosova që e fiton këtë çmim në këtë festival. Juria ndërkombëtare është përbërë nga shtetet si: Malta, Rumania, Turqia, Anglia dhe Kosova, të cilët vlerësuan lartë

Auronin dhe performancën e tij në edicionin e 21-të të festivalit ndërkombëtar për të rinj, MUSI-CLAND, në Maqedoni të Veriut. Ky festival është një prej tre festivalëve më të mëdha të muzikës në Evropë, dhe ky sukses i studentit të Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhim Digjital dhe Menaxhment në UBT, Auron Deva, padyshim që është një sukses që bën krenar gjithë shtetin e Kosovës.

UBT vjen me modelin e ri CLASSROOM 3.0 të shkollave të mesme profesionale të profilit të mjekësisë



Institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend – UBT ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, me infrastrukturën më moderne dhe profesionistët më të mirë, duke i sjellë në Kosovë praktikantët më të njohura ndërkombëtare të mësimdhënies, për zhvillimin e mësimin të mesëm të lartë. Duke parë nevojën për mësimdhënie të mirëfilltë në arsimin e mesëm të lartë, UBT është në proces të akreditimit të shkollave të mesme profesionale, të cilat do të nxjerrin kuadro profesionale në disa fusha. Fillimisht, UBT ekspertizën e

saj do ta zhvillojë në profilin e shkencave të mjekësisë, për të dhënë kontributin e saj përmes mësimdhënësve profesionistë dhe të dëshmuar në këtë fushë e cila ka shumë rëndësi për shoqërinë kosovare.


Zhvillimi i Poliklinikës së UBT-së, do të jetë mburojë e përkryer e mësimdhënies dhe mësimnxënies në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, duke iu mundësuar atyre praktikën profesionale në këtë poliklinikë, me të gjitha kushtet e nevojshme infrastrukturore.

Studentja e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Dhuratë Mavraj, fiton çmimin “Finalist mention” në garën “Young Architects Competition - YAC”

Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Dhuratë Mavraj, ka fituar çmimin “Finalist Mention” në garën “Young Architects Competitions – YAC”.

Përzgjedhur nga një juri profesionale, ajo ka arritur të futet në mesin e shumë arkitektëve të njohur të rinj, me projektin e saj “Design Lab”, të punuar me shumë përkushtim.

Pjesëmarrja në këtë garë e Dhuratës vjen si rezultat i punës dhe angazhimit të saj, si dhe ndihmës dhe rekomandimeve të profesorëve, që me studimet cilësore në UBT, u kurorëzuan me një rezultat të suksesshëm.



Ajo ka thënë se studimet në UBT kanë qenë mjaft përfituese në aspektin e aftësisë për profesionin që ka zgjedhur për karrierën e saj profesionale, duke vlerësuar

se kjo zgjedhje ka qenë kyçe për hapat e saj në rrugën drejt suksesit, falë punës korrekte dhe profesionale të stafit të UBT-së.


“E veçanta e studimeve në UBT

që më ka shtyrë të punoj çdo herë e më shumë, është fakti se ëndrrat nuk mbeten vetëm ëndrra, ato bëhen realitet, dhe një nga këto ëndrra është mundësia

për të fituar dije dhe për t’i aplikuar aftësitë e fituara në vende të ndryshme të Evropës, ndaj kjo lë të kuptohet se që puna dhe njohuritë e fituara në UBT, vlerësohen dhe konvertohen në sukses”, ka thënë studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Dhuratë Mavraj.

Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT është një prej programeve të shumta të studimit që ka prodhuar ekspertë të mirëfilltë të fushës së arkitekturës, të cilët kanë triumfuar me shumë projekte në arenën ndërkombëtare, në kompeticione të ndryshme.

Studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Shkëlqim Musiqi, punësohet në LAVA



Studimet në UBT hapin shtigje të sigurta drejt universiteteve më të famshme botërore.

Këtë e tregon edhe fakti që studentit të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Shkëlqim Musiqi, i janë hapur dyert për studime të nivelit master në universitetin që ka mbi 40 mijë studentë, e që radhitet ndër më të famshmit në botë "Politecnico di Milano", në Itali.

Pas sukseseve të arritura dhe punës voluminoze, Shkëlqimi ka arritur të punësohet në njërin ndër zyret më të dalluara në Europë LAVA (Laboratory for Visionary Architecture). Ai përgjatë studimeve ka qenë pjesëmarrës edhe në disa kompedicione të arkitekturës në botë si: "SkyHive2020", "Shenzhen Opera House Competition", si dhe ka qenë pjesëmarrës në garën "MiG Prize 2021", nga ku ka treguar rezultate mjaft të mira.

Për rrugëtimin e suksesshëm të tij, Shkëlqimi është mirënjohës për UBT-në, stafin e institucionit, mundësinë dhe kushtet e ofruara, përderisa UBT përmes bashkëpunimeve me mbi 500 universitete partnere vazhdon të kontribuojë në zhvillimin e rrjetit ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, duke mbetur kështu lider i padiskutueshëm në nxjerrjen e profesionistëve të rinj.

Mollza Vishi, studente e UBT-së, fillon punën praktike në televizionin "Liria"

Studimet në UBT hapin shtigje të sigurta drejt universiteteve më të famshme botërore.

Këtë e tregon edhe fakti që studentit të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Shkëlqim Musiqi, i janë hapur dyert për studime të nivelit master në universitetin që ka mbi 40 mijë studentë, e që radhitet ndër më të famshmit në botë "Politecnico di Milano", në Itali.

Pas sukseseve të arritura dhe punës voluminoze, Shkëlqimi ka arritur të punësohet në njërin ndër zyret më të dalluara në Europë LAVA (Laboratory for Visionary Architecture). Ai përgjatë studimeve ka qenë pjesëmarrës edhe në disa kompedicione të arkitekturës në botë si: "SkyHive2020", "Shenzhen Opera House Competition", si dhe ka qenë pjesëmarrës në garën "MiG Prize 2021", nga ku ka treguar rezultate mjaft të mira.



Për rrugëtimin e suksesshëm të tij, Shkëlqimi është mirënjohës për UBT-në, stafin e institucionit, mundësinë dhe kushtet e ofruara, përderisa UBT përmes bashkëpunimeve me mbi 500 universitete parte-

nere vazhdon të kontribuojë në zhvillimin e rrjetit ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, duke mbetur kështu lider i padiskutueshëm në nxjerrjen e profesionistëve të rinj.

Studentja e UBT-së, Dea Preniqi, zhvilloi punën praktike në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës

Studentja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Dea Preniqi, ka zhvilluar punën praktike në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës, nga ku ka marrë praktika shumë të rëndësishme lidhur me mënyrën e funksionimit të kësaj zyre dhe departamenteve në kuadër të saj.

Ajo ka thënë se ka mësuar shumë përgjatë kësaj periudhe, duke marrë më shumë praktika në zyrën e sekretarit të presidentes duke parë nga afër bashkëpunimet mes departa-



menteve dhe zyreve ligjore përbrenda këtij institucioni.

"Në këtë periudhë kam kuptuar

ecurinë mes stafit dhe departamenteve, si dhe më janë prezantuar edhe procedurat rreth

zhvillimit të shtetësisë, dekorative, procesverbaleve, amendamenteve, subvencioneve, e procese të tjera", ka thënë studentja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Dea Preniqi.

Dea ka vlerësuar shumë pjesën e punës praktike si dhe ndërlidhjen që ka bërë UBT me teorinë, teksa vlerëson shumë kontributin e UBT-së në ngritjen e saj profesionale.

"UBT më ka bërë të ndihem jashtëzakonisht e vlerësuar si studente, pasi që aftësitë dhe njohuritë që kam marrë gjatë

studimeve më kanë bërë të jem e përgatitur për të vazhduar me studimet master në rrugëtimin tim akademik", ka thënë studentja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT.

Dea Preniqi nuk është e vetmja studente e UBT-së që zhvillon praktikën profesionale në institucione publike, pasi që edhe shumë studentë të tjerë të UBT-së kanë zhvilluar praktikën në institucione publike që ndërlidhen me fushat përkatëse të studimit.

Lansohet për herë të parë në Kosovë prototipi i nanosatelitit CubeSat

Përbrenda UBT-së sukseset nuk kanë të ndalur, suksese këto që tejkalojnë kufijtë e me vete e marrin edhe imazhin e Kosovës. Ekipi i robotikës i përbërë nga Elta Bajrami, Vlora Saraçi, Riona Krosa, Alba Ratkoceri dhe Mërgita Alija që po përfaqësojnë Kosovën në garën ndërkombëtare të robotikës, FIRST Global Challenge, nën monitorimin e Elita Hajrizit dhe me asistim të mentorëve Ron Kasemi dhe Arxhend Jetullahu kanë lansuar prototipin e nanosatelitit CubeSat, i pari i ndërtuar dhe i lansuar në Kosovë.

CubeSat ka kaluar lartësinë e fluturimit të aeroplanëve komerciale duke kaluar troposferën dhe duke arritur në stratosferë, teksa në përbërje ky lloj i prototipit i cili është i bazuar në Arduino CubeSat ka një mikrokontrollues, aparat fotografik, si dhe sensor mjedisor.



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka përgëzuar ekipin përfaqësues të Kosovës që udhëhiqet nga UBT për këtë sukses, duke thënë se përkrahja

e të rinjve është një nga qëllimet parësore që UBT i ka vënë vetes që nga themelimi.

"UBT do të vazhdojë të ndihmojë të rinjtë e me theks të veçantë

vajzat e Kosovës në arritjen e kompetencave të bazuara në STEM si qëllime të mileniumit, duke e pozicionuar Kosovën në top ranglistat botërore. Deri më

tani kemi bërë implementimin e shumicës së teknologjisë moderne, duke përfshirë robotikën, 3D printing, intelgjencën artificiale, programimin, 5G, realitet virtual, mekatronikë dhe energji e tani jemi të lumtur edhe me suksesin që lidhet me hapësirën dhe satelitët", ka thënë rektori Hajrizi.

CubeSat u hartua dhe ndërtua në laboratorin e mekatronikës në UBT, me asistimin e mentorëve të UBT-së, me ndihmën e pajisjeve më të sofistikuara që posedon ky institucion inovativ. Edhe këtë vit Kosova do të përfaqësohet përmes UBT-së në garën më të madhe të robotikës, FIRST Global Challenge, në një garë me 170 shtete pjesëmarrëse në të cilën Kosova përfaqësohet dhe kërkon triumfin përmes një ekipi inovatorësh të rinj.

Studenti i UBT-së, Erion Mecini do të vazhdojë studimet në Universitetin e Salzburgut



Storjet e suksesit janë kurorëzime të punës së palodhshme që bëhet në UBT në bashkëpunim të ngushtë të profesorëve, studentëve dhe gjithë stafit, dhe kjo e bën UBT-në një institucion modern dhe evropian që është të përkrahje të vazhdueshme të studentëve të saj. Përkrahjen e njëjtë e kishte edhe studenti i Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Erion Mecini, i cili nëpërmjet programit PoSIG, falë UBT-së dhe bashkëpunimeve me universitete partnere, do të vazhdojë studimet e nivelit Master në Universitetin e Salzburgut në Austri. Cilësia e studimeve në UBT, si dhe mundësitë që institucioni i ka dhënë përgjatë gjithë kohës të gjithë studentëve, kanë bindur Erionin që t'i bashkohet një

ekipi të suksesshëm profesionalistësh dhe ekspertësh, që atë e ndihmuan që të zhvillohet ditë pas dite.

“Studimet janë pjesa më e rëndësishme në rrugëtimin tonë dhe duhet të na lënë kujtime të veçanta, e ajo që këto studime i bën të veçanta në UBT janë: cilësia e stafit, ambienti i ngrohtë dhe bashkëpunimi me profesorë, të cilët shquhen si më të mirët në vendin tonë”, ka thënë studenti i Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Erion Mecini.

Për mundësinë e shkëmbimit studentor ai u shpreh shumë i lumtur duke thënë se do të përfitojë shumë gjëra, ndër të tjera edhe kultura të reja dhe këndvështrime të ndryshme.

“Nga shkëmbimi studentor unë

pres të përfitojë zhvillimin e aftësive për të komunikuar në barrierat e shumta gjuhësore në një sërë skenarësh të ndryshëm, si dhe pres të përmirësoj aspekte të tjera kryesore sa i përket të folurit në publik dhe shkrimit akademik, në të njëjtën kohë duke krijuar një rrjet global të kontakteve”, ka thënë ai. Programi PoSIG është një program për nivelin master që mbulon të gjitha fushat e Shkencave Politike, që bashkë me partnerët ndërkombëtarë të UBT-së që vijnë nga Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor po u ofron studentëve një mundësi unike për të vazhduar studimet e tyre jashtë vendit në universitete prestigjioze dhe me emër nga këto vende.

Studentja e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, vazhdon studimet në Anhalt University of Applied Sciences, në Gjermani



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Dafina Thaqi, është duke vazhduar studimet në Anhalt University of Applied Sciences, në Gjermani.

Ajo është duke vazhduar studimet në këtë institucion të shquar akademik, falë marrëveshjeve që ka UBT me uni-

versitete të njohura të botës, përmes programit Erasmus+.

Nga programi Erasmus+ mund të përfitojnë të gjithë studentët e UBT-së, nga ku mund të bëhen pjesë e institucioneve më të shquara të arsimit të lartë, kështu duke marrë përvojë interesante që në të ardhmen do të mund t'i shërbejnë vendit tonë.

Studentja e UBT-së përfituese e bursës për shkëmbim studentor në VHL University of Applied Sciences, në Holandë

Studentja e nivelit master në Fakultetin Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Vesa Zeqiri, është përfituese e bursës për shkëmbim studentor në VHL University of Applied Sciences, në Holandë, në kuadër të programit Erasmus+.

Studimet cilësore, infrastruktura moderne, teknologjia e sofistikuar, trendet e reja të mësimdhënies, si dhe përkushtimi i institucionit ndaj studentëve, kanë bërë që Vesa t'i bashkohet UBT-së, si institucion që do të plotësojë rrugëtimin e saj akademik në karrierën profesionale.

“UBT më ka mundësuar të kem hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin tim intelektual, duke më ofruar shërbime profesionale dhe praktikim adekuat të njohurive që kam konform programit të studimeve, dhe ajo që e bën të veçantë studimin në UBT janë kushtet urbanistike dhe akademike që institucioni posedon, të cilat janë në shërbim të studentëve në çdo kohë”, ka thënë studentja e Fakultetit Shkencat



e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Vesa Zeqiri.

Shkëmbimin studentor ajo e sheh si një eksperiencë të re, eksperiencë e cila do t'i ndihmojë asaj të zhvillohet edhe më shumë dhe të njoh kultura të reja në shtetin e Holandës, përmes programit Erasmus+ dhe bashkëpunimit që ka UBT me universitete të tjera. “Arsyeja që kam aplikuar në shkëmbim studentor është se kam dashur t'a sfidoj vetën me një aventurë të re akademike dhe për këtë arsye

kam zgjedhur VHL University of Applied Sciences në Holandë që të studioj atje për një semestër”, ka thënë ajo. Përmes programit Erasmus+ dhe bashkëpunimeve të shumta që UBT ka me universitete partnere të këtij programi nga Evropa dhe mbarë bota, shumë studentë të UBT-së kanë përfituar bursa për shkëmbim studentor jashtë vendit, e që kanë marrë shumë njohuri dhe përvojë të cilat më pas i kanë sjell në vendin e tyre.

Studentja e UBT-së, Fitore Tahiri, përfituese e bursës për shkëmbim studentor në Waterford Institute of Technology



Waterford Institute of Technology i Irlandës, do të jetë destinacioni i radhës për një semestër i studentes së Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Fitore Tahiri. Ajo ka përfituar bursë për shkëmbim studentor në kuadër të programit Erasmus+, falë bashkëpunimit të UBT-së me institucione të ndryshme të cilat janë partner të programit Erasmus+. Përzgjedhjen e UBT-së si institucion që do të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë e saj në një nivel tjetër ajo thotë se e ka bërë duke u bazuar në atë se çfarë UBT bën për studentët, përkushtimin që

ka për ta, si dhe cilësinë e institucionit. “Pas shqyrtimit të të gjitha opsioneve për të studiuar, për shkak të planprogramit shumë të pasur që ofron UBT, cilësinë dhe përkushtimin që ka për studentët, zgjedha që t'i bashkohem këtij institucioni arsimor”, ka thënë fillimisht studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Fitore Tahiri. Aplikimin për shkëmbim studentor ajo e sheh si një mundësi jo vetëm për të, por për të gjithë studentët që duan të përfitojnë në aspekte të ndryshme të edukimit dhe jetës. “Unë kam aplikuar për shkëmbim

studentor në Waterford Institute of Technology në Irlandë dhe mendoj që kjo është një mundësi shumë e mirë për të njohur kulturën, historinë dhe gjuhën e një vendi tjetër, duke ndarë ide me njerëz nga vende të ndryshme dhe duke bashkëpunuar me ta”, ka thënë ajo.

Fitorja inkurajon të gjithë studentët që të aplikojnë për shkëmbim studentor, pasi që sipas saj kjo është një mundësi shumë e mirë për të përfituar njohuri nga aspekte të tjera të jetës, si dhe një mundësi për të ndjekur ëndrrat e tyre në rrugëtimin profesional në karrierë.

Studentja e UBT-së, Era Graiçevci, përfituese e bursës për shkëmbim studentor në Waterford Institute of Technology



Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Era Graiçevci, është përfituese e radhës e bursës për shkëmbim studentor në Waterford Institute of Technology, në Irlandë, në kuadër të programit Erasmus+.

Studimet cilësore në UBT, infrastruktura moderne dhe faktorë të tjerë që janë kyç dhe jetik për jetën akademike dhe zhvillimin

në karrierë, kanë bindur Erën që të bëhet pjesë e UBT-së.

“Zgjedhja e institucionit të së ardhmes mund të jetë një lloj sfide në vete. Në fillim nuk isha shumë e sigurt se cilin institucion të zgjedh, mirëpo duke hulumtuar mora rekomandime të ndryshme nga familjarët dhe nga rrethi i gjerë për UBT-në, dhe ky institucion ishte vendi ideal për zgjerimin e dijes dhe vazhdimin e studimeve akademike”, ka thënë studentja e UBT-së, Era Graiçevci.

Kurrikula e bazuar në institucionet më të mëdha të botës, e harmonizuar me trendin që po nd-

jekë i gjithë globi, ka sjellur diçka më ndryshe tek studentët, dhe që ka tërhequr vëmendjen edhe të Erës.

“Përveç sistemit të mësimdhënies dhe planprogramit, diçka tjetër që më ka tërhequr vëmendjen në UBT është organizmi i aktiviteteve të shumta në fusha të ndryshme dhe dhënia e mundësive të njëpasnjëshme për të qenë pjesë e kurseve dhe certifikimeve internacionale që e pasurojnë pasqyrën e studentëve”, ka thënë studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Era Graiçevci.

Sipas Erës, diversiteti i met-

odologjive, organizimeve dhe planprogrameve, që shërbejnë edhe si lloj motivimi për studentët në vazhdimin tutje të karrierës së tyre profesionale e akademike i bën studimet më të veçanta në këtë institucion të arsimit të lartë. Studentët që po përfitojnë bursa për shkëmbime studentore po marrin përvoja të ndryshme në aspektin personal dhe profesional, duke u njohur me shoqëri dhe kulturë të re, e ku ndër studentët që do të qëndrojnë për një semestër jashtë vendit, konkretisht në Irlandë, është edhe Era.

Studentja nga Turqia, Enfal Sena Atalay, është duke vazhduar studimet për një semestër në UBT

Studentja e programit Marrëdhënie Ndërkombëtare në Bolu Abant İzzet Baysal University, Enfal Sena Atalay, është duke vazhduar studimet në Fakultetin Shkenca Politike në UBT, në kuadër të programit Erasmus+.

Përzgjedhjen e UBT-së si institucion për të vazhduar studimet për një semestër ajo e ka bërë për faktin se UBT sipas saj është institucion që u ofron shansin studentëve që të jenë udhëheqës, duke iu siguruar një të ardhme premtuese.

“Zgjedhja UBT-në sepse doja të bëhem lidere, doja të jem pjesë e një institucioni të njohur ndërkombëtar sepse doja që të shumëzoja mundësitë e mia përgjatë kohës sa jam në universitet. Aplikimi në këtë institucion të arsimit të lartë është shumë i vlefshëm për mua sepse besoj se do të pasuroj fuqishëm të ardhmen time të studimeve dhe të ardhmen profesionale”, ka thënë Atalay.

Përmes këtij shkëmbimi studentor ajo pret njohuri të reja dhe praktika të njohura ndërkombëtare të cilat janë nga më të ndryshmet në UBT, e që do i



kontribuojnë jashtëzakonisht shumë zhvillimit të saj akademik e profesional në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

“Pres të mësojë gjëra të ndryshme, takime me njerëz të rinj dhe të ndryshëm, kultura të ndryshme, si dhe stile të ndryshme të jetesës. Përderisa do të gjej kohë edhe për argëtim, do të mësojë shumë edhe për nga aspekti i gjuhës dhe kulturës, vizitohet vende dhe qytete të reja, e që me një universitet të suksesshëm në CV-në time do të më bëjë më të kërkuar në tregun e punës”, ka thënë studentja e programit Marrëdhënie Ndërkombëtare në Bolu Abant İzzet Baysal University, En-

fal Sena Atalay.

Enfal, Kosovën e sheh si një vend me një histori të thellë e të rrënjësor, me një pozitë shumë të rëndësishme gjeografike, si dhe një kulturë të ngrohtë e me përvoja në çështje shumë të rëndësishme të politikave rajonale dhe urbane.

Ajo thekson se në Kosovë nuk ndihet e huaj, pasi që njerëzit janë shumë miqësorë, mikpritës dhe të gatshëm në çdo kohë për ndihmë, teksa përderisa është duke studiuar këtu, Enfal potencon se studentët mund të arrijnë të njohin vende të ndryshme të Ballkanit për shkak të pozitës strategjike gjeografike që ka Kosova.

Studenti nga Turqia, Musa Akyüz, po vazhdon studimet për një semestër në UBT

Studenti i programit Inxhinieri Kompjuterike në Bolu Abant İzzet Baysal University, Musa Akyüz, është duke shijuar aventurën semestrale në kuadër të programit Erasmus+, duke vazhduar studimet për një semestër në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT.

Ai zgjodhi që për një semestër të vijoj studimet në UBT, falë eksperiencave të mira që ka krijuar UBT vazhdimisht për studentët, si dhe për mundësitë e shumta që iu ka ofruar për të marrë praktikën më të njohura ndërkombëtare.

“Ndër institucionet që më janë ofruar për të studiuar, UBT është institucioni i arsimit të lartë më prestigjioz, më modern, më i bukur dhe mbi të gjitha më cilësori”, ka thënë fillimisht Akyüz. Kontributin e UBT-së në arritjet e tij akademike dhe jetësore e sheh si të rëndësishëm, marrë parasysh edhe faktin se do të njohë edhe një kulturë të re, në një shtet të vogël por me qytetarë dhe njerëz shumë të shoqërueshëm.



“Përfitimet e mia nga ky shkëmbim studentor, konkretisht nga UBT është mësimi i gjuhës dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës. Për mua, mënyra më e mirë për të mësuar është zgjedhja e problemeve që do të na vijnë në jetën e zhvilluar jashtë vendit, duke përdorur një gjuhë të huaj”, ka thënë studentin i programit Inxhinieri Kompjuterike në Bolu Abant İzzet Baysal University, Musa Akyüz. Musa i rekomandon të gjithë të rinjtë që të bëhen pjesë e shkëmbimeve studentore përmes programit Erasmus+, program i cili sipas tij do ua ndryshojë jetën e tyre.

Studenti i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Enes Shala punësohet në UBT

Ëndrra e fëmijërisë për të ndjekur studimet në fushën e shkencave kompjuterike përveç se iu bë realitet, studentit të UBT-së, Enes Shala iu shpërblje edhe me punësim në institucionin më të madh akademik në vend – UBT.

Studenti i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Enes Shala, ka arritur që falë angazhimit dhe studimeve cilësore në UBT, t'i bashkohet një ekipi të profesionistëve të suksesshëm të cilët janë pjesë e këtij institucioni akademik, në cilësinë e zyrtarit të IT-së në qendrën e UBT-së në Ferizaj.



“Kam përzgjedhur UBT-në si opionin më të mirë, më kredibil dhe më serioz në mësimdhënie, për të arritur profesionalizmin

dhe pikësynimin tim kryesor në këtë fushë, si dhe për kushtet më moderne që ky institucion akademik më ka ofruar për

t'u zhvilluar në mënyrë profesionale për rrugën time drejt suksesit”, ka thënë studentin i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Enes Shala.

Enesi, si student i vitit të tretë në nivelin bachelor në programin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ka thënë se ndihet me fat që është pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë, me kuadro profesionale dhe kolegë të cilët ligjëratat dhe ushtrimet i bëjnë gjithnjë e më shumë atraktive.

“Atraktiviteti në ligjëratat dhe përdorimi i teknologjive të fun-

dit për zhvillimin e ligjëratave, stafi profesional dhe shumë i përkushtuar, si dhe ambienti super i përshtatshëm për mësim, na bën të ndihemi me fat që jemi pjesë e UBT-së”, ka thënë ai.

Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, është programi më i madh i kësaj fushe në vend dhe rajon, i cili procesin mësimor dhe kërkimet shkencore i zhvillon duke u bazuar në infrastrukturën më moderne dhe laboratorët më të sofistikuar të teknologjisë informative në UBT.

Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Greta Ahma bëhet pjesë e stafit të UBT-së

Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Greta Ahma, pas studimeve të suksesshme në UBT është bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në cilësinë e asistentes.

Studimet e mirëfillta, cilësia e institucionit, infrastruktura moderne dhe elemente të tjera me karakter zhvillimin e studentëve në karrierë, kanë bërë që Greta të bindet dhe të bëhet pjesë e UBT-së.

“UBT është i njohur si institucioni më i madh dhe më i avancuar në regjion dhe më



gjerë, dhe duke u informuar nga gjeneratat e tjera kuptova që UBT do të jetë rruga ime e suksesit”, ka thënë studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Greta Ahma.

Programi i pasur i bazuar në institucione të mëdha të arsimit të lartë në Evropë dhe më gjerë, si dhe profesionistët më të mirë të vendit në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, e kanë ndihmuar Gretën që të arrijë maksimumin e potencialit të saj në këtë drejtim.

“UBT më ka ndihmuar të zhvillohem si individualisht ashtu edhe profesionalisht që të jem e gatshme për tregun e punës, si dhe për zhvillimin tim të mëtutjeshëm në karrierë”, ka thënë ajo.

UBT ka zhvilluar shkollën më të madhe të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Kosovë dhe rajon, bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare, duke iu ofruar studentëve diplomë të njohur ndërkombëtarisht.

Studenti i UBT-së, Resmi Berisha është punësuar në Qendrën e Vaksinimit për COVID-19 në Prizren

Studenti i Fakultetit të Infermierisë në UBT, Resmi Berisha, pas përkushtimit dhe angazhimit të tij në studimet profesionale në UBT, është punësuar në Qendrën e Vaksinimit për COVID-19 në Prizren.

Përzgjedhjen e UBT-së, si institucion ideal për studimet akademike në fushën e Infermierisë dhe Shkencave Mjekësore, Resmii e ka bërë duke u bazuar në cilësinë e institucionit dhe mundësitë që ky institucion i arsimit të lartë iu ka ofruar studentëve. “UBT është institucion shumë i mirë në shumë aspekte, dhe


aftësia për të bërë gjëra të mira dhe të duhura më ka shtyrë për të zgjedhur këtë institucion arsimor, i cili më ka ofruar dije nga profesionistët më të mirë të UBT-së”, ka thënë studentin e Fakultetit të Infermierisë në UBT, Resmi Berisha.

Praktikat e mira të mësimt, kurrikula moderne, bashkëpunimet e shumta ndërkombëtare, si dhe shumë elemente të tjera që ndërlihen me teknologjinë, inovacionin, shkencën dhe studimet e mirëfillta i kanë dhënë mjaftueshëm kurajo atij për të vazhduar një rrugëtim shumë të rëndësishëm në

karrierën e tij profesionale.

“UBT më mundësoi të kem njohuri të shumta, si dhe mundësi të tjera ndër të cilat ishte edhe qasja në bibliotekën e UBT-së, duke më lehtësuar shkollimin brenda dhe jashtë vendit”, ka thënë studentin e Fakultetit të Infermierisë në UBT, Resmi Berisha.

Fakulteti i Infermierisë në UBT, studentëve të saj u ofron një qasje multidisiplinare të bazuar në teori dhe praktikë, si dhe në kurrikulat më moderne të universiteteve më prestigjioze të botës.



Studenti i UBT-së, Resmi Berisha është punësuar në Qendrën e Vaksinimit për COVID-19 në Prizren

Studenti i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Egzon Avdyli, pas angazhimit dhe studimeve të suksesshme me profesionistët më të mirë të kësaj fushe është punësuar në UBT, në cilësinë e zyrtarit të IT-së në qendrën e UBT-së në Ferizaj. Programi i larmishëm me një kurrikulë moderne dhe me një cilësi të lartë, i bazuar në universitetet më prestigjioze evropiane, kanë bindur Egzonin që të bëhet pjesë e UBT-së dhe të vazhdoj rrugëtimin e tij akademik dhe profesional në fushën e shkencave kompjuterike.

“Kam vendosur të studioj në UBT duke marrë parasysh programin dhe kurrikulën që e ofron kjo fushë studimi, si dhe duke mos harruar

kuadrin profesional të ekspertëve të kësaj fushe që kanë bërë dhe po bëjnë një punë të shkëlqyer për gjeneratat e reja”, ka thënë studentin e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Egzon Avdyli.

Egzoni, punësimin në UBT e sheh si një mundësi shtesë që UBT i ka dhënë krahas studimeve cilësore me kushtet moderne infrastrukturore, që tashmë do të ketë mundësi t'i shndërrojë ato në praktikë, në profesionin që ai gjithmonë ka dashur ta ndjekë si rrugë të zhvillimit në karrierë.

“UBT më ka ofruar shumë mundësi, duke më hapur dyert për t'u bërë një nga studentët e suksesshëm të këtij institucioni, e që do të kontribuojë shumë në zhvillimin



tim në karrierë”, ka thënë ai.

Egzon Avdyli nuk është i vetmi student i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri

në UBT që menjëherë është punësuar dhe po korr suksese, pasi që shumë studentë të tjerë të këtij fakulteti dhe fushave të tjera kanë arritur

që të ambientohen në tregun e punës, si rezultat i punës dhe angazhimit të ndërsjelltë mes profesorëve dhe studentëve.

Ish-studentja e UBT-së, Blinera Zekaj, i bashkohet ekipit të profesionistëve të suksesshëm të programit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri



Ish-studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Blinera Zekaj, rrugëtimin e saj në karrierën akademike e ka filluar më së miri, duke u punësuar si asistente në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, në institucionin më të madh të arsimit të lartë në vend – UBT.

Besimin se UBT është zgjidhja e duhur për të e ka fituar bazuar në cilësinë e institucionit dhe kuadrot profesionale që vazhdimisht UBT i ka nxjerrë ndër vite, duke e bindur Blinerën që t'i bashkohet një ekipi profesionistësh të suksesshëm në UBT. “Duke marrë parasysh emrin e UBT-së jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj, cilësinë dhe kuadrot që ka nxjerrë ndër vite, kam besuar që ky institucion është vendi ku do të gjej gërshetimin mes profesionalizmit dhe suksessit, duke më mundësuar një karrierë që do ta mbajë në mendjen time përherë”, ka

thënë fillimisht Blinera.

Tutje, ajo vlerëson shumë programin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe kurrikulën moderne, e cila sipas saj studentëve ua lehtëson studimet akademike në këtë program studimi.

“Programi Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT është program unik dhe sfidues, që gjithmonë të dhuron një dinamikë pozitive drejt mësimëve më të mira të kësaj fushe përmes profesionistëve më të mirë që ka UBT. Mbi të gjitha, ky program studimi më ka zhvilluar tej mase në rrugëtimin tim akademik, falë një kurrikule moderne dhe të dalluar në aspekte të ndryshme që ngjason me universitetet më të njohura evropiane”, ka theksuar ish-studentja e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Blinera Zekaj.

Blinera ka thënë se ndihet e lumtur që është pjesë e një institucioni të madh akade-

mik siç është UBT, institucion që sipas saj e dallon shkenca, teknologjia dhe inovacioni.

“Studimet në UBT definitivisht i bën teknologjia e sofistikuar, gjithnjë e më shumë inovative, si dhe vizioni i qartë i institucionit për të nxjerrë kuadro të reja profesionale, të cilët kurrë gjatë jetës së tyre nuk do të ndeshen me probleme të natyrës madhore, pasi që më parë UBT i ka testuar dhe përgatitur të gjithë studentët një nga një për tregun e punës dhe për atë se çfarë i pret në të ardhmen”, ka thënë ajo.

Interesimi i vajzave dhe studenteve për teknologjinë dhe inovacionin çdo ditë e më shumë është në rritje e sipër, dhe Blinera është njëra prej shumë vajzave që kanë zgjedhur për të studiuar në fushën e teknologjisë, dhe suksesshëm po arrijnë të ndërtojnë karrierë në sektorin e ICT-së.

Studentja e UBT-së, Mirela Mustafa, angazhohet në projektet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë si dhe në QKMF në Prizren

Ish-studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Blinera Zekaj, rrugëtimin e saj në karrierën akademike e ka filluar më së miri, duke u punësuar si asistente në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, në institucionin më të madh të arsimit të lartë në vend – UBT.

Besimin se UBT është zgjidhja e duhur për të e ka fituar bazuar në cilësinë e institucionit dhe kuadrot profesionale që vazhdimisht UBT i ka nxjerrë ndër vite, duke e bindur Blinerën që t'i bashkohet një ekipi profesionistësh të suksesshëm në UBT. “Duke marrë parasysh emrin e UBT-së jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj, cilësinë dhe kuadrot që ka nxjerrë ndër vite, kam besuar që ky institucion është vendi ku do të gjej gërshetimin mes profesionalizmit dhe suksessit, duke më mundësuar një karrierë që do ta mbajë në mendjen time përherë”, ka

Tutje, ajo vlerëson shumë programin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe kurrikulën moderne, e cila sipas saj studentëve ua lehtëson studimet akademike në këtë program studimi.

“Programi Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT është program unik dhe sfidues, që gjithmonë të dhuron një dinamikë pozitive drejt mësimëve më të mira të kësaj fushe përmes profesionistëve më të mirë që ka UBT. Mbi të gjitha, ky program studimi më ka zhvilluar tej mase në rrugëtimin tim akademik, falë një kurrikule moderne dhe të dalluar në aspekte të ndryshme që ngjason me universitetet më të njohura evropiane”, ka theksuar ish-studentja e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Blinera Zekaj.

Blinera ka thënë se ndihet e lumtur që është pjesë e një institucioni të madh akademik siç është UBT, institucion që sipas saj e dallon shkenca,



teknologjia dhe inovacioni. “Studimet në UBT definitivisht i bën teknologjia e sofistikuar, gjithnjë e më shumë inovative, si dhe vizioni i qartë i institucionit për të nxjerrë kuadro të reja profesionale, të cilët kurrë gjatë jetës së tyre nuk do të ndeshen me

probleme të natyrës madhore, pasi që më parë UBT i ka testuar dhe përgatitur të gjithë studentët një nga një për tregun e punës dhe për atë se çfarë i pret në të ardhmen”, ka thënë ajo.

Interesimi i vajzave dhe studenteve për teknologjinë

dhe inovacionin çdo ditë e më shumë është në rritje e sipër, dhe Blinera është njëra prej shumë vajzave që kanë zgjedhur për të studiuar në fushën e teknologjisë, dhe suksesshëm po arrijnë të ndërtojnë karrierë në sektorin e ICT-së.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me İstanbul Ticaret Üniversitesi

UBT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me İstanbul Ticaret Üniversitesi, e cila parasheh shkëmbim të përvajave, të stafit akademik, studentëve si dhe programe të përbashkëta studimi.

Marrëveshja është nënshkruar në Stamboll nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe rektori i İstanbul Ticaret Üniversitesi, prof.dr. Yücel Uğurlu.

Fushat specifike të bashkëpunimit ndërmjet dy universiteteve përfshijnë, aktivitete të përbashkëta kërkimore, ligjërata të për-



bashkëta përmes e-learning, shkëmbim të stafit akademik, të studentëve, pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike, shkëmbim të materia-

leve të publikuara akademike dhe informacioneve të tjera. İstanbul Ticaret Üniversitesi (Universiteti Tregtar i Stambollit) është themeluar në

vitin 2001 nga Fondacioni i Edukimit dhe Shërbimeve Sociale të Dhomës së Tregtisë së Stambollit me gjashtë fakultete: Shkenca Humane

dhe Sociale, Biznes, Drejtësi, Komunikim, Inxhinieri, Arkitekturë dhe Dizajn, me synim për të lidhur akademinë me komunitetin e biznesit.

“UBT po hap çdo ditë nga një dritare të re bashkëpunimi, duke krijuar aleanca të reja ndërmjet Kosovës dhe vendeve të ndryshme të botës në fushën e shkencës dhe dijes”, ka thënë rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Rektori Hajrizi pret që nga ky bashkëpunim të përfitojnë përvoja e njohuri të reja stafi dhe studentët respektiv.

UBT bashkëpunim me YTÜ Technopark, qendrën më të madhe teknologjike në Stamboll



Në kuadër të vizitës në Turqi, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, vizitoi edhe parkun e zhvillimit teknologjik – YTÜ Technopark, ku u prit nga kryetari i Bordit Dre-

jtues, prof.dr. Bahri Şahin. Në rrugën e modelit universitar sipërmarrës të shekullit të 21-të, Yıldız Technical University, në vitin 2003, themeloi parkun e zhvillimit teknolog-

jik – YTÜ Technopark, me vizionin për t'u bërë një qendër ndërkombëtare e bashkëpunimi ku idetë e reja shndërrohen në rezultate inovative. Rektori Hajrizi dhe prof.dr. Bahri Şahin ranë dakord për bashkëpunim ndërmjet YTÜ Technopark në Stamboll dhe Parkut Shkencor Inovativ të UBT-së në fushën e start-up, bashkëpunimit të përbashkët me industrinë, si dhe sjelljen e investimeve të huaja në parqet respektive. YTÜ Technopark ka një hapësirë prej 148.000 m², brenda të cilit janë akomoduar 330 kompani kërkimi dhe

zhvillimi, 111 inkubatorë biznesi me më shumë se 8,000 punonjës të kualifikuar në fushën e kërkimit dhe zhvillimit si; softuer, teknologji informacioni dhe komunikimi, telekomunikacion, elektronikë, farmaceutikë, makineri dhe pajisje, hapësirë ajrore, energji, mbrojtje, ndërtim, ushqim, etj. Parku Shkencor Inovativ i UBT-së, po ashtu është i pajisur me teknologjinë e së ardhmes, Qendrën e Teknologjisë 5G, Qendrën e Realitetit Virtual “EON Reality, Augmented and Virtual Center”, mbi 150 laboratorë të ndryshëm shkencor e kërkimi

mor, inkubatorin e biznesit, qendrën e start-up, atë të inovacionit, transferit teknologjik si dhe qendrat e tjera për një mbështetje moderne të ndërmarrësisë, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Në parkun e UBT-së, gjithashtu janë të vendosura rreth 100 Spin-offs të fushave të ndryshme të jetës, duke qenë kështu parku i vetëm i këtij lloji në rajonin tonë.

Të dyja këto parqe teknologjike janë anëtare të asocionit ndërkombëtar për parqe shkencore dhe teknologjike – IASP

Thellohet bashkëpunimi mes UBT-së dhe Riga Technical University

Bashkëpunimi i shkëlqyeshëm mes UBT-së dhe Riga Technical University, në Letoni, përkrahë Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastruktural në UBT, ka bërë që përfaqësuesit e Fakultetit të Ndërtimit të këtij institucioni të vizitojnë UBT-në.

Eriks Badamsins nga zyra ndërkombëtare, Leine Maurice nga Fakulteti i Ndërtimit të Riga Technical University, si dhe Inese Dzarcane nga siguria kibernetike e këtij universiteti, janë pritur nga rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe përgjegjësjë e zyrës ndërkombëtare Lirigzona Morina.

Rektori Hajrizi ka njoftuar përfaqësuesit e Riga Technical University me të arriturat e UBT-së dhe planet e së ardhmes, duke vënë theksin te bashkëpunimet ndërkombëtare me universitete prestigjioze si pikë kyçe të zhvillimit të përbashkët.

Përfaqësuesit e Riga Technical University u takuan edhe me drejtorin për Çështje Akademike në UBT, prof.dr. Muhamet



Ahmeti, prodekanin e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktural në UBT, prof.dr. Visar Krelani, përfaqësuesen e Zyrës Ndërkombëtare në UBT, Erëza Mehmeti, si dhe dekanin e Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në UBT, dr. Bertan Karahoda.

Nga kjo vizitë, përfaqësuesit e të dyja palëve u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin dhe organizimin e Akademisë Ndërkombëtare Verore, mes UBT-së, Riga Technical University dhe Universitetit të Bergamos, mentorimin e përbash-

kët të temave të diplomave të nivelit master, mundësi për doktoratë për stafin e UBT-së, si dhe planifikim për specializim në nivelin master për sigurinë dhe shëndetin në punë, çështje që Kosova vazhdon të ketë nevojë që UBT mund të jap një kontribut mjaft të madh për Kosovën në këtë aspekt.

Kujtojmë se shumë studentë të UBT-së kanë vazhduar dhe janë duke vazhduar studimet për një semestër në Riga Technical University të Letonisë, në kuadër të programi Erasmus+.

Rektori Hajrizi nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me “Yıldız Technical University” në Stamboll

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, gjatë vizitës zyrtare në Turqi, ka arritur disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete të njohura atje. Në ditën e parë të kësaj vizite, rektori Hajrizi u prit në takim nga rektori i “Yıldız Technical University”, me seli në Stamboll, prof.dr. Tamer Yılmaz. Rektori Hajrizi në emër të UBT-së dhe rektori Yılmaz nga “Yıldız Technical University” pas takimit të frytshëm nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në mes të këtyre dy institucioneve, e cila parasheh inkurajimin e kontaktit dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet stafit akademik e shkencor si dhe ndërmjet studentëve. Të dy institucionet do të përqipen të bashkëpunojnë në arsim dhe kërkim në fusha me interes të përbashkët.

Marrëveshja përveç hulumtimeve të përbashkëta parasheh edhe shkëmbim të studentëve, të stafit akademik e shkencor, ligjërata të

përbashkëta përmes e-learning, pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike, shkëmbim të materialeve të publikuara akademike dhe informacioneve të tjera. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi e vlerësoi lartë arritjen e kësaj marrëveshjeje, me një prej universiteteve më të vlerësuara në botë. “UBT po krijon çdo ditë e më shumë aleat të fortë të dijes e shkencës kudo nëpër botë. Në këtë kuadër është edhe marrëveshja e nënshkruar sot me ‘Yıldız Technical University’ një ndër universitetet më të mira në botë”, u shpreh rektori Hajrizi, i cili do të qëndrojë për disa ditë në Turqi, ku do të ketë takime të rëndësishme me institucionet akademike e shkencore atje. Yıldız Technical University është renditur në mesin e 100 universiteteve më të mira në botë. Në 26 lëndë mësimore ky universitet është renditur krye të universiteteve më të mira botërore.

UBT dhe Bashkia e Korçës nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e Qendrës Inovacionit dhe Teknologjisë në Korçë

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, bashkë me kryetarin e Bashkisë së Korçës, Sotirajq Filo, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e Hubit më të madh të teknologjisë dhe inovacionit që së shpejti do të hapet në qytetin e Korçës. Njoftimin për këtë marrëveshje bashkëpunimi e ka bërë të ditur kryetari i kësaj bashkie, Sotirajq Filo, ku theksoi se kjo marrëveshje do të sjell teknologji e inovacion për të rinjtë e Korçës.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi është shprehur i lumtur me këtë marrëveshje të arritur, duke thënë se ky

bashkëpunim me Bashkinë e Korçës do të jetë rol model për inovacion për të gjithë të rinjtë e Korçës, si dhe do të jetë një ambient inovativ me teknologjinë më të avancuar të kohës. Me këtë projekt madhor, UBT, me ekspertët e angazhuar, do të ofrojë mbështetje akademike dhe do të ketë rol kyç në hartimin e trajnimeve profesionale në gjuhën programuese. UBT përmes kësaj marrëveshjeje, të rinjëve korçarë do u ofrojë një Qendër Inovative, që do të jetë ambient i atillë që studentëve dhe të rinjëve do t'u sjellë vetëm zhvillim e prosperitet.



UBT zgjeron bashkëpunimin në Kroaci, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me "Zagreb School of Economics and Management"



Nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me "Zagreb School of Economics and Management", marrëveshje kjo që synon promovimin e mirëkuptimit ndërkombëtar, bashkëpunimit shkencor, ndërveprimin kulturor dhe ruajtjen e kultivimit të miqësisë mes Kosovës dhe Kroacisë duke

mbështetur aktivitetet arsimore. Me këtë marrëveshje fakultetet dhe studentët e të dy institucioneve do të kenë mundësi të shkëmbimit të përvojave dhe ideve me njëri-tjetrin, duke zhvilluar aktivitete të përbashkëta kërkimore, si dhe pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike.

Ky bashkëpunim parasheh edhe shkëmbimin e stafit akademik nga të dy institucionet arsimore, me që rast do të kontribuojë jashtëzakonisht shumë në zhvillimin e kërkimeve shkencore, si dhe shkëmbimin e materialit akademik dhe informacioneve të tjera mes tyre.

UBT partnerë me shumë kompani dhe universitete prestigjioze ndërkombëtare në projektin "Work-Life-Flow"

UBT i është bashkuar nënismës së Universitetit të Barcelonës në projektin "Work-Life-Flow", kështu duke shtuar listën e partneriteteve të shumta që UBT si institucion i arsimit të lartë ka me shumë universitete prestigjioze ndërkombëtare. Synimi i këtij projekti është që të nxisë një rrjedhë pozitive të punës dhe jetës në periudhën pas COVID-19 duke iu referuar ekuilibrit dinamik midis roleve profesionale dhe sociale të një individi, duke i dhënë shtysë zotërimit të një rrjedhe të shëndetshme pune dhe jetese, në mënyrë që të ketë një performancë efektive të punës. Ky projekt do të zbatohet

nga katër partnerë të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe tre partnerë biznesi, të cilët kanë ekspertizë, njohuri dhe përvojë në fushat përkatëse. Projekti "Work-Life-Flow" është projekt i financuar nga Komisioni Evropian dhe në këtë projekt marrin pjesë shumë universitete dhe kompani prestigjioze si: Universitat de Barcelona (Spanjë), Universidade de Coimbra (Portugali), IBK Management Solutions (Gjermani), Waterford Institute of Technology (Irlandë), Irish Work Study Institute Ltd (Irlandë), dhe Eskilara S. Koop Txikia (Spanjë).

UBT dhe AKK nënshkruajnë marrëveshje mirëkuptimi për rritjen e numrit të ekspertëve të konkurrencës

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka pritur në takim kryetarin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi me të cilin ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi.

Përmes këtij memorandum synohet bashkëpunimi për zhvillimin e moduleve dhe programeve të ndryshme të studimit, konkretisht përfshirja e një lënde në fushën e politikave të konkurrencës. Ky memorandum parasheh organizimin e veprimtarive shkencore dhe profesionale si: simpoziume, konferenca, seminare, tryeza, shkolla verore, trajnime, etj.

Rektori i UBT-së prof.dr. Ed-

mond Hajrizi ka thënë se kjo marrëveshje është e rëndësishme për institucionin, për faktin se do të jetë në shërbim të studentëve, për të shkëmbyer përvoja dhe praktika më të mira me stafin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është promovimi i përpjekjeve të përbashkëta që ka UBT me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok, në zhvillimin e programeve të ndryshme të studimit, si dhe rritja e numrit të ekspertëve në fushën e politikave të konkurrencës.

UBT lidh memorandum bashkëpunimi me kompaninë "Krapu Com SHPK"

UBT në kuadër të Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë e ndërtimit "Krapu Com SHPK". Kjo marrëveshje vjen në vazhdim të bashkëpunimeve që Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura ka me kompani të ndryshme.

Marrëveshja u nënshkrua nga dekani i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastruktura dhe njëherit, drejtorit për çështje akademike, prof. dr. Muhamet Ahmeti dhe Inxh. Msc. Jeton Zogaj, në prezencë të prodekanit, prof. dr. Visar Krelani.

Me këtë marrëveshje studentët e UBT-së do të kenë mundësi të kryejnë punën



praktike në kompaninë "Krapu Com SHPK", teksa kompania do të ketë në dispozicion përmes UBT-së programet dhe trajnimet të cilat do ndihmojnë në avancimin e stafit të kësaj kompanie.

Këtë partneritet UBT e konsideron shumë të rëndësishëm, marrë parasysh faktin se me këtë bashkëpunim do të mundësohet shkëmbimi i përvojave nga të dyja palët në lëmin e ndërtimitarisë.

UBT dhe komuna e Vitisë hartojnë planin e ri zhvillimor komunal

UBT, në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, konkretisht Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, kanë mbajtur një takim publik me qytetarë të Komunës së Vitisë lidhur me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029.

Në këtë takim u bë prezantimi i profilit të gjendjes ekzistuese dhe analiza e kësaj gjendjeje, teksa Drejtori për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ajet Salahu, theksoi se Komuna e Vitisë bashkë me UBT-në po hartojnë planin e ri zhvillimor për 8 vitet e ardhshme.

Prof.dr. Hazer Dana, ndër të tjera ka folur rreth punës së përbashkët mes UBT-së dhe Komunës së Vitisë në hartimin e këtij dokumenti që është shumë i rëndësishëm



për qytetarët, teksa prezantimin e gjendjes ekzistuese dhe analizës e saj e ka bërë profesora Lyra Bakia.

Nënkryetari i Komunës së Vitisë, Hasan Aliu, ka thënë se ky plan zhvillimor është jetik për Komunën e Vitisë dhe qytetarët e saj. Ai ka thënë se përmes këtij takimi, qytetarët jo vetëm se do të njihen me

gjendjen ekzistuese por edhe mund të japin sugjerime lidhur me këtë plan zhvillimor përpara se të përfshihet dokumenti final.

UBT vazhdon që t'iu qëndrojë afër të gjitha komunave të Kosovës, duke iu ofruar ndihmën e nevojshme që secila komunë ka, përmes aseteve dhe teknologjive më të reja të cilat UBT posedon.

UBT dhe Komuna e Suharekës nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, në emër të institucioneve që drejtojnë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Aplikacioni online për leje ndërtimore në Komunën e Suharekës".

Përmes kësaj marrëveshjeje UBT do t'i ofrojë në shfrytëzim Komunës së Suharekës aplikacionin që e ka zhvilluar lidhur me aplikimin online për

leje ndërtimore.

Me këtë rast, rektori Hajrizi ka thënë se kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme për faktin se qytetet tani janë duke hyrë në një fazë tjetër të digjitalizimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Të dyja palët u pajtuan për të thelluar bashkëpunimin e tyre në fusha të ndryshme, kështu duke planifikuar që në të ardhmen të zhvillojnë edhe projekte të tjera të përbashkëta.

UBT dhe Komuna e Gjilanit nënshkruajnë marrëveshje për krijimin e platformës "Smart City" dhe aplikacionit online për leje ndërtimore

Komunave të Kosovës që kanë lidhur bashkëpunim me UBT-në për krijimin e platformës Smart City dhe aplikacionit online për leje ndërtimore i është shtuar edhe Komuna e Gjilanit. Rektori i UBT-së, Prof.Dr. Edmond Hajrizi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për implementimin e projekteve për platformën dhe aplikacionin që synojnë ta orientojnë Gjilanin drejt konceptit të zhvillimit të mençur dhe të qëndrueshëm.



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka mirëpritur nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, duke thënë se me këtë bashkëpunim qyteti

i Gjilanit do të përfitojë një strategji dhe qasje inovative ndaj problemeve lokale. "Këto marrëveshje do të kontribuojnë shumë në qasjen

dhe strategjinë që do ta ketë qyteti i Gjilanit në të ardhmen ndaj problemeve lokale dhe mënyrën se si do të duhet zgjidhur ato", ka thënë rektori Hajrizi.

Së bashku me kryetarin e Komunës së Gjilanit, ata kanë diskutuar rreth zhvillimit të mençur dhe të qëndrueshëm hapësinor, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor. Projektet synojnë që të përgatisin dhe komunikojnë strategji gjithëpërfshirëse të qyteteve të mençura, të cilat do t'u sigurojnë qyteteve të

Kosovës qasje inovative ndaj problemeve të komunitetit, si dhe do të ndihmojnë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban.

Ndërsa kryetari Haziri ka shprehur përkrahjen e tij të plotë për konkretizimin e këtyre dy projekteve si dhe ka theksuar nevojën dhe gatishmërinë e komunës për bashkëpunime tjera konkrete me UBT-në. Të dy projektet UBT do t'i realizojë përmes Institutit për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor.

UBT ofron gjithë ekspertizën e saj për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan, pas situatës së krijuar me helmimet e qytetarëve në komunën e Deçanit, nga ku është pritur nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Deçanit, Musa Berisha, të cilit i është dorëzuar një kontingjent me medikamente, me qëllim ndihmesën në trajtimin e pacientëve të prekur.

Rektori Hajrizi shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në çfarëdo mënyre Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan, edhe duke ofruar në dispozicion stafin mjekësor dhe ekspertët e shkencave mjekësore të Poliklinikës së UBT-së, me qëllim menaxhimin sa më të mirë të kësaj situatë.

"Si institucion jemi të shqetësuar me gjendjen e krijuar këtu në Komunën e Deçanit, në të njëjtën kohë qytetarëve

të prekur u urojmë shërim të shpejtë. Më e mira që mund të bëjmë si institucion është të ofrojmë ekspertizën e stafit mjekësor të Poliklinikës së UBT-së, për t'iu dalë në ndihmë mjekëve të kësaj qendre në çfarëdo forme që kanë nevojë ata", ka thënë rektori Hajrizi.

Fillimisht, rektori Hajrizi ka kontaktuar drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan, Selmon Berisha, nga i cili është informuar për gjendjen faktike pas situatës së krijuar, kështu duke i identifikuar nevojat që kanë qytetarët që po trajtohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan. UBT vazhdimisht iu ka dalë në ndihmë dhe është solidarizuar me raste të tilla si kjo, pasi që UBT vlerëson se kontributi për komunitetin përmes formave të ndryshme është mëse i nevojshëm.

UBT lidh memorandum bashkëpunimi me Odën e Afarizmit të Kosovës

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, në emër të dy institucioneve kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim të lidhjes së bashkëpunimit, nga i cili mund të përfitojnë shumë studentë të UBT-së.

Ky memorandum i bashkëpunimit parashihet të ketë si rrjedhojë shkëmbimin e përvojave dhe sigurimit të një qasje sistematike ndaj problemeve të identifikuar gjatë punës së përbashkët, aktivitete të përbashkëta për të bërë ndikim në politikë-bërje dhe vendimmarrje që ndërlihet me qëllimet kryesore të të dyja palëve, e gjithashtu edhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në mes tyre për promovim dhe përkrahje në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social.

Rektori Edmond Hajrizi, përgëzoi OAK-në për an-

gazhimin e saj dhe vlerësoi këtë bashkëpunim me qëllim të krijimit të partneritetit në mes bizneseve, studentëve dhe teknologjisë.

Sipas Hazirit, bashkëpunimi ndërmjet përfaqësuesve të bizneseve dhe institucioneve arsimore është shumë i nevojshëm, pasi që vetëm kështu mund të arrijmë deri tek ndërlihdja e studentëve me tregun e punës.

Ndërsa, kryetari i Bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi me këtë rast theksoi se OAK është e fokusuar në shërbimet e bizneseve, rrjetëzimin, identifikimin e problemeve të bizneseve të cilat janë të shumta, deri te alternativat e zgjidhjes së tyre.

Ai shtoi që OAK është duke lobuar në vazhdimësi që të bëhet ndërlihdja e kadrove të kualifikuar me nevojat e tregut të punës dhe rëndësinë e përfshirjes së sistemit të arsimit dual në shkollat profesionale.

THANË PËR UBT

Edi Rama - kryeministër i Shqipërisë

"Fakti që jemi këtu sot me këta partnerë të shkëlqyer, si dhe fakti që këtu ka filluar puna, tregon që kjo nuk është një ëndërr, nuk është as një dëshirë, por është një program i nisur. Ne sot këtu me dy partnerë që më të mirë s'kishim ku i gjenim për të filluar, me Bashkinë e Korçës dhe me UBT-në e Prishtinës, jemi absolutisht të bindur që falë edhe një skuadre që janë mbledhur këtu, ne do t'ia dalim që ta transformojmë këtë ëndërr që tanimë po futet në rrugën e realitetit, duke filluar nga disa qendra qarqesh dhe pastaj duke u shtrirë në të gjitha qendrat urbane të Shqipërisë". (Në ceremoninë e hapjes së Qendrës së Inovacionit dhe Teknologjisë "Korça Innovation&Technology Hub")

Dan Lejerskar - presidenti i gjigantit teknologjik "EON REALITY", DanLejerskar

"Një nga shkollat më të mëdha në shtetin më të ri në Evropë, është duke ndryshuar mënyrën se si instruktorët dhe studentët e shohin edukimin në XR gjatë pandemisë". (Shkrim në LinkedIn)

Andre Haynes - eksperti i ekselencës

"UBT është një organizatë shumë impresionuese në të gjitha mënyrat. Çdo organizatë që aplikon për çmim të ekselencës nga EFQM duhet të shikojë modelin e ekselencës dhe duhet të përputhet në të shkruar dhe në të folur me atë që ndodhet në atë model, e UBT ka bërë përpjekje shumë të mira që ta bëjë këtë. Nuk do t'i merrte pesë yje dhe 500+ pikë po të mos tregojë efektivitet në kryerjen e kësaj përgjegjësie. Unë mendoj që UBT është një institucion shumë i këndshëm, mënyra e të mësuarit, mënyra se si profesorët sillen dhe stafi mbështetës, është absolutisht e shkëlqyeshme", theksoi Haynes

Hykmete Bajrami - Ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë

"Nga informacionet që ne si ministri i kemi marrë, jemi informuar që UBT është një nga institucionet e arsimit të lartë, një ndër të parët që në ditët e para pas shpalljes së pandemisë ka filluar aplikimin e arsimit online. Gjithashtu, statistikisht tregojnë për ndjekjen e ligjëratave nga një numër i madh i studentëve të UBT-së në mësim në distancë, dhe ky fakt na gëzon e jemi mirënjohës për të gjithë ata që kanë vepruar njësoj në këtë drejtim". (Në video-konferencën e organizuar nga UBT, me temë: "Rëndësia e edukimit online në kohë pandemie").

Pia Stjernvall, ambasadore e Finlandës në Kosovë

"Jam shumë krenare që po arrini ta jetësoni këtë projekt në një universitet dhe po mundoheni t'i gjeni format më të mira për ta shfrytëzuar rrjetin 5G. Ka shumë gjëra pozitive që mund t'i bëni me 5G. Studentët në universitetin tuaj janë me të vërtetë të privilegjuar sepse ata mund të shohin edhe mundësi të tjera". (Në inaugurimin e rrjetit 5G).

Michael Siegel, drejtor i Shitjeve për Evropën Juglindore në kompaninë Nokia

"UBT" është duke mbështetur të rinjtë dhe të rejtat në ambiciet e tyre për të krijuar një shoqëri të dijes, duke punuar me ndërmarrjet publike dhe private, në mënyrë që të vendoset infrastruktura e nevojshme që mbështet kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin". (Në komunikatën e lëshuar nga "Nokia")

Prof. dr. Karamjit S. Gill, Universiteti Brighton, Britania e Madhe

"UBT është një institucion shumë i suksesshëm dhe i mrekullueshëm me karrierë 15-vjeçare. UBT është një institucion që u ngrit nga fillimi, me kushte të limituara, dhe vazhdoi duke u rritur dhe tani ka arritur të bëhet institucion i rëndësishëm për shoqërinë e Kosovës. Zhvillimet janë reale dhe mund të krahasohen me shoqërinë Kembrixh ose edhe vendeve të tjera të përparura". (Konferenca e pestë ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, 2016)

Prof.dr.Felix Breitenecker, Universiteti Teknik i Vjenës

"UBT-ja vazhdon punën inovative që disa vite radhazi dhe është kënaqësi që marr pjesë në konferencë. Shoh shumë zhvillime pozitive dhe temat janë interesante. Konferenca është me rëndësi ndërkombëtarizimi i UBT-së dhe prezantimet kryesive nga teknologjia informative, por edhe nga mekatronika, ekonomia dhe fusha të tjera të veçanta. Pra, kjo është një zhvillim i suksesshëm i cili ndihmon edhe zhvillimin e industrisë". (Konferenca e pestë ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, 2016)

Peter Groupms, profesor nga Universiteti i Patrasit në Greqi

"Suksesi i UBT-së për 15 vjet, disa universitete s'do ta arrinin as për 50 e 100 vjet. Rektorin Edmond Hajrizi është privilegj i madh që e kam njohur, jam njoftuar me punën e madhe që e ka bërë për UBT-në dhe në përgjithësi për arsimin e lartë në Kosovë. Jo vetëm UBT-ja, por edhe Kosova është me fat që e ka një njeri të tillë. Nga viti 2013 kam parë rritje të numrit të studentëve, paralel me numrin e programeve të studimit. Kjo është shenjë shumë e mirë, që tregon se UBT-ja po rritet, duke krijuar situatë shumë të shëndetshme për një universitet", ka theksuar profesori nga Greqia. (Konferenca e pestë ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, 2016).

Michael Murphy, presidenti i Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EUA)

"Kam kënaqësinë të mirëpres Institucionin e Arsimit të Lartë - UBT, si një anëtar të ri të Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EUA). EUA është rrjeti më i madh dhe më i gjerë i universiteteve evropiane që ofron një forum për të ndarë ekspertizën, për të kontribuar në studime, për të marrë pjesë në ngjarje, si dhe për të ndikuar në vendimet e politikave. Unë pres që të punoj me ju në promovimin e partneriteteve në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në brenda Evropës, dhe unë ju falënderoj që u bashkuat me zërin e universiteteve të Evropës". (Letër dërguar rektorit Hajrizi)


Ekspertët ndërkombëtarë të Fondacionit Evropian për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM)

"Jemi shumë të kënaqur që UBT vazhdon të përdorë modelin EFQM. Ju keni qenë implementues të shkëlqyeshëm për shumë vite të modelit EFQM, dhe jeni në krye të 1-2% të organizatave të të gjithë botës që keni kontribuar në fuqizimin e EFQM si model në 25 vitet e fundit. Kjo është një performancë e jashtëzakonshme". (Letër dërguar nga përfaqësues të Fondacionit Evropian për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM))

SYRI



SYRI



Feride Rushiti, drejtoreshë e Qendrës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës në Kosovë

“Është një ndjenjë e veçantë për faktin se në fushëveprimtarinë time kam marrë edhe mirënjohje tjera ndërkombëtare dhe kanë pasur rëndësinë e vet për ndërkombëtarizimin e çështjes dhe kauzës, në të cilën unë kam punuar ndër vite, por ju kur e merrni një mirënjohje nga një universitet i njohur siç është UBT, mendoj që ka një vlerë të veçantë për mua personalisht, por jo vetëm për mua, por edhe për 33 anëtarë të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, si dhe për qindra gra, vajza dhe burra të cilët e ndajnë rrëfimin e trishtë të luftës në organizatë, aty ku ne mundohemi t’ia zbutim dhimbjet dhe plagët e luftës. Ndihej e nderuar që jam pjesë e vlerësimit të një universiteti kredibil, i cili gjeneron dije, brymosë të rinj, të cilët në të ardhmen do të kenë mundësi t’iu qasen edhe kësaj kategorie”. (Me rastin e ndarjes së çmimit “Excellence Leadership Award”)

Ilir Shaqiri, këngëtar

“Ndihej i nderuar që sot ky libër po përurohet këtu në këtë ambient të mrekullueshëm, në këtë ambient ku shumë studentë po arrijnë të shpërndahen gjithandej, dhe jo vetëm në Kosovë por në të gjitha hapësirat shqiptare dhe të kontribuojnë në fushat përkatëse prej ku marrin gjithë këto mësimë siç është universiteti juaj. Shumë faleminderit që jemi këtu”. (Me rastin e ndarjes së çmimit “Excellence Leadership Award”)

Chad Rogers, diplomat dhe aktivist i shquar kanadez

“Kosova është një vend ku dinjteti dhe vlerat nuk humbin kurrë. Kosovarët nuk harrojnë kurrë ata të cilët i kanë ndihmuar nëpër kohë të vështira dhe kjo është një vlerë e madhe njerëzore. Ju e keni obligim qytetar dhe kombëtar punën për komunitetin tuaj, andaj edukohuni, arsimohuni dhe tregoni humanizëm për njerëzit tuaj”, theksoi ai, teksa dha këshilla për të studentët në aspektin e përfaqësimit sa më dinjitoz të vendit. (Në ceremoninë për nder të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës).

Andreas Dalluege, ekspert i cilësisë

“Tani ndjehem edhe më i obliguar që të ndihmojë UBT-në dhe Kosovën në arritjen e shkallës më të lartë të cilësisë në të gjitha fushat”. (Në ceremoninë për nder të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës).

Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër i Kosovës

“Ne i jemi jashtëzakonisht falënderues UBT-së, rektorit Hajrizi dhe studentëve të UBT-së, të cilët për vite e kanë mbështetur zhvillimin e sektorit të arsimit të lartë në Kosovë”. (Konferenca e ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, 2018).

Felix Bretinexger, profesor në UBT

“Kjo është e pesta herë që jam këtu dhe jam tejet krenar me atë që ka arritur një ish-student i imi, siç është rektori Edmond Hajrizi, por edhe studentët e mi aktualë. Më pëlqen jashtë mase të qëndroj dhe të jap leksione në UBT”.

Caroline Jaeger Klein, profesoreshë në Universitetin Teknik të Vjenës

“Unë tashmë jam presidente e ICOMOS Austria, ndërkohë bashkëpunimi me UBT-në po zgjerohet edhe përmes programeve, siç është Erasmus+. Në këtë mënyrë po mundohemi që ta promovojmë nivelin akademik të Kosovës, por edhe trashëgiminë kulturore të vendit”.

Claire Gordon, profesoreshë në London School of Economics and Political Science

“UBT është në rrugë të drejtë të zhvillimit të punës sepse gjeneratat e reja të studentëve duhet të gjejnë zgjidhje për problemet më komplekse me të cilat po përballet bota për momentin”.

Driton Kuka, selektor i reprezentacionit të xhudos së Kosovës

Ky çmim i ndarë nga UBT për mua, në mesin e shumë mirënjohjeve dhe titujve evropianë, është specifik, sepse po dhurohet nga një tempull i dijes, që gëzon kredibilitet të lartë në vend, por edhe sepse është dhuruar nga njerëz që e vlerësojnë punën e atyre që e meritojnë”.

Prof.dr. Ali Jashari, rektor i Universitetit të Korçës

“Ndjehem i nderuar me këtë çmim, respekti i shprehur ndaj meje do të jetë një shtysë që ta mbaj edhe më të fuqishëm bashkëpunimin me UBT-në dhe Kosovën”. (Në ceremoninë e ndarjes së çmimit “Excellence Leadership Award”).

Reinhard Heinisch, profesor i Shkencave Politike në University of Salzburg

“Ne jemi shumë të impresionuar me atë që keni bërë këtu dhe për rezultatet që keni arritur për 20 vite, ato duken shumë mbresëlënëse, kështu që ju përgëzoj të gjithëve marrë parasysh edhe sfidat tuaja në këtë rrugëtim”. (Në ceremoninë e hapjes së Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion)

Józsa János, ish-rektor i Budapest University of Technology and Economics,

“Më lejoni që t’iu përshëndes me këtë rast, në konferencën e sotme ndërkombëtare, për të festuar përvjetorin e njëzetë të UBT-së, në Prishtinë, Kosovë, Evropë Juglindore, një vend i rëndësishëm në të kaluarën, të tashmen dhe me shpresë edhe në të ardhmen tonë të përbashkët. Faleminderit për ftesën e rektorit Hajrizi, një prej rektorëve më energjik në botë që kam takuar ndonjëherë”. (Në ceremoninë e hapjes së Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion)

Paolo Parisi, ish-rektor i Universitetit të Romës “Foro Italico”

Ishte një kënaqësi e vërtetë për të qenë i ftuar, jo një surprizë, sepse ju keni qenë gjithmonë të sjellshëm me mua, ju njoh prej dy vitesh dhe çdo ditë e më shumë jam i mahnitur dhe i admiruar me energjinë tuaj, siç thanë edhe të tjerët me vizionin tuaj. Mendova, mirë unë kam një karrierë të gjatë mbi 15 vite mësimdhënie në universitete në mbarë botën dhe është e rrallë të gesh dikë që kombinon gjëra të ndryshme që janë përgjithësisht të pranishme herë pas here me të tjerat e që kombinohen me të njëjtin person, pra kjo nuk është edhe aq e shpeshtë. Vizioni, aftësia, hapat praktik për ta realizuar këtë, energjia për ta mbështetur këtë, si dhe fati i mirë, ju i keni të gjitha këto”. (Në ceremoninë e hapjes së Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion)

Shpend Ahmeti, kryetar i Prishtinës

“Aplikacioni online për leje ndërtimi” do të implentohet në fazë, ku fillimisht do të do të mundësohet aplikimi dhe trajtimi i kërkesave për KUSHTE NDËRTIMI kategoria 1, ku në muajt në vijim do të pasojë me çasje në sistem edhe për procedurat e trajtimit edhe të kërkesave tjera pasi që të njëjtat janë në fazën e testuese. Aplikacioni për disa ditë është në fazën testuese, ndërsa nga e hëna, 12.10.2020, mund të shfrytëzohet zyrtarisht. Falënderojmë Kolegjin UBT për mbështetje dhe për këtë donacion të rëndësishëm”.

Lutfi Haziri, kryetar i Gjilanit

“UBT, me rritjen konstante që ka pasur prej themelimit të saj dhe me shtrirjen aktuale gati në të gjithë Kosovën, duhet të shihet si partner i rëndësishëm strategjik nga të gjitha komunat. Ky partneritet mund dhe duhet të fokusohet në hulumtime të përbashkëta të cilat rezultojnë në projekte të implementueshme për lehtësimin e jetës së qytetarëve. (Në takimin me rastin e dorëzimit të strategjisë për “SmartCity” dhe “EcoCity”)

Haki Rugova, ish-kryetar i Komunës së Istogut

Ne mendojmë se duhet inicuar bashkëpunim i mirëfilltë dhe konkret mes institucioneve lokale (komunave) dhe universiteteve, veçanërisht bashkëpunimi me UBT-në. Ky lloj bashkëpunimi do t’iu ndihmojë komunave të hartojnë politika, strategji dhe projekte konkrete duke përfutur nga resurset profesionale e akademike të universiteteve në njërin anë, ndërsa do t’iu ndihmojë edhe universiteteve për të trajtuar probleme reale dhe për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për shoqërinë në anën tjetër. (Në takimin me rastin e dorëzimit të strategjisë për “SmartCity” dhe “EcoCity”)

Luan Dalipi, shefi i stafit të kryeministrit të Republikës së Kosovës

“Edmondin e njoh prej shumë vitesh, dhe këtë sukses e bëjnë iniciativat e tilla private, sepse janë novatore. Ata nuk presin që qeveritë t’iu ndihmojnë, as politikanët t’iu ndihmojnë, ata sjellin inovacione që të jenë konkurrues. Dhe, ajo që ky projekt sjell, është një dritë në fund të tunelit për mua, dhe jam shumë i emocionuar që jam këtu për të parë se çfarë është planifikuar dhe punuar, sepse mendoj se kjo është absolutisht e vetmja alternativë që kemi. (Në ceremoninë përruese të rrjetit 5G)

Ardian Gola, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sporte

UBT-ja tashmë e ka dëshmuar që është një nga kontribuuesit kryesor që institucioneve të arsimit të lartë i kthen kulturën akademike, shkencore dhe inovative, për ç’gjë vet institucionet e arsimit të lartë realisht janë të dizajnuara si të tilla. 5G konsideroj që është revolucioni më i madh në kuadër të revolucionit digjital i cili e pason revolucionin industrial dhe teknologjik, dhe të kemi një pionier që udhëheq në këtë sferë të inovacionit dikë nga Kosova është sinqerisht diçka me të cilën do të duhej të krenohemi si shtet. (Në ceremoninë përruese të rrjetit 5G)

Edona Maloku Bërdyna - Zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

“Sot kam nderin dhe kënaqësinë që të marr pjesë në inaugurimin e Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar që sjell në Kosovë një teknologji të re, të dobishme në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Ky bashkëpunim në mes UBT-së dhe EON Reality ofron mundësi të reja të pasurimit pedagogjik në klasë duke stimuluar dukshëm interesimin e angazhimin e studentëve dhe për më tepër, duke i kontekstualizuar nevojat mësimore që mendoj se për kontekstin tonë janë esenciale”. (Në ceremoninë e inaugurimit të Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar)

Muhamet Hajrullahu, gazetar

UBT tashmë është institucion kredibil i arsimit në Kosovë, inovativ dhe shumë i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë së edukimit të rinjve jo vetëm në vend por edhe në rajon e më gjerë. UBT tashmë ka dalë jashtë hapësirave vendore duke bashkëpunuar me institucione profesionale të rëndësishme të arsimit në Bashkimin Evropian, ShBA dhe Azi. Besoj që UBT në të ardhmen do të jetë një derë hyrëse e shpresëdhënëse shumë e mirë për nxënësit e studentët për arritjet e tyre në fusha specifike. Besoj që UBT (Departamenti për Media dhe Komunikim) të ketë një ngritje edhe më të madhe duke ofruar vendit e rajonit modelin dhe gazetarët më të mirë profesional.

Faton Osmani, gazetar

Kolegji UBT sivjet shënon jubileun e 20-të. Dy dekada punë përkushtuese për të ofruar për të rinjtë e Kosovës një arsim cilësor e inovativ, sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Fillimi nuk ka qenë aspak i lehtë, sikurse në shumicën e fushave të tjera, në Kosovën e sapodalë nga lufta. Mungonte infrastruktura e duhur, teknologjia ishte e paktë dhe shtrenjtë, pothuajse të gjithë profesorët ishin të huaj. Sot Parku Inovativ e Shkencor në UBT e bën këtë institucion konkurrues e atraktiv, madje edhe për studentët nga rajoni e më gjerë.

Jo rastësisht, UBT-ja sivjet është radhitur ndër 100 universitetet më të mira në botë për inovacion, nga organizata kredibile. E ndër më meritoret për këtë rrugëtim të suksesshëm, pas dyshim, është themeluesi, njeriu i palodhshëm, z. Edmond Hajrizi. Atij dhe gjithë stafit të UBT-së iu uroj dhe shumë jubile e suksese të tjera!

SYRI



PROGRAMET, SPECIALIZIMET DHE PROFILET E AKREDITUARA... ZGJEDH MË TË MIRIN QË TË BËHESH MË I MIRI!

PROGRAMET E STUDIMIT NË UBT, NË NIVELIN BACHELOR

Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi
Specializimet:

- Financa, Banka dhe Sigurimi;
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime;

Shkenca Komputertike dhe Inxhinieri

Specializimet:

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike;
- Databaze dhe Sisteme Informative;
- Grafika Komputertike dhe Multimedia;
- Ueb Programim;
- Rrjetet dhe Telekomunikimi;
- Robotike dhe Sistemet Inteligjente
- Biointformatike;
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit;

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

Specializimet:

- Dizajni i qëndrueshem
- Menaxhim Urban
- Mirëmbajtje dhe Restaurim në Arkitekturë
- Dizajni Enteriit

Menaxhimi i Mekatronikës

Specializimet:

- Menaxhim i Mekatronikës;
- Automatizim Industrial dhe Kontrolli i Proccsit;
- Robotike dhe Sisteme Inteligjente;
- Inxhinieri Bionjeksore;
- Inxhiniera e Telekomunikacionit;
- Inxhiniera Mekanike;
- Inxhinieri e Aeronautikës;
- Dizajnimi i Produkteve Industriale;
- Inxhiniera Elektrike/Elektronike;

Shkenca Politike

Specializimet:

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci;
- Integritme Evropiane;
- Administratë Publike;

Juridik

Specializimet:

- Civile;
- Penale;
- Ndërkombëtare;

Dizajni i Integruar

Specializimet:

- Dizajn Grafik;
- Dizajn Produktit
- Dizajni i Enteriit

Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji

Specializimet:

- Teknologji e ushqimit;
- Nutricion (të ushqyerit);
- Menaxhimi dhe Sigurimi i Cilësisë së Ushqimit;

Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji

Specializimet:

- Teknologji e ushqimit;
- Nutricion (të ushqyerit);
- Menaxhimi dhe Sigurimi i Cilësisë së Ushqimit;

Muzika Moderne, Prodhimi Digital dhe Menaxhimi

Specializimet:

- Kompozim / Këngshkrues;
- Performance Vokale;
- Performance në Instrument;
- Audio Produksion;
- Menaxhment Muzikor;

Agrikultura dhe Inxhiniera e Mjedisit

Specializimet:

- Prodhimtaria bimore;
- Hortikulturë;
- Menaxhimi i mjedisit në agrikulturë;

Studime të Sigurisë

Specializimet:

- Siguria Nacionale dhe Emergjencia Civile;
- Siguria Kibernetike;

Shkenca të Sportit dhe Lëvizjes

Specializimet:

- Shëndet, Parandalimi dhe Rehabilitimi;
- Trajningu Sportiv dhe Stërvitja;
- Menaxhimi në Sport dhe Zvillimi Socioekonomik

Gjuhë Angleze

Specializimet:

- Gjuhë Angleze e Përgjithshme;
- Përkthim;

Sistemet e Informacionit

Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura

Media dhe Komunikim

Specializimet:

- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhim i medias
- Marrëdhënet me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

Teknik Dentar

Psikologji

Administrim Biznesi
Art dhe Media Digitale
Teknik i Radiologjisë
Infermieri
Farmacii
Stomatologji

Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Specializimet:

- Financa dhe kontabilitet bankar;
- Marketing dhe shitje;
- Ndërmarrësi dhe inovacion;
- Logjistika dhe menaxhimi i prokurimit;

Shkenca Komputertike dhe Inxhinieri

Specializimet:

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike;
- Databaze dhe Sisteme Informative;
- Shkenca e te Dhenave;
- Inxhiniera e Komunikimit;
- Programimi në Ueb;
- Multimedia dhe Vizualizim;
- Informatika Mjekësore;

Sisteme të Informacionit dhe Menaxhment

Specializimet:

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike;
- Databaze dhe Sisteme Informatice;
- Shkenca e te Dhenave;
- Inxhiniera e Komunikimit;
- Programimi në Ueb;
- Multimedia dhe Vizualizim;
- Informatika Mjekësore;

Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura

Specializimet:

- Inxhinieri Strukturore;
- Menaxhimi i Ndërtimtarisë dhe Teknologji;
- Infrastruktura Rrrgore;
- Inxhinieri e Ujërave;
- Inxhinieri e Gjeoteknikës;
- Inxhinieri e Materialeve;

Menaxhimi i Mekatronikës

Specializimet:

- Menaxhimi i mekatronikës;
- Dizajni i produkteve Industriale;
- Inxhiniera dhe teknologjia e proccsit të prodhimit;

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

Specializimet:

- Arkitekturë e Qëndrueshme
- Planifikim Hapësinor

Politika Publike dhe Menaxhim

Specializimet:

- Politika Publike;
- Menaxhim Publik

Shkencat e Ushqimit dhe Teknologjisë

Specializimet:

- Nutricion;
- Shkenca dhe Inxhiniera e Ushqimit;
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit;

Energji Elektrike dhe Tregjet e Energjisë

Specializimet:

- Tregu i Energjisë Elektrike dhe Energjisë;
- Inxhiniera e Energjisë dhe Mjedisit;

Politika Publike dhe Menaxhim

Specializimet:

- Politika Publike;
- Menaxhim Publik;

Muzika Moderne, Prodhimi Digital dhe Menaxhimi

Media dhe Komunikim

Shëndet Publik dhe Menaxhim

Zhvillim dhe Urbanizëm

Dizajni i Integruar i Avancuar

Shkenca Politike

E Drejta Penale

E Drejta Biznesore Ndërkombëtare dhe Evropiane

E Drejta Civile dhe Pronës

Krimnologji Komputertike dhe Forenzikë

Farmacii

Stomatologji

30

INOVACIONET E VITIT 2021

1	5G Technology	6	UBT Research Hubs	11	Taylored Manufacturing and Services	16	UBT EdTech	21	UBT High Schools	26	UBT Health Care Services
2	Augmented and Virtual Reality	7	UBT Junior Hub	12	Remote / Contactless Delivery Services	17	UBT Digital Innovation Hub	22	UBT Professional Schools	27	UBT - University 4.0
3	AI, Robotics and Industrial Automation	8	UBT Sport - ESport - Art Hub	13	Creativity Industry Hub	18	National Public Policy Simulation Lab	23	UBT Ideaa	28	UBT Go International
4	UBT Smart City	9	UBT Innovation and Technology Hubs	14	Central Testing Hub	19	UBT Integrated Media Center	24	Virtualisation based Delivery Services	29	UBT Science and Technology Park
5	National Cyber Security and Resilience	10	UBT Knowledge Hub	15	Smart Green Campus	20	UBT GIS Center	25	UBT Community Services	30	Impact Universit